Rruga e Arbërit



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 8 (88). GUSHT 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

AKTUALITET

Nuk lejojmë që uji i Radikës të shkojë në Vardar

Nga **REXHEP TORTE** - FAQE 6

REPORTAZH

Bulqiza e pasur, me njerëz të varfër

Nga **SHAQIR SKARRA** - FAQE 7

EMIGRACION

Në ishullin grek të dibranëve

Nga **MENTOR HOXHA** - FAQE 16

HISTORI

Qeveria provizore dhe kryengritja e shtatorit 1913

Nga GAFUR ZOTA - FAQE 19,23



Shpëtoni Rrugën e Arbrit!

Shoqëria civile duhet që krahas kërkesës për përfundimin sa më shpejt të rrugës, t'i kërkojë qeverisë së ardhshme që projektet e zbatimit të bëhen publike para se të fillojnë punimet, pasi siç ka rezultuar deri më tani, në shumë vepra të rëndësishme të ndërtuara, ka pasur devijime apo përpjekje për ndryshime nga projektet e miratuara, pa pasur më parë një miratim institucional.

Ne duhet t'i ftojmë gjithë qytetarët, sidomos deputetët, të vijnë një vizitë këtu në Qafë Murrizë dhe kur të shikojnë në lindje Dibrën dhe në Perëndim Tiranën, do ta kuptojnë se Rruga e Arbrit nuk është një ëndërr, por një realitet që duhet prekur sa më shpejt.

Duhet një koordinim sa më i mirë i shoqatave dibrane, në mënyrë që të ndikojmë sa të mundemi, që aksi i Rrugës së Arbrit nga Tirana në Bulqizë, të ndërtohet sipas standardeve, duke qënë një shembull i infrastrukturës në vend, jo vetëm nga cilësia e ndërtimit, por edhe siguria rrugore.

OPINIONE / DEBAT

Magjia e rrugës së Arbrit dhe dibranët

Nga **BESNIK ALKU**

Ka ardhur koha që dibranët të mendojnë dhe të organizohen më fort kudo që ato janë, për të qenë më lobues si në politikë dhe në zhvillim, për të pas një grup lobingu që me gjithë diversitetin e tij në përbërje, të ketë një fushë veprimtarie influencën në të mirë të dibranëve. Ky grupim nuk duhet të ketë një ngjyrim politik, fetare apo individual, por vetëm një mision fisnik dhe modern: Për Dibrën!

Rruga e Arbrit nuk ka nevojë për magji

Nga **BUJAR KAROSHI**

Shoqëria dibrane nuk duhet të presë nga qeveria. Ajo duhet t'ia kërkojë qeverisë atë që duhet. Nuk është detyrë e shoqërisë civile të qajë hallet e qeverisë dhe mënyrën se si do t'i gjejë ajo fondet. Ndaj është koha të mos shohim interesin tonë personal lidhur pas një qeverie, por të shohim përpara, sepse me Rrugën e Arbrit të gjithë janë të fituar. Edhe ata që janë kundër!

SPECIALE NE FAQET 2,3,4,5,12,13

INTERVISTË ME SHKRIMTARIN XHAFER MARTINI: Media, letërsia, folklori, botimet, sponsorët, planet krijuese.... Një vështrim kritik dhe realist i shoqërisë, parë në realitetin e sotëm...

Libri, *zgjatim i kujtesës dhe i përfytyrimit të njeriut*

Gazeta "Rruga e Arbërit" e ka bërë të njohur Dibrën dhe dibranët, ka bërë të njohur historinë e tyre, duke pasqyruar ngjarjet më të rëndësishme, ka shkruar për kulturën, traditat, doket, zakonet, jetën e dibranëve në përgjithësi. Por, unë si bashkëpunëtor dhe dashamir i saj, vërej edhe të meta, disa prej të cilave, mjaft të rëndësishme, që, po nuk u vunë në dukje dhe po mos të bëhen përpjekje për t'u eliminuar dora-dorës, do ta dëmtojnë shumë gazetën. Dashuria për një gjë, duke filluar nga dashuria për atdheun, do të thotë jo lavdërime dhe tamtame delirante, por vënia nën zjarrin e kritikës.

Lexoni ne faqen 10,11,14,15



BUJQËSI

Sfidat e bujqësisë, vendet e reja të punës dhe siguria e ushqimit

Nga **DALI HORESHKA** - FAQE 6-7

"SHËNIME NË ÇADËR"

Kujtime që m'i trazojnë Çeliasit

Nga **VESEL HOXHA** - FAQE 20-21

cyan magenta yellow black 1

Qytetarët dibranë, ashtu si gjithë qytetarët e tjerë të Republikës së Shqipërisë u takon të kenë rrugën e asfaltuar, të shkurtër dhe të mirëmbajtur.


opinion

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 8 (88). 1 - 31 Gusht 2013

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë, Haki Pernezha, Mustafa Tola, Destan Rama, Namik Selmani, Dali Tërshalla, se shkrimet e tyre jane në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



KËSHILLI BOTUES:

Musa Riçku
Mentor Hoxha
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Rexhep TORTE
Xhafer MARTINI
Dali HORESHKA
Besnik ALKU
Vesel HOXHA
Gafur ZOTA
Hysen Likdisha
Gazmend Kërkuti
Islam ÇENGA
Nikollë KOLA
Namik SELMANI
Afrim KAROSHI
Mahir JANGULLI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Magjia e **rrugës së Arbrit** dhe dibranët

Nga **BESNIK ALKU**



Një segment i rrugës aktuale për Peshkopi në afërsi të Klosit. Foto © B.Karoshi

Ka ardhur koha që dibranët të mendojnë dhe të organizohen më fort kudo që ato janë, për të qenë më lobues si në politikë dhe në zhvillim, për të pas një grup lobingu që me gjithë diversitetin e tij në përbërje, të ketë një fushë veprimtarie influencën në të mirë të dibranëve. Ky grupim nuk duhet të ketë një ngjyrim politik, fetare apo individual, por vetëm një mision fisnik dhe modern: Për Dibrën!

Rruga e Arbrit është një rrugë e magjishme për të gjithë dibranet, kudo që ato janë në Dibër, Dibër të Madhe, Tiranë, Itali, Amerike, etj. Ajo është e magjishme pasi është rruga historike e dibranëve në jetë të jetëve. Përshkrimin më të bukur ia ka bërë arkeologu e historiani dibran Iljaz Kaca. Ajo do shkurtojë distancën me metropolin dhe qendrat e tjera të zhvilluara të Shqipërisë dhe rajonit. Për 1 orë do përshkruajmë 70 km e saj, do përshpejtojë lëvizjen e njerëzve dhe të mallrave, do të krijojë një akses më të madhe të prodhimit dibran me tregjet kombëtare dhe rajonale, do të zhvillohet turizmi malor dhe rural në Dibër, do të shfrytëzohen më mirë resurset natyrore të Dibrës, do të ketë më shumë të ardhura në xhepat e familjarëve dibranë, do të ketë një impakt të drejtpërdrejtë dhe në aspektin social dhe edukues të populisë, e cila do të jetë më afër qendrave arsimore dhe kulturore të vendit. Dibranët kudo që janë do vizitojnë më shumë njëri-tjetrin dhe do vijnë më shumë në vendlindjen e tyre me familjen dhe me miq e shoke.

Dibranet nuk do të ikin më fushave dhe kënetave të Durrësit dhe Tiranës, dhe shume e shumë gjëra të tjera të bukura dhe të mira do të sjellë ndërtimi i rrugës së Arbrit.

Për të gjitha këto është folur shumë e shumë herë të tjera, kanë qenë pjesë e diskutimeve me njëri-tjetrin, por janë mbajtur dhe shumë kumtesa, konferenca, aktivitete lobuse, botime të ndryshme, publicistike, peticione, janë bërë organizime të ndryshme nga organizata dhe grupime, e shume gjëra të tjera, por përsëri rruga e Arbrit mbetet akoma një gjurmë në hartë në forma të ndryshme dhe një gjurmë në terren që nga lashtësia në epokën e arbrit, në rrugë shfrytëzimi për pyjet, rrugë ushtarake, rruge ekzistuese, trase rruge në segmente të ndryshme, ku ka më shumë se 4 vjet që gërmohet dhe segmente rruge që përdoret që ka filluar të prishet akoma pa u përfunduar. Akoma nuk është arritur të kemi dhe një projekt të plotë teknik të kësaj rruge dhe aq me pak një fond investimi për këtë rrugë.

Socialistët e Nanos e filluan, por shtruan vetëm 300 m, atëherë demokratët në opozitë thanë që "vetëm Sali Berisha do ta ndërtoje rrugën e Arbrit", i cili shtroi ca kilometra dhe gërmoi ca kilometra të tjera. Tani që Sali Berisha nuk është më kryeministër, me nota pesimizmi të gjithë dibranët që kanë mbështetur atë thonë që "kur nuk e bëri edhe Sali Berisha, që shtroi 10 mijë km rrugë, kjo rrugë nuk behet më". Ndërsa dibranët që mbështetën Edi Ramën, që ishin të shumtë në numër, thonë që "Edi Rama e ka prioritet rrugën e Arbrit", megjithëse në asnjë program të tij nuk shikohet, pasi ai ka prioritet aksin e bregdetit. Aq më tepër që qeveria e re shumë shpejt do të merret me borxhin e madh publik të brendshëm dhe për investimet e mëdha në rrugë as që do të bëhet fjalë. Atëherë do të na vijë një kinez që ta marrë me koncesion, por ai është mik i Berishës dhe Rama se mbështet më biznesin e tij, e shume e shume fjalë të tilla, që më shumë janë fjalë kafenesh apo legjenda urbane.

Dhe kur dëgjon këto legjenda të ditëve tona, të duket që rruga e Arbrit është e ngjashme me legjendën e Kalasë së Rozafës, por rrugën tonë njëra palë e ndërton ditën, ndërsa pala tjetër e prish natën, a thua që të kenë bërë një magji që kjo rruge të mos ndërtohet kurrë apo të mbetet ashtu, copa-copa.

A munden që "magjia kundra rrugës së Arbrit" ta prishim me një peticion, i cili ka më shumë se 4 muaj dhe megjithëse janë më shumë se 450 mijë dibranë, akoma nuk është nënshkruar nga 4000 vetë?

A mund ta prishë këtë magji një grup intelektualësh, personalitete të çmuara të fushave të ndryshme në grupime të shumta që janë krijuar mes dibranëve? A mund ta prishin këtë magji simpoziume, konferenca, koncerte apo tubime të ndryshme? A mund ta prishin këtë magji ndonjë lider dibran apo mik i fuqishëm i liderëve që kanë pushtet? A mund ta prishë këtë magji dhe nëse dibranët nisen në këmbë si qëmoti dhe të vijnë në Tiranë? A mund ta prishin këtë magji dhe nëse bëjmë ndonjë dua apo lutje në kisha dhe xhami? Nëse do të ishte me "dua dhe lutje", besoj se do prishej magjia dhe ne do të kishim rrugën e Arbrit.

Nëse rruga e Arbrit do bëhej vetëm me peticione apo kumtesa (gjej rast të falënderoj të gjithë këto nisma të shumë e shumë njerëzve gjatë gjithë këtyre viteve, pasi ka qenë sakrificë, angazhim, para të hedhura për këtë kauzë), besoj se do prishej magjia dhe do e kishim sot rrugën e Arbrit.

KTHIM NË REALITET NË RRUGËN TIRANË-PESHKOPI

Mendimi im është që të gjithë këto forca, përpjekje dhe energji që po përdoren për ndërgjegjësimin e rrugës së Arbrit, ti harxhojmë në një drejtim tjetër, në drejtimin e rrugës së Arbrit të vërtetë, atë rrugë e cila është me gropa, e dëmtuar, me kthesa, me shkarje që për ato shoferë furgonash dhe makinash është dërrmuese dhe shkatërruese, ndërsa për udhëtarët e mërzitshme dhe e lodhshme.

Kjo është rruga e vërtetë Tiranë-Peshkopi, e gjatë dhe e mërzitshme, e pasigurtë, teknikisht e zgjidhur keq e me keq duke përshkuar 200 km në vend që të jetë 70 km, edhe të gjithë ato njerëz që jetojnë atje kanë të drejtën që të kenë rrugën e tyre dhe çdo qeveri që të vijë e ka për detyrim t'ju bëjë këtë rrugë. Qeveria ka detyrim ligjor të ofrojë një shërbim të tillë. Teknikisht, kjo rrugë është e thjeshtë, ajo do të jetë rrugë interurbane dytësore, me dy korsi lëvizje, e gjerë 7-11 m, me disa vepra arti përfshirë këtu tunele dhe ura, dhe do të plotësojë kriteret e eficencës dhe efektivitetit si në aspektin financiar dhe atë social.

Rruga Tiranë-Peshkopi, nuk do të jetë si rruga e Kukësit, nuk do të jetë si rruga e Durrësit, nuk do të jetë si rruga e Elbasanit, nuk do të jetë si rruga e Vlorës, nuk do të jetë si rruga e Qaf-Thanës, ajo për nga standardin e ndërtimit do të jetë një rrugë që lidh qendra të banuara, pak më cilësore se rruga Kukës – Peshkopi dhe këtë po e shikojnë të gjithë dibranët në atë segment që e kanë përfunduar dhe ato ecin çdo ditë.

Qytetarët dibranë, ashtu si gjithë qytetarët e tjerë të Republikës së Shqipërisë u takon të kenë rrugën e asfaltuar, të shkurtër dhe të mirëmbajtur. Pra, kjo rruge, e ka emrin e thjeshtë "Tiranë – Peshkopi", një realitet dhe aspak legjendë apo mit.

NEVOJA E FORCIMIT DHE STRUKTURIMIT TË INFLUENCËS DIBRANE

Por, çfarë duhet të bëjnë dibranët që kjo rrugë të ndërtohet? A duhet të presin që kjo rruge të ndërtohet si dhurata e ndonjë lideri politik? Unë mendoj që dibranët nuk duhet të presin një gjë të tillë, ato duhet të ngrenë në një standard më të lartë dhe më modern influencën dhe përpjekjet e tyre për ndërtimin e rrugës "Peshkopi –Tiranë", por dhe për çdo gjë që lidhet me zhvillimin e Dibrës dhe fuqizimin social ekonomik të dibranëve. Mendoj se ka ardhur koha që dibranët të mendojnë dhe të organizohen më fort kudo që ato janë, për të qenë më lobues si në politikë dhe në zhvillim, për të pas një grup lobingu që me gjithë diversitetin e tij në përbërje, të ketë një fushë veprimtarie influencën në të mirë të dibranëve. Ky grupim nuk duhet të ketë një ngjyrim politik, fetare apo individual, por vetëm një mision fisnik dhe modern: Për Dibrën!.

Kështu, nëse do kemi një grupim të tillë mund të fitojmë mbi grupimet e tjera që fondet e investimeve që mund të ishin për rrugën e Arbrit dhe i kanë çuar në një destinacion tjetër, vetëm kështu mund të bëjmë që skemat e subvencioneve bujqësore të shkojnë te fermerët dibranë më shumë se te fermerët e rajoneve të tjera. Vetëm në këtë mënyrë mund të bëjmë që fondet për turizmin malor të shkojnë në Korab dhe Lure, më shumë se në vendet e tjera. Vetëm në këtë mënyrë, mendoj që rruga Peshkoi-Tiranë do të jetë realitet dhe magjia e saj dhe magjitë e tjera kundër dibraneve do të prishen.

opinion

Një vështrim ndryshe, nxitur nga shkrimi
"Magjia e Rrugës së Arbrit dhe dibranët"

Rruga e Arbrit nuk ka nevojë për magji

Nga **BUJAR KAROSHI**

Shkak i këtij shënimi u bë shkrimi i Besnik Alkut. Që në fillim dua ta falënderoj autorin për guximi dhe kurajën për të botuar një opinion, që qarkullon prej kohësh, por që nuk ka marrë kush përsipër ta bëjë publik, qoftë edhe nga zyrtarë të shtetit dhe përfaqësues të popullit në parlament, specialistë të fushës së infrastrukturës apo pushtetarë lokalë.

A ËSHTË RRUGA E ARBRIT RRUGA E DIBRËS?

Pikëpamja ime dhe e një pjese të mirë të shoqërisë civile, që kanë lobuar dhe po lobojnë për rrugën e Arbrit, nuk po kërkojnë rrugën e Arbrit për Dibrën. Ne, dhe për fatin e mirë, qindra qytetarë që kanë dhënë opinionet e tyre në mbështetje të Rrugës së Arbrit, e shohin ndërtimin e saj në një kuadër më të gjerë. Ata shohin ndërtimin e saj në funksion të integrimit të Shqipërisë në bashkësinë Europiane, dhe bashkë me të, integrimin e infrastrukturës rrugore në rrjetin e rrugor europian.

Kjo pjesë e shoqërisë, që po kërkon rrugën prej gati dy dekadash, nuk e sheh ndërtimin e saj si një lidhje të Tiranës me Peshkopinë. Për fat të mirë, që në nisje të kërkesës popullore, rruga do t'ia sillte përfitimet të parës popullsisë që jeton në Dibër, por vlerat dhe përfituesit e vërtetë të rrugës, do të jetë shoqëria shqiptare. Rruga kërkohet të ndërtohet me dalje në Luginën e Pollogut në Maqedoni dhe kështu lidhet me sistemin e autostradave europiane.


Për hir të së vërtetës, duhet thënë se kjo pjesë e shoqërisë civile e ka kundërshtuar fillimin e Rrugës së Arbrit tre ditë para zgjedhjeve në Korrik të vitit 2005, pasi ato punime nuk filluan në gjurmën e miratuar të Rrugës së Arbrit, miratuar po nga Fatos Nano në kështillin Kombëtar të Rrugëve. Opozita e atëhershme e denoncoi këtë fakt si fillim të punimeve pa projekt, por sapo erdhi në pushtet, jo vetëm që i vonoi dy vjet punimet, por në dhjetor 2007 i filloi punimet në të njëjtin vend që kishte prerë shiritin Fatos Nano.

Me gjithë premtimet e vazhdueshme të qeverive në pushtet, deri me tani, nga Rruga e Arbrit nuk është ndërtuar asnjë kilometër. Pasi rruga e ndërtuar deri me tani, nuk është ne aksin e miratuar nga Këshilli Kombëtar i Rrugëve, nuk është ndërtuar në standardet e kërkuara dhe përkundrazi, edhe aty ku ka pasur mundësi përmirësimi, ajo është dëmtuar me ndërhyrjen, për fat të keq të "inxhinierëve dibranë".

Faktet po tregojnë sot se janë ndryshuar projektet e zbatimit gjatë punës, pa miratimin e strukturave dhe institucioneve përkatëse.

A ISHTE SERIOZE QEVERIA SHQIPTARE ME RRUGËN?

Unë kam krijuar bindjen se qeveritë e derisotme nuk e kanë marrë seriozisht problemin e Rrugës së Arbrit. Ata kanë lejuar vonesa të pajustifikuara në ndërtimin e saj, por më kryesorja kanë pranuar si të përfunduar një rrugë, e cila nuk i përmbush standardet e udhëtimit. Rrugës i mungon siguria, si dhe lëvizja në të është maksimumi 60 km/orë, si dhe ka segmente që shpejtësia kufizohet në 20 apo 30 km/orë. Pra, ndërtimi i këtij segmenti nuk përmbush kriterin e premtuar të lëvizjes me shpejtësi 80 km/orë, përveç një segmenti në dalje të qytetit të ri të Bulqizës. Vetëm këtë verë në këtë aks kanë ndërruar jetë nga aksidentet 2 qytetarë dhe 5 të tjerë janë të plagosur. Rrugës i mungon sinjalistika, madje një segment te Kepi i Qytetit është me kthesa të pakuptimta. Kur u pyet në atë kohë ndërtuesi se pse nuk



Është koha të mos shohim interesin tonë personal lidhur pas një qeverie, por të shohim përpara, sepse me Rrugën e Arbrit të gjithë janë të fituar. Edhe ata që janë kundër!

Urë në rrugën e Arbrit mbi lumin e Tiranës ne afërsi të Qafës së Tujanit. Foto:© B.Karoshi

janë eliminuar kthesat, tha se "janë lënë për variacion". Ndërsa në një legjende urbane, për t'ia hequr përgjegjësinë qeverisë, thuhet se kur paska kaluar Berisha asaj ane, paska thënë: "Unë e kam ditur që po ndërtojmë rrugën e Arbrit, por paskemi ndërtuar "rrugën e gjarprit".

Gjithë opinioni dibran ka pritur që me përfundimin e rrugës së Kukesit do të fillonte Tuneli i Murrizit, një nga dy veprat më të rëndësishme të Rrugës së Arbrit, por Kryeministri Berisha i çoi financimet e kërkuara në tunelin Kërrabës. Asnjë zyrtar, qoftë lokal apo qendror, asnjë deputet dibran, asnjë ministër nuk dha asnjë shpjegim për mosmbajtjen e këtij premtimi.

Vetëm pak ditë para zgjedhjeve u pranua nga qeveria ajo që qarkullonte si thashetheme, se në "Tunelin e Murrizit dilka ujë", por ky justifikim, sipas specialistëve, nuk qëndron. Tani, pas zgjedhjeve, Berisha shpalli në Facebook se "kishte gjetur financimin për ndërtimin me koncesion nga kinezët", por duket i çuditshëm fakti se, megjithëse kishte dy vjet që bënte negociata me kinezët, ai nuk tha asnjë fjalë gjatë fushatës.

Unë si redaktor i gazetës i kam shkruar një email firmës kineze dhe Ambasadës së Republikës Popullore të Kinëz në Tiranë, por deri më sot nuk kemi marrë asnjë përgjigje. Ndërsa rezulton se delegacioni me të cilin u takua Kryeministri, ishte një delegacion i Partisë Komuniste Kineze.

Shoqëria dibrane nuk duhet të presë nga qeveria. Ajo duhet t'ia kërkojë qeverisë atë që duhet. Nuk është detyrë e shoqërisë civile të qajë hallet e qeverisë dhe mënyrën se si do t'i gjejë ajo fondet. Ajo është detyrë e saj.

PETICIONI

Siç e kemi theksuar edhe me parë, peticioni është vazhdim i kërkesës së shoqërisë shqiptare, dhe kryesisht asaj dibrane, për të përmbushur nevojën e një infrastrukture bashkëkohore mes Tiranës dhe Dibrës, dhe më tej me hapësirën shqiptare në Maqedoni.

Peticionin deri më tani është firmosur nga 4500 vetë, që sipas një leximi të parë mendohet se janë dibranë. Por unë që kam pasur fatin të kem hyrje në listën e firmëtarëve, më rezulton se as gjysma e tyre nuk janë dibranë. Firmëtarët janë shqiptarë, nga Saranda në Mitrovicë, nga Korça në Shkodër, nga Amerika në Australi, nga Tirana në Shkup, të cilët, për fatin e mirë, e shikojnë Rrugën e Arbërit ashtu siç ajo duhet të jetë. Për ndërtimin e saj nuk ka nevojë për magji dhe legjenda, por duhet të besojmë te energjitë tona për të qenë të aftë të bashkohemi, në radhë të parë për të mirën e vendit, Shqipërisë, dhe pastaj për të mirën tonë individuale.

Peticioni nuk e zgjidh problemin, por së bashku me aksionet e tjera të shoqërisë civile në vend, ajo do të bëjë të mundur jo ndërtimin e rrugës, por përshpejtimin e saj si dhe ndërtimin me standardet më të larta se sa janë parashikuar. Duhet të ndërtojmë Rrugën e Arbrit që do të na bashkojë, ajo do t'i japë një frymëmarrje Tiranës së mbipopulluar në afro një milionë banorë, si dhe do t'i kthejë njerëzit tek puna.

A ËSHTË RRUGA TIRANË - PESHKOPI RRUGA E ARBRIT?

Prej kohësh, qytetarë dhe qeveritarë, që qajnë hallet e qeverisë më shumë se të popullit, kanë dhënë lloj-lloj propozimesh, si "Rruga e Arbrit" të kalojë nga Burreli dhe të lidhet me Rrugën e Kukësit", "apo të ndërtohet Rruga nga Stebleva në Librazhd", apo edhe ideja që të mos e kërkojmë më rrugën e Arbërit që kalon mes malesh, por të kërkojmë zgjerimin e rrugës ekzistuese.

Qeveritë mund të vendosin të investojnë ku të duan, aq më tepër në një shoqëri të plogësht dhe apatike, që në mëngjes i lutet qeverisë dhe në darkë Zotit, por asnjë nga akset rrugore të mësipërme nuk mund të quhet Rruga e Arbërit. Rruga e Arbrit është ajo që fillon në Tiranë, kalon nga Qafa e Tujanit, Zall Dajt, Qafa e Murrizës, Guri i Bardhë, Ura e Vashës, Planit të Bardhë, në Bulqizë e në vazhdim drejt Dibrës së Madhe. Çdo aks tjetër i emërtuar me këtë emër, është mashtrim publik dhe ata që e bëjnë këtë cilësim, me dashje apo pa dashje, po punojnë kundër interesave të zhvillimit të vendit.

"Rruga Tiranë - Peshkopi, shkruan B.Alku, nuk do të jetë si rruga e Kukësit, nuk do të jetë si rruga e Durrësit, nuk do të jetë si rruga e Elbasanit, nuk do të jetë si rruga e Vlorës, nuk do të jetë si rruga e Qafë-Thanës, ajo për nga standardin e ndërtimit do të jetë një rrugë që lidh qendra të banuara, pak më cilësore se rruga Kukës – Peshkopi dhe këtë po e shikojnë të gjithë dibranët në atë segment që e kanë përfunduar dhe ato ecin çdo ditë".

Por çfarë janë dibranët që nuk e dashkan një rrugë si gjithë rajonet e tjera të vendit? Dibranët e mençur, luftëtarë, trima, që kanë marrë pjesë në luftërat kundër pushtuesve në çdo cep të vendit, aty ku mendja ka gjetur shtëpinë e vet, aty ku mund ta mbarosh një universitet vetëm se ke jetuar apo kaluar asaj ane, aty ku gjallon lavdia dhe krenaria e të qënit shqiptarë e të përulur, çfarë paskan bërë që nuk e merituakan një rrugë?

Rruga e Arbrit, edhe sikur vetëm për Dibrën të ndërtohej, do ta kishte të justifikuar ndërtimin. Shoqëria, ajo dibrane në veçanti, duhet të flasin me një zë për rrugën që i nxjerr nga izolimi, që u krijon hapësira zhvillimi e jetese më të mirë. Rikonstruksioni dhe mbajtja në funksion e rrugëve ekzistuese nuk është përgjegjësi madhore e shoqërisë civile, por e zyrtarëve të zgjedhur apo të emëruar.

Shoqëria civile shikon përpara, të paktën në 50 vitet e ardhshme!

Ndaj është koha të mos shohim interesin tonë personal lidhur pas një qeverie, por të shohim përpara, sepse me Rrugën e Arbrit të gjithë janë të fituar. Edhe ata që janë kundër!

Shqipëria ka nevojë për infrastrukturë më të mirë. — Ndrek Gjini, MA GALWAY, IRELAND.



Rruga e Arbrit është një arterie e rëndësishme për të lidhur njerëzit dhe kombet në rajon dhe do të nxisë ekonominë, kulturën dhe zhvillimin në përgjithësi. Nuk jam në moshën që mund të konsiderohet e re, po kjo nisme e mrekullueshme më bën të ndjehem fare i ri! — Ferhat Ymeraga, KENT, WA.

Rruga e Arbrit *i shërben interesit kombëtar*

Qani Vezi, PESHKOPI, ALBANIA: Rruga e Arbrit është një mrekulli e vërtetë për të gjithë vendin tonë, prandaj urojmë e shpresojmë që të realizohet sa më shpejtë.

Atilda Belina, VLORË, ALBANIA: Mendoj që është i talentuar.

Fatjola Ferrollari VLORË, ALBANIA: Është e rëndësishme.

Malvin Goleci, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse shkurton hapësirën mes shkollës dhe qytetit dhe mund të shkoj në fundjavë në shtëpi.

Aleksander Islami, PESHKOPI, ALBANIA: Për të arritur më shpejtë dhe më lehtë kryeqytetin e Shqipërisë

Alban Roci, PESHKOPI, ALBANIA: Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Elton Cani, PESHKOPI, ALBANIA: Është gjithçka.

Mevlud Zenelhasani, PESHKOPI, ALBANIA: Nëse bëhet fjalë për rëndësi, pikërisht kjo rrugë është ajo që do t'i japë vlerat dhe rëndësinë e duhur Peshkopisë sime. Rruga e Arbrit nuk është vetëm për dibranët, por për Shqipërinë e madhe!

Arshi Saraçi, BRONX, NY: Bashkon vendlindjen time me Tiranën e Europën në një kohë sa më të shkurtër, i bën b/qytetarët e mi me një kosto jetese më të ulët, mirëqenie më të mirë e pse jo: Dibrës i zgjidhet dhe padrejtësia që i është bërë nga qeveritë e ndryshme të kohës së komunizmit dhe kohës të demokracisë. Edhe Dibra ka të drejtën e saj të zhvillohet si shumë qytete të tjera të Shqipërisë (Ne po kërkojmë vetëm një rrugë që të shkurtojë distancën me qendrën e Shqipërisë kur Kukësi ka autostrade në emër të "korridorit 8") Po Dibra a nuk është një "korridor" për lidhjen me zonat e shumta shqiptare në Maqedoni dhe pjesën veri-lindore të Shqipërisë? Bëjeni rrugën e ARBRIT në emër të asaj që quhet përparim i vendit. Dhe ju PUSHTETARET LOKALE të dy Dibrave mos shikoni vetëm interesin tuaj por vazhdoni rrugën e nisur deri në fund. Para ca vitesh premtuat shumë por 2012 kaloi e po mbaron dhe 2013-ta???!!!!....Më pak premtime e më shumë rezultate. P.S:SHPRESOJ SE ÊNDRRA IME DHE E BASHKËQYTETARËVE TË MI NJË DITË TË BËHET REALITET!...

Igballe Sylejmani, PRISHTINË, KOSOVO: Gëzim i nderuar, u uroj nga zemra që Projekti juaj të fitojë përkrahjen e gjerë.

Kastriot Sherifi, GJILAN, KOSOVO: Qeverisë Shqiptare të pas zgjedhjeve të 2013-tës, Ndërtoni rrugën e Arbrit.

Fidan Selimi, SHKUP, MACEDONIA: Me fat !

Emri Sela, BOLOGNA, ITALY: Dibra është vendlindja ime e dashur.....

Ramadan Lici, Χανιά, GREECE: Të ndërtohet rruga e Arbrit.

David Prenka, GERMANY: Dua që trojet e shqipes të lulëzojnë nga çdo anë. Ato brigje të pakalueshme ndër shekuj të bëhen mrizore për turistin e rastit, të huaj e vendas. Ndërtoje qeveri, cila do të jesh vendin, rrugën cila do qoftë dhe kudo qoftë, sepse përmes rrugës vjen e ardhmja e lumtur për të gjithë.

Edmond Binjaku, TORONTO, CANADA: E mbështes si çdo investim që do të kontribuonte në unifikimin e trevave shqiptare!

Elhamidin Elmazi, TETOVË, MAQEDONI, MACEDONIA: Është e rëndësishme për të gjithë Shqipërinë

Fejzi Cena, SPAIN: Për ta shkurtuar udhëtimin tim drejt vendlindjes sime Dibrës, dhe patjetër më të këndshëm.

Bledar Halili, TIRANE, ALBANIA: Është vendlindja ime.

Faruk Kaba, TIRANA, ALBANIA: Si autor i kësaj rruge (Ideja, studimi i kryer dhe hartues i projekt zbatimit, besoj se nuk ka më shumë nevojë për komente. Dhëntë zoti të realizohet sa më parë.

Ndrek Gjini, MA GALWAY, IRELAND: Shqipëria ka nevojë për infrastrukturë më të mirë.

Igli Kadriu, BROOKLYN, NY: Kjo është e rëndësishme për mua pasi unë jam rritur e Dibër edhe rrugët ishin të prishura kështu që tani e dua sepse tani mund të shkojmë edhe t'i shikoj prindërit e mi më shpejt edhe më lirë

Korab Lazri, PESHKOPI, ALBANIA: Kjo rrugë është e rëndësishme sepse Dibra është një rajon i pasur, dhe qyteti ka një nivel të lartë prodhimi, bujqësie, gjëje të gjallë dhe do të ketë një ndikim pozitiv për zhvillimin e prodhimit kombëtar

Eriselda Balliu, VLORA, ALBANIA: Do të na afrojë më shumë me shqiptarët e Maqedonisë.

Ramazan Ilnica, TIRANA, ALBANIA: Kam dëshirë që ta mbërrij ditën që të udhëtoj për dy orë e ta shoh shpesh Vendlindjen time.

Xhevat Ukshini, GERMANY: Rrugë e rëndësishme!

Victor de Waal, LONDON, UNITED KINGDOM: E njoh dhe e kam vizituar këtë rajon të këndshëm.

Michael E. Martin, CHELTENHAM, UNITED KINGDOM: Përmirëson një arterie të gjallë rrugore në Ballkan për përfitimin e të gjithëve

Bledar Kuta, LONDON, UNITED KINGDOM: Për një të ardhme më të mirë

Ylber Sina, NOTTINGHAM, ENGLAND, UNITED KINGDOM, UNITED KINGDOM: Ndjehem keq për njerëzit që jetojnë në verilindje të Shqipërisë. Nuk ka pasur investime për rreth një shekull. Akoma përdoren rrugët që u ndërtuan nga Italia në Luftën e Dytë Botërore. Qeveria shqiptare duhet t'i shikojë të gjithë njësoj por kjo pjesë e popullsisë është lënë pas dore. Mendoj që është koha për njerëzit në pushtet të bëjnë diçka për këtë rajon, duke ndërtuar rrugën e duke rritur mundësitë për biznes. Ky është një vend Europian dhe standardet e jetesës duhet të jenë si në Europë, kur në fakt janë si në Lindjen e Mesme ose si në Afganistan. Dua të jap gjithë mbështetjen time për këtë projekt, për mbarimin e tij dhe të ndihmoj këtë rajon që të ketë mundësi më të mira biznesi për zonën më të pastër të Shqipërisë.

Erion Dardha, TIRANA, ALBANIA: Të ndërtohet Rruga e Arbrit

Renols Dehari, EDMONTON, CANADA: Për rrugën e Arbrit, kam 14 vjet që nuk kam shkuar vitin që vjen dua të shkoj shpresoj me rrugën e Arbrit.

Klodi Xheka, PESHKOPI, ALBANIA: Për zhvillimin e Dibrës

Leonat Zepishta, BRONX, NY: Është vendlindja e nënës sime. Unë kaloja pushimet andej. Nëse e rregullojnë rrugën do të udhëtoj përsëri në këtë vend të mrekullueshëm

Man Poga, KRUMË, HAS!, ALBANIA: Përtej interesit lokal që ka kjo rrugë, mendoj se më së shumti i shërben interesit kombëtar. Kështu duhet parë investimi për këtë projekt anipse lobimi është bërë më së shumti nga dibranët. Rruga e Arbrit është një rrugë jo thjesht që lidh Dibrën me Tiranën, por është një rrugë që lidh dhe bashkon përfundimisht për mos t'u ndarë e zgjidhur, Maqedoninë Shqiptare me Tiranën si Kryeqendër e Kombit tonë. Kjo rrugë është jetike për vitalizimin e pjesës lindore të Shqipërisë dhe kthimit në vëmendje të vendbanimeve e qyteteve Shqiptare që ndodhen në Maqedoninë Perëndimore. Uroj që sa më shpejt ta shoh rrugën të përfunduar. Amin!

Blerta Rreshketa, MONTREAL, CANADA: Shqipëria është vendi im dhe ata kanë nevojë për rrugën

Ada Shehu, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse kjo është rruga më e shkurtër për në Tiranë

Serda Shehu, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse është e rëndësishme për të gjithë dibranët

Anisa Balla, TIRANA, ALBANIA: Që të shkoj në Dibër

Nertila Beqiri, TIRANA, ALBANIA: Infrastruktura ndihmon në zhvillimin e vendit.

Besmira Tuma, BULQIZË, ALBANIA: duke qenë se jam banore e Dibrës dua një zhvillim për të dhe kjo rrugë do t'i japë shumë zhvillim zonës sime.

Elson Cibaku, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse studioj në Tiranë dhe shkoj në Peshkopi njëherë në muaj. Me rrugën mund të shkoj në shtëpi çdo ditë.

Enes Krashi, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse i shton vlerë të ardhmes së qytetit tim

Anxhela Çili, ELBASAN, ALBANIA: Të mbarohet ndërtimi i rrugës

Ermira Uka, BROOKLYN, NY: Peshkopia është qyteti im!!!

Skender Zogu, FRANCE: Do të hapë hapësira të reja për turizmin

Ornela Llorja, TIRANE, ALBANIA: Për të patur një rrugë më të shkurtër

Erblina Kërçishta, TROY, MIL: Që të shkoj atje më shpejt dhe do të jetë pozitive për Bulqizën dhe Peshkopinë.

Enxhi Merpeza, ROYAL OAK, MI: Dua që të gjithë njerëzit e Shqipërisë të kenë lidhje me njëri-tjetrin...veç po të duam që të themi që jemi një njerëzim shqiptar me tradita të bukura– jo njerëzim me toka të ndara.

Anita Kallaverja, LONDON, UNITED KINGDOM: Do të përmirësohet rrugëtimi im për në shtëpi.

Vedat Shehu, SHARON, MA: Ka rëndësi përparësore në progresin e gjithanshëm jo vetëm të Dibrës, por edhe të Tiranës, kryeqytetit mbarëshqiptar. Pse është neglizhuar? Për mendimin tim neglizhimi buron nga mentaliteti enverist që ishte kundër komunikacionit dhe kundër komunikimit midis njerëzve. Vetvetishëm apo me dashje ky mentalitet është përcjellë nga pasuesit e Politikës Enveristë në Kapitalizmin shqiptar, pa pronarë, pa kapital, pa kapitalista, por me bollëk enverista.

Madana Kimet, GRADISCA D'ISONZO, ITALY: i shërben gjithë trojeve shqiptare

Ejona Mazari, ANKARA, TURKEY: Jam nga Peshkopia dhe e dua vërtet këtë rrugë sepse ka vështirësi për të udhëtuar për në Peshkopi. Do të jetë një mundësi që Peshkopia të zhvillohet pasi të mbarojë rruga.

Tauland Cekici, PESHKOPI, ALBANIA: Për 1.000.000 arsye

Artur Muça, PESHKOPI, ALBANIA: Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar

Përmirëson një arterie të gjallë rrugore në Ballkan për përfitimin e të gjithëve. — Michael E. Martin, CHELTENHAM, UNITED KINGDOM.



Foto: © B.Karoshi

Përtej interesit lokal që ka kjo rrugë, mendoj se më së shumti i shërben interesit kombëtar. Kështu duhet parë investimi për këtë projekt anipse lobimi është bërë më së shumti nga Dibranet. Rruga e Arbrit është një rrugë jo thjesht që lidh Dibrën me Tiranën, por është një rrugë që lidh dhe bashkon përfundimisht për mos t'u ndarë e zgjidhur, Maqedoninë Shqiptare me Tiranën si kryeqendër e Kombit tonë. Kjo rrugë është jetike për vitalizimin e pjesës lindore të Shqipërisë dhe kthimit në vëmendje të vendbanimeve e qyteteve Shqiptare që ndodhen në Maqedoninë Perëndimore. Uroj që sa më shpejt ta shoh rrugën të përfunduar. Amin! — **Man Poga**, KRUMË, HAS.

ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Eriola Kica, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse jetoj në Peshkopi

Almira Xhembulla, PESHKOPI, ALBANIA: Mundësi më të mira

Besnik Avdiaj, GJAKOVA, KOSOVO: Është e rëndësishme për zhvillimin e infrastrukturës së vendit dhe lidhjen e sa më shumë pjesëve periferike me qendra kryesore!

Zenulla Mehmeti, PESHKOPI, ALBANIA: Në fund të fundit zhvillimi ekonomik i një vendi ndodh kur të gjitha rajonet e saj janë të zhvilluara, aq më tepër kur në ato zona ekzistojnë potenciale për të zhvilluar ekonominë e saj. Njerëzit e këtij rajoni janë shumë punëtorë dhe e meritojnë një investim të tillë për të marrë përfitimet ekonomike që rrjedhin nga ndërtimi i Rrugës së Arbrit.

Almir Trepcha, DEBAR, MACEDONIA: Është e rëndësishme për mua sepse dua t'i shikoj të gjithë shqiptarët së bashku.

Basri Troci, TIRANE, ALBANIA: Vepra me e rëndësishme për të gjithë trevën e Dibrës dhe më gjerë

Era Kërliu, DEBAR, MACEDONIA: Sepse është më e lehtë për të shkuar në Shqipëri, do jetë ndihmë për ekonominë, turizmin, etj.

Manjola Lipe, TIRANA, ALBANIA: Kam kaluar fëmijërinë time atje

Mustaf Dida, TIRANA, ALBANIA: Jetoj në Tiranë dhe jam student në Universitetin "Aleksandër Moisiu"

Mustaf Dida, TIRANA, ALBANIA: Sepse jam student në Universitetin "Aleksander Moisiu" Peshkopi.

Ardit Rustani, PESHKOPI, ALBANIA: Të ndërtohet rruga e Arbrit

Arian Oboku, DIBER, MACEDONIA: Ndërtimi i Rrugës së kombit (Rruga e Arbrit)

Shpetim Kaja, DIBER, MD: Dy qytete bëhen një.

Adnan Jusufi, SKOPJE, MACEDONIA: Është shumë shumë e rëndësishme për bashkimin e shqiptarëve, ruajtjen e traditave kombëtare, kulturës dhe përmirësimin e ekonomisë nga të dyja anët

Ardian Hame, DEBAR, MACEDONIA: Sepse rruga që do ndërtohet do të lidhë qytetin tim me atdheun mëmë Shqipërinë, dhe gjithashtu do të lidhë shqiptarët që jetojnë në Maqedoni me gjithë Europën.

Ardi Zhuta, STRUGA, MACEDONIA: Sepse kemi nevojë të jemi në lidhje me Shqipërinë; kemi familje andej.

Ferhat Ymeraga, KENT, WA: Rruga e Arbrit është një arterie e rëndësishme për të lidhur njerëzit dhe kombet në rajon dhe do të nxisë ekonominë, kulturën dhe zhvillimin në përgjithësi. Nuk jam në moshën që mund të konsiderohet e re, po kjo nisme e mrekullueshme më bën të ndjehem fare i ri!

Andri Gjeci, TIRANË, ALBANIA: Shkurton kohën për të shkuar në Dibër .

Fatjon Selmani, VLORË, ALBANIA: Sepse prindërit e mi jetojnë atje

Namik Pilafi, TIRANA, ALBANIA: Sepse ndihmon në zhvillimin e qarkut Dibër dhe është rruga që bashkon shqiptarët njëri me tjetrin pra rruga e Arbrit.

Përgatiti për botim dhe përktheu nga anglishtja: **AFRIM KAROSHI**

SHËNIM I REDAKSISË: Komentet janë të pacensuruara. Redaksia ka ndërhyrë në komente vetëm për korrigjime drejtshkrimore. Gjithashtu, në këtë përmbledhje janë përfshira vetëm komentet e shënuara në faqen e peticionit në change.org.

Mbi modalitetet e nënshkrimit të peticionit online për Rrugën e Arbërit

Dëshirojmë të njoftojmë gjithë lexuesit se peticioni onlinë për Rrugën e Arbrit do të vazhdojë të firmoset dhe ai do të mbyllet vetëm kur të përurohet rruga Tiranë-Dibër.

Shumë qytetarë në Shqipëri dhe në vende të tjera kanë komunikuar me redaksinë e gazetës "Rruga e Arbërit" dhe hartuesin e peticionit për të konfirmuar se e kanë nënshkruar atë si dhe për tu interesuar nëse nënshkrimet e tyre janë regjistruar.

Pavarësisht ftesave të ripërsëritura për ta firmosur peticionin, njoftojmë se vetëm nënshkrimet që përmbushin kriteret e rrepta të transparencës të përcaktuara që kur filloi peticioni, do të përfshihen në dokumentin zyrtar që do t'i dorëzohet qeverisë së re.

Ju rikujtojmë se kush e ka nënshkruar peticionin online, nuk duhet ta firmosë për së dyti, si dhe nuk ka të drejtë ta nënshkruajë atë në letër.

Lista e plotë e nënshkrimeve dhe komentet e bëra online do të jenë dokumente publike.

Gjithashtu, njoftojmë gjithë ata që kanë firmosur peticionin në letër, t'i sjellin ato sa më shpejt në redaksi, pasi procesi i përgatitjes së peticionit për t'iu dorëzuar qeverisë shqiptare ka filluar.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj!



NDIQ HAPAT E MËPOSHTME PËR TË FIRMOSUR SAKTË:

1 - KLIKO NË FAQEN E WEB SI MË POSHTË:

www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-thearb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarderrug% C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

2- LART, DJATHTAS SHFAQEN KUADRATET BOSH

Shkruaj Emrin, Mbiemrin, Adresën e emailit dhe Qytetin tuaj. Pastaj klikon **"Sign".**
Pas kësaj, ju do të merrni një mesazh falënderimi dhe konfirmimi që emri juaj u regjistrua.
Për të gjithë miqtë tuaj që nuk kanë mundësi hyrje në web,
sharko formularin dhe plotësoje me dorë.
Për hollësi mund të vizitoni faqen e gazetës
në Web: <**www.rrugaearberit.com**>
ose në Facebook <**facebook.com/gezim.alpion**>
ose <**facebook.com/rruga.arberit**>

Rruga e Arbërit nr. 88

Dibra e Madhe kundërshton ndërtimin e HC në Fushën e Llukovës



Pamje nga Gryka e Radikës. Foto © Gazmend Kërkuti

Nuk lejojmë që **uji i Radikës** të shkojë **në Vardar**

Nga **REXHEP TORTE**

Kohëve të fundit në Dibër të Madhe po debatohet shumë lidhur me projektin e Maqedonisë për ndërtimin e HC në Fushë të Llukovës

që ndodhet në trekëndëshin Maqedoni-Shqipëri dhe Kosovë, me çka sërish do të merren ujërat e lumit Radikë.

Ruzhdi Lata, kryetar i Komunës së Dibrës së Madhe, lidhur me çështjen marrjes së ujit të lumit Radikë për ndërtimin e HC në Fushën e Llukovës, tha për gazetën "Rruga e Arbërit" se:

"Komuna e Dibrës dhe qytetarët e saj janë shumë të shqetësuar për këto veprime të njënshme, qoftë nga Ndërmarrja për prodhimin e energjisë elektrike në Maqedoni "Elem-it" , por edhe nga investitori, Banka Botërore. Kështu që, ditë më parë, në Komunë erdhën përfaqësues nga Banka Botërore, përfaqësues të "Elem-it", Ndërmarrjes për prodhimin e energjisë elektrike në Maqedoni, përfaqësuesit të një shoqate ndërkombëtare për çështje ekologjike, gjithsej 20 persona, në mesin e të cilëve nuk ishte asnjë shqiptar. Qëllimi dhe kërkesa e tyre ishte që të arrijnë realizmin e këtij projekti. Me informacionin që e dha Banka Botërore si investitor, u dëshmua se për ndërtimin e HC në Fushën e Llukovës do të merren dy deri në shtatë metër kub ujë në sekondë, që do të thotë se do të përfshiheshin gjashtë burime uji, të cilat sot derdhen në Lumin Radikë. Uji i këtyre burimeve do të merrej duke e ndryshuar rrjedhjen e tyre natyrale dhe uji i tyre do të derdhej në Lumin Vardar për në Detin Egje. Këtë ide e kundërshtuam me arsye dhe bindje, sepse po qe se kjo sasi e ujit që do të derdhej në Lumin Vardar do të përdorej për prodhimin e energjisë elektrike nuk është argument bindës, sepse kjo sasi e ujit mund të përdoret siç po përdoret edhe tani për prodhimin e energjisë elektrike duke u derdhur në Liqenin e HC të Spiles, ku po ashtu prodhohet energji elektrike. Kështu që, sa i takon çështjes së prodhimit të energjisë elektrike duke marrë ujë nga lumi Radikë për në HC "Fusha e Llukovës, argumenti nuk qëndron. Me siguri në prapaskenë ekziston diçka tjetër. Përfaqësuesi i Bankës Botërore u bind lidhur me këtë argumentim.

Përfaqësuesi i "Elem"-it, na irritoi më së tepërmi, sepse në pyetjen që i parashtruam, se a keni marrëveshje me Shqipërinë për këtë çështje, pasi unë e dija se marrëveshje e tillë nuk ekziston. Mëngjesin e asaj dite që u bë ky takim unë për këtë gjë u konsultova me përfaqësues të Qeverisë së Shqipërisë. Përfaqësuesi i "Elem-it" tha se, ekziston një marrëveshje e vitit 1963. Kjo do të thotë se kemi të bëjmë me një marrëveshje me Shqipërinë nga viti 1963, marrëveshje e një shteti që ka vdekur, të një shteti që nuk ekziston, të një shteti që na irriton, të një shteti që s'mund të jetë e vlefshme asgjë nga ajo periudhë. Por ai si shkak e merrte se gjoja kjo ide thirret në atë marrëveshje. Si do që të jetë unë kisha obligim moral, obligim të popullatës, vendit të punës, postit si kryetar i Komunës, që të gjithë ata i kundërshtova me fakte, me bindje, se po të realizohet ideja e ndërtimit të HC Fusha e Llukovës, më nuk mund të flitet për florën dhe faunën të Radikës, nuk mund të flitet për Radikën, por mund të flitet për një lum që do të shndërrohet në një përrua të thatë që nuk do të ketë ujë. E përfundova prononcimin tim me atë se duke gërshetuar atë momentalen, me tradicionalen, se gjithçka në jetë njeriu mund të fal, mund te japë, por ujin dhe gjakun nuk e fal, ngase me ujin mbijeton rasa njerëzore, rasa bimore dhe shtazore, ndërsa me gjakun jetojmë të gjithë ne. Këto janë gjëra që nuk mund t'i fal unë dhe askush, nuk e ka guxim dhe të drejtë që këto t'i merr dhe këto t'i dhurojë për një çështje politike, apo për një çështje interesi parcial, momental. Si do që të jetë historikisht Radika është e Dibrës dhe duhet të derdhet në Drinin e Zi dhe të vazhdojë rrugën e mëtejshme për në Detin Adriatik. Ky është qëndrimi zyrtar i kryetarit të Komunës së Dibrës", tha Lata.

I pyetur për hapat që duhet të ndërmerren në të ardhshmen, kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe tha se "Sa u takon hapave të mëtejme për pengimin e realizimit të ndërtimit të HC "Fusha e Llukovës", së pari unë vetë e bëra prononcimin, dhe pastaj duke respektuar dhe falënderuar komplet Këshillin Komunal të Dibrës. KK mbajti një mbledhje të veçantë me pikë të posaçme të rendit të ditës, ku këshilltarët morën të njëjtin qëndrim, se ne jemi kundër këtij investimi të këtij sistemi dëmtues për qytetin dhe rrethin e Dibrës. Njëkohësisht për këtë vendim, u dërguam informacion Bankës Botërore, Ndërmarrjes për prodhimin e energjisë elektrike të Maqedonisë, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkësisë Europiane, Qeverive të Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës, dhe të gjithë asociacioneve relevante politike që funksionojnë dhe punojnë në Maqedoni. Deri tash është ky proces, kjo mundësi që si njerëz të kulturuar ta shfrytëzojmë anën ligjore, anën e rezistencës dhe kundërshtimit të arsyeshëm që mos bëhen këto shpenzime investuese më kot, ngase diku sjellin dobi, diku sjellin dyfish ose trefish më shumë dëm. Varësisht nga situata, normalisht me kryetarin e Këshillit të Komunës, me këshilltarët dhe qytetarët, do të konsultohemi për hapa të mëtejshme, që me çdo kusht këtë veprim dhe marrje të këtij uji ta ndërpresim.", deklaroi në fund Mr.Ruzhdi Lata.

- **Qytetarët e Komunës Dibër REAGOJNË ASHPËR dhe janë KATEGORIKISHT KUNDËR realizimit të projektit Energjetik Fusha e Llukovës.**
- **- Projekti Energjetik Fusha e Llukovës ndikon negativisht në mjedisin jetësor dhe biodiversitetin në hapësirë që ka vlera mjaft të veçanta, bën devijimin e rrjedhës natyrore të ujërave të lumit Radika dhe riorienton ujin nga Pellgu i Drinit në atë të Vardarit.**
- **- Ky projekt nuk është në përputhje me Konventën Ndërkombëtare të ujërave (për ndërrimin e rrjedhës së ujërave) sepse ka ndikim në disa shtete.**
- **- Zvogëlimi i sasisë së ujërave si pasojë e kapjes dhe riorientimit të tyre në Pellgun e Vardarit do të sjell dëme të pariparueshme për popullatën dhe mjedisin në rrjedhën e poshtme të Radikës. Kjo dukshëm do të zvogëlon rrjedhën e Radikës, zvogëlon mundësinë për realizimin e projekteve meliorative për zhvillimin e bujqësisë.**
- **- Zvogëlimi i sasisë se ujit në rrjedhën e Radikës do të degradojë vlerat e lumit si një ndër lumenjtë më të pastër në vend dhe grykën piktoreske ku kalon ky Lum dhe si rezultat i kësaj zvogëlohen dhe vlerat turistike të rajonit.**

Këshilli i Komunës në Dibër të Madhe kundërshton marrjen e ujit nga Lumi Radikë

Këshilli i Komunës në Dibër të Madhe, në një mbledhje të saj, mori në analizë "shqyrtimin e projektit energjetik Fusha e Llukovës për marrjen e ujërave të malit Korab që derdhen në Lumin Radikë'.

Prof.dr. Abdyl Koleci, veç tjerash theksoi se: "Padrejtësia ndaj Dibrës është bërë qysh në vitet e '50 të Shekullit të XX gjatë ndërtimit të Liqenit të Mavrovës mbi bazën e Marrëveshjes së dëmshme ndërmjet ish Jugoslavisë dhe Shqipërisë për shfrytëzimin e ujërave të Lumit Radikë. Aso kohe nga rrjedhja e Lumit Radikë është lejuar që të merren 9 metër kub ujë dhe të drejtohen për mbushjen e Liqenit të Mavrovës. Tani me ndërtimin e Liqenit në Fushën e Llukovës kërkohet të merren edhe 4 metra kub ujë në sekondë nga Lumi Radikë, ujë i cili sikurse edhe me Liqenin e Mavrovës do te derdhet në Lumin Vardar. Kjo do ta dëmtonte shumë rëndë biodiversitetin e grykës të Lumit Radikë, i cili gjatë stinës së verës ka 5-10 metër kub ujë në sekondë. Shtryrja territoriale e Dibrës ka qenë deri në fshatin Duf të Gostivarit. Me katër ndarjet territoriale të komunës së Dibrës që nga çlirimi e gjer më sot, i është marrë shumë territor dhe burime ujore. Lumi Radikë dhe ujërat e tij u takojnë të gjithë nacionaliteteve që jetojnë në komunën e Dibrës. Marrja sërish e ujërave nga Lumi Radikë do të shkaktojë edhe dëm të madh ekonomik. Edhe me ndërtimin e liqenit të Dibrës u mbulua toka e Udovës, hambari i Dibrës, ndërsa bujqve për çdo metër katror iu pagua një çmim minimal, sa çmimi i një akulloreje. Edhe Stacioni i motopompave për ujitjen e fushës së Dibrës është shkatërruar. Tash e 10 vite bujqit dibran nuk kanë mundësi ti ujisin tokat e tyre".

Inxhinier Rexhep Qormemeti theksoi se "Ndërrimi i rrjedhjes natyrale të ujërave është i palejueshëm edhe me Konventën Ndërkombëtare, por edhe me Ligjin e Maqedonisë për shfrytëzimin e ujërave. Për ti shfrytëzuar ujërat e Lumit Radikë duke ua ndryshuar rrjedhën natyrale dhe duke i orientuar në drejtim të Vardarit dhe të Detit Egje, Maqedonia Parkun e Mavrovës e ka shndërruar në kategori më të ulët për ti arritur këto qëllime të saja. Me Marrëveshjen e viteve të '50 ndërmjet ish Jugosllavisë dhe Shqipërisë është parashikuar që për ndërtimin e Liqenit të Mavrovës të shfrytëzohet 70% e ujërave të Lumit Radikë, duke ua ndryshuar drejtimin nga Deti Adriatik për në Detin Egje. Aktualisht 4 metra kub ujë në sekondë nga Lumi Radikë shkon për në Liqenin e Mavrovës e më pastaj derdhet në Lumin Vardar. Me ndërtimin e Liqenit në Fushën e Llukovës kërkohet që nga Lumi Radikë të merren edhe 4 metra kub ujë nga Lumi Radikë, duke shfrytëzuar dhe devijuar rrjedhjen edhe të përrenjve të Korabit. E tërë kjo u shkakton dëme të mëdha Komunës së Dibrës, Qendrës së Zhupës dhe Rostushës, Komunave qe më parë kanë qenë në administrim të Dibrës. Këto kapje të padrejta të ujit të Radikës do të shkaktojnë dëme të mëdha duke shkaktuar shkatërrimin e biodiversitetit, dëme në zhvillim e turizmit dhe të bujqësisë.

Ndërtimi i Liqenit në Fushën e Llukovës nuk ka aq leverdi elektroenergjetike, por qëllimi është që ujërat e Radikës në vend që të shkojnë me rrjedhje të natyrshme nëpërmjet Drinit të Zi për në Detin Adriatik, tentohet që këto ujëra të shkojnë në Lumin Vardar dhe në Detin Egje.

Autoritetet e pushtetit vendor në Dibër duhet ti shfrytëzojnë të gjitha mekanizmat që Maqedonia të heqë dorë nga grabitja e paligjshme e ujërave të Radikës. Për ndryshe dibranët do të jenë të detyruar ti drejtohen Gjykatës Ndërkombëtare në Strasburg".

Këshilltarët pjesëmarrës nga pozita dhe opozita me diskutimet e tyre ishin kundër shfrytëzimit të ujërave të Lumit Radikë për hidrocentrale dhe ndërrimin e rrjedhjes së natyrshme në vend drejt detit Adriatik, kundërshtonin derdhjen e këtyre ujërave në liqenin e Mavrovës dhe në lumin Vardar. Përfaqësuesit e OJQ- ve dhe Shoqatat ekologjike dhe të peshkimit theksuan se ky shfrytëzim i pa drejtë i ujërave të Lumit Radikë do ta asgjësojë biodiversitetin, do ta zhdukë edhe troftën karakteristike dibrane, dhe do ta shndërrojë lumin Radikë në një kënetë, si burim i shumë sëmundjeve infektuese.

Nga kjo seancë u vendos që Qeverive të Maqedonisë, të Shqipërisë dhe të Kosovës, Bankës Botërore, Ministrisë së ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor, Ministrisë së transportit dhe lidhjeve, Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë se ujërave, ELEM-it si dhe institucioneve përkatëse, tu dërgohen letra me konkluzionin se "Këshilli i Komunës Dibër e Madhe, Ruzhdi Lata si kryetar i komunës së Dibrës së Madhe dhe shoqatat joqeveritare në Komunë, si dhe mbarë qytetarët e Komunës Dibër REAGOJNË ASHPËR dhe janë KATEGORIKISHT KUNDËR realizimit të projektit Energjetik Fusha e Llukovës. Projekti Energjetik Fusha e Llukovës ndikon negativisht në mjedisin jetësor dhe biodiverzitetin në hapësirë që ka vlera mjaft të veçanta, bën devijimin e rrjedhës natyrore të ujërave të lumit Radika dhe riorienton ujin nga Pellgu i Drinit në atë të Vardarit. Ky projekt nuk është në përputhje me Konventën Ndërkombëtare të ujërave (për ndërrimin e rrjedhës së ujërave) sepse ka ndikim në disa shtete. Zvogëlimi i sasisë së ujërave si pasojë e kapjes dhe riorientimit të tyre në Pellgun e Vardarit do të sjell dëme të pariparueshme për popullatën dhe mjedisin në rrjedhën e poshtme të Radikës. Kjo dukshëm do të zvogëlon rrjedhën e Radikës, zvogëlon mundësinë për realizimin e projekteve meliorative për zhvillimin e bujqësisë. Zvogëlimi i sasisë se ujit në rrjedhën e Radikës do të degradojë vlerat e lumit si një ndër lumenjtë më të pastër në vend dhe grykën piktoreske ku kalon ky Lum dhe si rezultat i kësaj zvogëlohen dhe vlerat turistike të rajonit. Projekti nuk ka argumente të forta ekonomike që do të arsyetonte leverdinë ekonomike në raport me ndikimet dhe pasojat negative dhe nuk jep mundësi për zgjedhjen e alternativave tjera për realizimin të qëllimit themelor të Projektit (prodhimin e energjisë elektrike)", thuhet në fund të këtyre konkluzioneve.

Bashkim Mashkulli, kryesues i Këshillit Komunal në Dibër të Madhe lidhur me këtë problem tha për gazetën "Rruga e Arbërit" se, "Kjo është një politikë antishqiptare dhe kundër interesave të dibranëve në këtë shekull. Është nisur më në fund edhe një projekt tjetër dëmprurës. Partitë politike me anë të të zgjedhurve të vet në Këshillin Komunal dhe shoqatat jo qeveritare e thanë prerazi se janë kundër këtij projekti. Nëse ky projekt nis të realizohet këshilltarët e KK do të organizojnë protesta qytetare. Lumi i Radikës për veç se është sinonim i qytetit tonë, ai është edhe vetë jeta jonë. Marrja e ujërave të lumit Radikë rrezikon që në një të ardhme të shpejtë kjo zonë përkundër burimeve të shumta ujore të mbetet edhe pa ujë të pijshëm. Ne shpresojmë se Qeveria e Shqipërisë do të ndalojë realizimin e këtij projekti, sepse edhe me konventat ndërkombëtare rrjedhjet natyrore të lumenjve nuk mund të ndryshohet. Ky është ndoshta rasti i parë në botë ku lumi i merret një qyteti siç është rasti me Dibrën, dhe duke ia ndryshuar rrjedhjen uji dërgohet në drejtim të Shkupit, gjë që është e palejueshme, i merret pellgut të Drinit të Zi dhe Shqipërisë dhe i dërgohet Greqisë. Shpresojmë se edhe Bashkia e Peshkopisë do të ndikojë te qeveria e Shqipërisë që ky projekt i dëmshëm i Maqedonisë të mos realizohet".

reportazh



Një foto e bukur e Bulqizës nga Maja e Lepurit. Por Bulqiza ka shumë nevojë të shihet nga afër për hallet e mëdha që ka në jetën e përditshme të banorëve të saj.
Foto © Mahir Jangulli

Bulqiza **e pasur**, me njerëz **të varfër**

Nga **SHAQIR SKARRA**

Disa herë më ishte lutur Qëndrim Mjeshtri, një miku im nga Bulqiza që të udhëtoja një ditë nga Tirana e të shkoja në qytetin minator të Bulqizës, të shikoja vërtet një realitet krejt ndryshe nga sa ishim mësuar ta njihnim Bulqizën para viteve nëntëdhjetë. Jo që nuk kisha qenë, por nuk më ishte dhënë rasti të qëndroja gjatë, të shëtisja nëpër lagjet e qytetit e të ngjitesha edhe te galeritë, tek ato galeri që nëpër zgafellat e frikshme të nëntokës bulqizakët, duke vënë jetën e tyre në rrezik, nxjerrin mineralin e kromit dhe vetëm kaq. Më shumë nuk dinë. Nuk dinë as se kush e ka në pronësi minierën, ku tregtohet kromi, për çfarë shërben dhe thonë si nën zë se pikërisht nga ky mineral i përhimët kromi del dhe një përqindje ari. Po, po safi flori. Rrezet e diellit dukeshin fare mirë në majë të Dhoksit kur makina me të cilën, po udhëtoja po rrëshqiste drejt Bulqizës. Edhe pse ende herët, qyteti ishte zgjuar, qepenat e dyqaneve ishin hapur e në rrugë kishte filluar ajo lëvizja e pakët karakteristike vitet e fundit. Në lokale gjeje pak veta që më së shumti tymosnin duhan e ndiqnin titujt e gazetave këtë mëngjes gushti se sa kishin filxhan me kafe apo gotë me raki përpara. Nuk e pata të vështirë ta gjej mikun tim Qëndrimin pasi qyteti është i vogël e banorët e njohin fare mirë njëri-tjetrin. Pikërisht, te lokali që e kishim lënë një ditë sipas bisedës që bëmë në telefon po më priste mua. Qëndronte më këmbë tek një derë e vogël që në dukje nga larg kuptoje se ishte një lokal i vogël, i thjeshtë dhe me një klientelë të përhershme ku ato pak tavolina ishin mbushur. Lokali ishte në pronësi të Qëndrimit, i cili punonte vetë nga mëngjesi deri në darkë vonë e në fund fitonte sa për një rrogë të vogël mujore.

PAK HISTORI

Qëndrimi është banor i hershëm i këtij qyteti, lindur, rritur dhe arsimuar në këtë qytet e sot e ka të vështirë të shkëputet e t'i kthejë shpinën që në fakt mjaft qytetarë të Bulqizës vitet e fundit e kanë braktisur qytetin dhe janë larguar dikush në emigracion e dikush në vende të tjera për një jetesë ndryshe. Historia e Bulqizës është e vonë, nis e tregon Qëndrimi. Jo vetëm unë por të gjithë bulqizakët e dinë historinë e qytetit të tyre që u bë i njohur jo vetëm në vendin tonë por në mbarë botën për mineralin e kromit që fshihte në thellësi nëntoka e saj. Ishin vitet 1948-1949 kur këtu u ngritën barakat e para e nëntoka e Bulqizës filloi të shfrytëzohej në fillim nga italianët. Ishin vetë bulqizakët që në arë gjetën ca mademe (kështu u thoshin mineraleve atëherë). Kishin parë në arat e tyre copa nga këto mademe në ngjyrë të përhimët ku në rrezet e diellit bëheshin me pika të ndritshme si ari. Italianët i morën pikërisht këto gur dhe vendosën të hapnin galeritë e para për ta marrë e përpunuar këtë lloj guri që fshihte nëntoka e Bulqizës. Deri atëherë nuk njihej Bulqiza, nuk ishte as qytet. Njihej në histori para, gjatë dhe pas Skënderbeut por nuk kishte asgjë të veçantë që ta dallonte me vendet e tjera, përkundrazi shquhej si vend tepër i ftohtë në stinën e dimrit ku populli e quante si vendlindjen e erërave të mëdha. E qyteti u ngrit shpejt. Nga barakat e para filluan të hedhin shtat pallatet, shkollat, objekte të tjera social kulturore. Bulevardet zgjateshin , trotuaret e gjelbërimi i dhanë një pamje të bukur këtij qyteti të ri futur mes maleve. Një qytet krejt i ri ku në çdo orë të ditës e natës kishte gjallëri. As që bëhej fjalë për papunësi. Burrat në minierë me turne e gratë në fabrikën e pasurimit të kromit, në ndërmarrjet tregtare e qendra të tjera kulturore. Në darkë qyteti gumëzhinte e pallati i kulturës po thuaj çdo natë jepte koncerte të ndryshme. Vinin shpesh dhe trupa profesioniste nga rrethe të ndryshme të vendit në Bulqizë për të dhënë shfaqje për minatorët. Këtu dhe vetëm këtu rrugët nuk kishin qetësi por dhe dritat në pallate nuk mund t'i gjeje fikur. Dikush shkonte në punë në turnin e tretë e dikush kthehej nga puna. Autobuzët ishin në lëvizje të vazhdueshme. Sillnin dhe merrnin nga fshatrat minatorët që linin dhe shkonin në punë. Të njëjtën lëvizje kishte dhe Qafa e Buallit e cila jo vetëm ditën por dhe natën oshëtinte nga boritë e makinave të kromit që udhëtonin drejt stacionit hekurudhor të Laçit. Populllsia shtohej në qytet, vinin nga zona të

> Ashtu siç është katandisur sot miniera e kromit në Bulqizë ka mbetur vetëm që administrimi i minierës të bëhet nga vendasit, nga ata që e njohin më mirë Bulqizën me nëntokën e saj të pasur.

ndryshme të vendit për të punuar në minierën e kromit dhe vetëm pak vite ma vonë sillnin dhe familjet në këtë qytet të ri. Kështu shumë shpejt qyteti minator për nevoja emergjente në strehim të minatorëve u nda në dy pjesë ku vetëm pak metra ma poshtë e përballë qytetit të Bulqizës, rrëzë malit u ngrit një tjetër qytet i ri ku bulqizakët ende e quajnë "qyteti i ri". Pra Bulqiza rritej dita ditës e popullsia e gjitha heterogjene shtohej. Vinin minator e inxhinier, gjeolog e teknik ndërtimi, kuadro të ndryshëm e ushtarak. Vinin nga ana e anës dhe shumë shpejt ambientoheshin me erërat e mëdha e zhurmat karakteristike në këtë qytet të vogël malor. Bulqiza ishte i vetmi qytet në ato vite ku nuk njihej dita apo nata. Këtu në çdo kohë e orë punohej e qyteti kishte gjallëri.

VDEKJA NUK ËSHTË FJALË E HUAJ PËR MINATORËT

Ende nuk e kishim mbaruar kafen kur nga një televizion kombëtar aty në lokal me titra lexojmë se minatori Mustafa Kola është aksidentuar në galeri. Ishte pikërisht pesha e rëndë e vagonit të kromit që i kishte prerë këmbën. Lokali u boshatis në çast dhe të gjithë u drejtuan drejt spitalit të Bulqizës. U nisëm dhe ne pasi Qëndrimi e mbylli lokalin. I plagosuri ishte 49 vjeçari Mustafa Kola, i cili punonte në nivelin e 15 të pusit nr1. Brenda dhe jashtë spitalit plot njerëz ku të gjithë kishin ardhur të interesoheshin për gjendjen e minatorit të plagosur. Kishte ardhur dhe vetë policia që të hulumtonte mbi shkaqet e aksidentit. Në sytë e familjarëve të minatorit të plagosur kishte lot por dhimbja ishte e të gjithë të pranishmëve që ndodheshin aty. Bulqizakët në të tilla raste gjithmonë janë bashkë pasi vdekjet dhe aksidentet në minierë janë të shpeshta e duke u ndodhur pranë njëritjetrit duket sikur e ndajnë dhimbjen. Edhe pse në gjendje të rëndë shëndetësore ku nga çasti në pritej helikopteri të vinte në Bulqizë e ta transportonte drejt spitalit ushtarak për një shërbim mjekësor më të specializuar, minatori i plagosur nis e u tregon të pranishmëve: -"Këtë radhë më zuri fatkeqësia mua por kjo fatkeqësi mund të ishte e shokut tim ashtu siç ka ndodhur shpesh në galeri". Ai tregon se si i ndodhi aksidenti, se si vagoni me dy ton krom ka marrë shpejtësi duke i këputur atij këmbën." Ishim katër punëtorë. Na ra vagoni në kanal dhe duke e ngritur tre punëtorët po e shtynin nga prapa, ndërsa unë isha përpara duke e prerë. Ndoshta ju shmangëm përgjegjësisë dhe nga pakujdesia bëri që vagoni të merrte shpejtësi të madhe. Në atë moment unë u mundova të largohesha se do të më këpuste në mes. Në fakt u largova me trup por më mbeti këmba aty që mu këput nga pesha e rëndë e vagonit mbushur me mineral kromi. Vdekjen e kisha fare pranë. Më shkëputën shokët e mi nga kthetrat e saj. Po sa jetë minatorësh ka marrë vdekja në këto zgafella të frikshme. Para pak ditësh mori një shokun tonë. Edhe unë fatin e tij do kisha. Shokët më sollën në jetë për së dyti duke më sjellë shpejt në spital. Vdekja është e pranishme kudo e kurdoherë pranë nesh. Futemi me të në galeri e kur dalim i gëzohemi se Zoti na fali dhe një ditë jetë, e mposhtëm dhe një ditë vdekjen. Pra vdekja nuk është më një fjalë e huaj për ne minatorët. Mustafai shprehet se ka punuar gjithsejt 24 vjet si mekanik dhe brigadier e tashmë si punëtor i thjeshtë."Mbas 24 vitesh pune tashmë jam manovrues vagonash. Kjo punë në fakt nuk ka asnjë lloj sigurie por jemi të detyruar të punojmë që të ushqejmë fëmijët".Në fakt Bulqiza vitet e fundit është bërë objekt lajmesh të përhershme mbi aksidentet e shumta dhe humbjet e jetëve të minatorëve e gjitha kjo si shkak i mungesës së kushteve të punës dhe të investimeve për modernizimin e mëtejshëm të minierës. Në minierën e Bulqizës jeta e minatorëve çdo ditë është në fije të perit.

JETË MBI DHE E NËN DHE

U larguam nga spitali i Bulqizës me një ndjenjë frike dhe paniku për këto që pamë duke e lënë minatorin e plagosur në pritje të helikopterit. Ky nuk është rasti i parë, as i fundit, thyen heshtjen Qëndrimi. Në fakt vetëm në Bulqizë ndodh që "të mëdhenjtë pasurohen e punonjësit e thjeshtë rrezikojnë jetën nga dita në ditë duke punuar si skllevër për të ushqyer fëmijët e tyre. Bulqiza është qyteti minator më i rëndësishmi në vendin tonë për nga rëndësia që ka minerali i kromit. Nëntoka e saj edhe pse e shfrytëzuar pa kriter vitet e fundit ende ruan shtresa të mëdha kromi të pa zbuluara. Këtu sot e gjashtëdhjet vjet ma parë, qysh kur u hapën galeritë e para ka jetë mbi dhe e nën dhe. Këto kohë i është dëgjuar ulërima e një heshtje të gjatë qytetit minator të Bulqizës. Është ulërima e njerëzve të qetë, e njerëzve punëtorë, që nis fill në galeritë e harruara dhe dëgjohet shpesh në valët e radiove, shihet në ekranet e televizioneve e mbush po thuaj çdo ditë faqet e gazetave. E s'ka si të jetë ndryshe. Kjo është jehona e sakrificës, e djersës, e gjakut, e bukës së fëmijëve. Bulqizakët flenë mbi pasuri e gdhihen të varfër ndaj çdo minator duhet ta pyes veten: Çfarë shekull i shanseve të barabarta është ky, ku djersa pihet, gjaku shtypet e njeriu ndrydh njeriun dhe e shëndron atë në kafshë pune? E ç'shekull i qytetërimit është ky, ku puna është skllavëri e bëhet në minierë me mjete tej primitive, sikur ora e botës të mos ketë shkelur kurrë në këtë qytet? Të ther në shpirt ai vështrim nga qielli me shpresën se sytë do e shohin dhe nesër dritën e diellit. Ata jetojnë me vdekjen, çohen e bien me të bile shpesh herë ia kanë dëgjuar dhe zërin e kobshëm. Për çdo ditë e kanë mbi krye që me zbardhjen e ditës e deri sa errësira mbulon gjithçka. Pavarësisht gjithçkaje, shpirti i tyre nuk përkulet lehtë, këmbët nëse iu mbajtshin hekur i bëjnë, duart nenës iu këputshin, gur i bëjnë. Punojnë ku të munden, jashtë e brenda minierës, në shi e acar, pa kurrfarë kontrate dhe jo vetëm por edhe gratë e fëmijët e vegjël me kosha e trasta mbi shpinë me ditë të tëra mbledhin gur kromi në sipërfaqe. Ky në fakt qenka ligji i pa shkruar i kapitalizmit të tejskajshëm. Njeriu ngrihet mbi veten rilind për një të ardhme më të mirë, për mirëqenie ekonomike, njësoj si njeriu i Niçes. Por fatkeqësisht, edhe me këtë forcë, më e fortë se forca vetë, minatorët mbeten sërish të dobët, për deri sa vendi ynë përpëlitet nga gjendja e keqe ekonomike.

BULQIZAKËT SHPRESOJNË

As vetë nuk e kuptova se sa shpejt iku dita në Bulqizë. Qëndrim Mjeshtri e mbylli lokalin dhe gjatë gjithë ditës qëndroi me mua. E them sinqerisht, me dhimbset Bulqiza, thotë Qëndrimi, ky qytet që bëri emër për gadi gjashtëdhjetë vjet tashmë është katandisur si mos më keq. Kishte urrejtje, mllef dhe keqardhje Qëndrimi. Mua m'u kujtua thënja e një mikut tim inxhinier miniere që pas viteve nëntëdhjet tekstualisht më pati thënë: "E di se kromin e Bulqizës kinezët e marrin me na bë qejfin ne dhe në fakt e përdorin në vend të çakullit me shtruar rrugët në Kinë". Mendjeshkurtri inxhinier! Me çfarë logjike fliste. Pak gur e çakull kishin malet e Kinës sa u duhej të blinin shtrenjtë kromin e Bulqizës për të shtruar rrugët, thjeshtë për t'i bërë qejfin udhëheqjes së atëhershme. Edhe atëherë kromi i Bulqizës ishte krom i pastër dhe që kishte e vazhdon të ketë një përdorim të gjerë në industri. Sot është rritur çmimi i kromit në tregun botëror por sot kromi nuk është më pasuri e Bulqizës dhe bulqizakëve, është pasuri e mafies së kromit. Ashtu siç është katandisur sot miniera e kromit në Bulqizë ka mbetur vetëm që administrimi i minierës të bëhet nga një firmë vendase. Pikërisht ato që e njohin më mirë Bulqizën me nëntokën e saj të pasur. Por që administrimi të bëhet nga një firmë shqiptare duhet në radhë të parë që të kemi dhe një shtet të fuqishëm financiar. Kaq kërkojnë buqlizakët. Aktualisht sot zinxhiri ACR-shtet-minator ka hallkë të dobët vetë shtetin pasi ai është i vënë nën presion nga të dyja palët. Dua me gjak e zemër që Bulqiza të jetë e bulqizakëve dhe jo qyteti i pasur me njerëz të varfër, që të mos ngrihet më pasuria e dikujt mbi ngrehinat e skamjes së tjetër kujt! Megjithatë bulqizakët shpresojnë, shpresojnë shumë se Bulqiza jo veten e saj por do të ndryshojë dhe krejt ekonominë e kombit!

Rruga e Arbërit nr. 88

bujqësi

Një ndër problemet me madhore të fermës në vendimmarrjen e fermës është çfarë të prodhojë dhe sa të prodhojë.

Sfidat e bujqësisë, vendet e reja

Nga **DALI HORESHKA ***

Është mjaft normale dhe kontribut që me përgatitjen e fillimit të punës së një qeverie të re dhe për pasojë edhe të Ministrisë së Bujqësisë, të rifillojë edhe procesi i diskutimeve për çështjet e zhvillimit të bujqësisë, për të ndihmuar në një vendimmarrje sa më cilësore dhe efektive e lidhur me dhe në drejtim të zhvillimit të saj. Në këtë kuadër, edhe unë, si specialist i bujqësisë me një përvojë 28-vjeçare, po paraqes disa mendime me cilat synoj të bëj më të mundur **informimin orientues të politikës për të marrë vendime e fokusuar në drejtimet kryesore dhe përqendruar forcat kryesore në zhvillimin e bujqësisë.**

ÇFARË KËRKON TREGU QË TË PRODHOJË FERMA IME?

Një ndër problemet me madhore të fermës në vendimmarrjen e fermës është çfarë të prodhojë dhe sa të prodhojë. Zgjidhja e këtij problemi bëhet nëpërmjet një komunikimi midis tregut/konsumatorit dhe fermës për të kuptuar madhësinë e kërkesës së tregut Mekanizimat për ta realizuar zgjidhjen janë specialistët e tregut të drejtorisë së bujqësisë dhe organizimi i fermerëve në shoqata të produkteve të veçanta. Mjeti për ta realizuar këtë janë studimet dhe vrojtimet e herëpashershme të tregut brenda trekëndëshit: import-eksport dhe nevojë e brendshme.

Risia që mund të sillet në lidhje me nevojat e brendshme është **bilanci zonal mbi nevojat për produkte dhe kapaciteti prodhues e tregtues.** Ka mjaft raste kur edhe pse bilanci total midis kërkesave dhe mundësive të prodhimit është pa tepricë, gjejmë zona të veçanta që nuk e prodhojnë një produkt të caktuar dhe aty mund të zhvillohet mjaft mirë tregu i x produkti. Kjo do të kërkonte **adresimin e nevojave për një prodhim, prodhimin real dhe mundësitë prodhuese**, adresim me të cilën mund të komunikohet me biznesin për të mbushur këto zona. Lidhjet e prodhimit me tregun janë pjesë e domosdoshme e suksesit të së nesërmes. Wb-site-i i Ministrisë së Bujqësisë duhet të përmbajë në mënyrë periodike studime të ndryshme që janë bërë për tregun e produkteve të ndryshme, duke i dhënë tregut një rëndësi gjithnjë e më të madhe. Jo vetëm kaq, por për pjesën e fermerëve që mendohet se nuk informohen nga ky kanal, të mbështetet komunikimi direkt i këtyre studimeve.

Parë edhe në lidhjet import eksport, kërkesat për fruta, mish e sidomos të imtash, bimë mjekësore, arra dhe sidomos kur këto janë të vërtetuara si natyrale (pa shkuar më tej të themi organike) janë të mëdha.

A I KA KUSHTET FERMA IME?

Ballafaqimi i kërkesave që ka një bimë për t'u kultivuar apo kafshë për t'u mbarështuar me kushtet tokësore dhe klimatike të zonës, japin mundësinë për të gjykuar mbi një mundësi të tillë. **Hartimi i një harte të përshtatshmërisë mbi bazën e analizave është më se urgjente.**

Fermerët nuk kanë ku kryejnë analiza toke. Disponueshmëria e analizave të tokës përbën problem për zgjidhje dhe mundësi të hapjes së një biznesi për ato që i kanë njohuritë e nevojshme, në se ky problem mendohet të zgjidhet në rrugë private. Pas marrjes së një analize pedologjike vjen interpretimi i saj dhe receta e trajtimit të tokës për një bimë e pritje të caktuar rendimenti.

Me fjalë të tjera, **ky duhet të jetë rajonizimi i ardhshëm** dhe jo një mbjellje e sotme për ta shkulur pemën nesër.



Toka te mbjella me kulturën e misrit

Zgjidhjet prioritare të zhvillimit të bujqësisë?

1. Dokumentimi i pronësisë mbi tokën.
2. Zgjerimi i dukshëm i aftësisë ujitëse dhe fuqizimi i pronësisë menaxhuese.
3. Rritja e rolit dhe motivimit të shërbimit këshillimor dhe zgjerimi i games së shërbimeve këshillimore.
5. Ndërtimi i tregjeve rajonale.
6. Përmirësimi rrënjësor i strukturës së kulturave të fermës dhe i të ardhurave nga ajo.
7. Ulja e kostos së produkteve bujqësore.
8. Përmirësimi i imazhit të fermës dhe vlerësimi i saj në përmasa shumë më të mëdha tek institucionet financiare.
9. Përmirësimi i skemës së subvencionit duke ngushtuar përjashtimin e fermerëve që kontribuojnë në punësim dhe sigurimin e ushqimit në përmasa të caktuara dhe mbështetja e funksionimit të bankave bujqësore.
10. Rritja e cilësisë së inputeve bujqësore.



Ferma të reja me pemëtari

KUSHTET E PRODHIMIT DHE PAGESA PËR TO

Uji për ujitje, farat, fidanat, racat e kafshëve, rrugët bujqësore përbëjnë kushtet ku ndërsa ujitja dhe rrugët shpesh herë mungojnë dhe duhet investuar për to, farave, fidaneve dhe racave u ka munguar cilësia. Mjaft pemëtore të mbjella para tre-katër apo më shumë vjetësh kanë filluar të thajnë dhe shfaqin sëmundje me shkallë rreziku mjaft të lartë. **Kjo situate jo vetëm që ka nevojë të monitorohet e analizohet në tërësi, por kërkon një zgjidhje afatgjatë. Farat, fidanat dhe racat duhen prodhuar vetëm nga institucione të specializuara që garantojnë cilësi dhe efekt të lartë**. Çështja se si mund të ngrihen e funksionojnë këto institucione është për t'u diskutuar. Çmimet e tregut në vendin tonë, veçanërisht për fidanat dhe në raport me ato të rajonit, flasin për cilësinë e ulët të tyre. Vrojtimet flasin për një gatishmëri të fermerëve për të paguar më shumë për inpute më cilësore e të garantuara.

INSTITUTE KËRKIMORE-SHKENCORE DHE EKSPERIMENTALE NË RAJON

Biodiversiteti rajonal dhe dallueshmëria e rajoneve për produkte të caktuara bëjnë më se të domosdoshme që institutet kërkimore e shkencore dhe eksperimentale të kenë degët e tyre në rajone. Unë po sjell vetëm shembullin e bimëve mjekësore për të argumentuar një gjë të tillë. Fatmirësisht, QTTB e Shkodrës vitet e fundit ka vënë në fokus të punës së saj bimët mjekësore. Megjithatë, ajo mund të shtrihet në rajonet Lezhë-Shkodër-Tropojë dhe Kukës. Po ta vesh re me vëmendje në raportet dhe prezantimet e saj, Dibra zë një peshë mjaft të vogël në rëndësinë që i jepet asaj për shkak midis të tjerash të mosnjohjes së rajonit. Unë dua të përmend se Dibra është prodhuesi dhe grumbulluesi më i madh i Uva Ursit, potencial prej 2500 ha të boronicës, potencial prej mbi 500 ha të shërbelës etj. A nuk janë këto tregues të mjaftueshëm për të thënë që është e nevojshme në Dibër një bazë e tillë kërkimore e shkencore? Nga bimët mjekësore në rajonin e Dibrës punësohen 2500 familje. Një zgjidhje e tillë do të krijonte mundësinë që në perspektive Dibra të mund të ketë 2500 ha të mbjellë me bimë mjekësore dhe mundësuar një punësim prej 5000 vetash. Megjithë sa thamë më sipër, edhe pse absolutisht eksperimentet duhet të bëhen nga institucione të specializuara dhe jo nga fermerët, vetëm këto institucione mund të çelin perspektiva të reja për punësim.

SHËRBIMI KËSHILLIMOR DHE STATUSI I TIJ

Është krijuar një traditë më se shkatërruese që ato që vijnë në pushtet zëvendësojnë specialistet si pa të keq, pa i vënë përballë atij që mendohet se duhet zëvendësuar një alternative krahasuese më të mirë. Unë mendoj se Dibra ka specialist kaq të mirë sa ato jo vetëm që duhen mbajtur në punë por duhen respektuar (Sigurisht nuk përfshij këtu ato që kanë reflektuar qëndrime persekutuese dhe antiekonomike). Disa nga treguesit për t'u konsideruar për marrjen e specialistëve të bujqësisë në punë do të ishin studimet, rekomandimet e dhëna, botimet, projektet e ndryshme dhe shkrimet në gazeta, punime shkencore për rritje të shkallës arsimore, eksperimentet etj.

Çfarë i nevojitet shërbimit këshillimor?

a) Struktura e shërbimit këshillimor. Në mendimin tim struktura e shërbimit këshillimor duhet të përfshije disa drejtime: prodhimin, tregun, projektet, standardet dhe statistikën. Pjesa e prodhimit të ketë dhe industrinë ushqimore. Ajo që ka qenë e dukshme deri tani tek shërbimi këshillimor ka qenë fakti se tregu dhe marketingu, megjithëse pjesë e përgjegjësisë këshillimore, nuk kanë qenë realisht pjesë e tij.

b) **Numri i specialistëve. Specialistët e bujqësisë** nuk **janë** barrë e tepërt për buxhetin kombëtar por **pjesë e domosdoshme e zhvillimit kombëtar**. Duke e konsideruar misionin e specialistëve të bujqësisë si krijues të vendeve të punës dhe garantues të së ardhmes së bujqësisë nëpërmjet rekomandimeve, këshillave dhe studimeve, specialistët e bujqësisë duhet të jenë të mjaftueshëm në numër për të dhënë shërbimin e nevojshëm këshillimor. Vendet e rajonit kanë norma të ngarkesës për specialist dhe thjesht për efekt pamjaftueshmërie buxheti, nuk kemi pse nuk i përdorim ato. Minimalisht një specialist i fushës përkatëse për çdo komune duhet të punësohet për t'i shërbyer fermerit. Në mbështetje të argumentit dua të shtoj se një pjesë e kohës së specialistëve të bujqësisë është zënë me skemën e subvencionit. Deri më tani një specialist i bujqësisë mbulon me shërbim këshillimor mbi rreth 1000 ferma dhe ai shpenzon gjatë vitit jo më shumë se 50% të kohës efektive për shërbimin këshillimor.

c) **Cilës fermë duhet t'i shërbehet?** Opinioni im është se në se një madhësi e caktuar ferme e matur në ha ose numër krerësh ferma krijon një vend pune, për mua justifikon t'i shërbehet.

d) **Vendndodhja e shërbimit këshillimor,**

Zyrat drejtuese le ta kenë vendin e punës si deri më sot, tek drejtoritë ekzistuese të bujqësisë, ndërsa Qendrat e Informacionit Bujqësor, të jenë pranë komunave, por jo në vartësinë e tyre. Tendenca graduale të jetë për ta pajisur komunën me siguruesit e shërbimeve të nevojshme për bujqësinë. Sot për sot nuk e kemi përkushtimin dhe vizionin e drejtuesve lokal që të menaxhojnë edhe shërbimin këshillimor bujqësor.

e) **Kualifikimi i specialistëve.** Programimi dhe mbështetja e kualifikimit të specialistëve, jo me kurse afat shkurtër, por me periudha që garantojnë rritjen e mjeshtërive në shërbim të efektiviteti të matshëm përbën domosdoshmërisht një prioritet.

debat

Skema e subvencionit të marrë në konsideratë jo vetëm instalimin e investimeve por edhe efektivitetin e shfrytëzimit.

të punës dhe **siguria e ushqimit**



Shirja e grurit. Foto © B.Karoshi

Realizuesit e këtyre trajnimeve shumë mirë mund të jenë Universiteti Bujqësor, Institutet Kërkimore dhe Shkencore në bashkëpunim me Institucionet respektive të vendeve që kanë zhvillimin më të spikatur të fushës ku do të trajtohet specialisti.

Vitet e fundit vëmendja për të kualifikuar specialistët dhe monitoruar rezultatin apo cilësinë e këtij kualifikimi duket se ka qenë e papërfillshme. Mendimi këshillimor nuk i ka rezistuar ndryshimit klimatik për t'i dhënë këshillat e nevojshme fermës si dhe në shumë pak raste këshillimi bujqësor ka patur në përmbajtje të tij edhe mendimin ekonomik. Fjala vjen, shumë pak nga specialitet e bujqësisë janë të pajisur me njohuri mbi Analizën e Zinxhirit Vleror, si e vetmja metodë për të bërë të mundur orientimin e fermës mbi strukturën e mbjelljes. Ky kualifikim i sipërpërmendur duhet të jetë periodik dhe rreptësisht i programuar sipas sektorëve.

a) **Mbështetja e shërbimit këshillimor për lëvizjen me mjete transporti dhe logjistikën tjetër të nevojshme.** Unë e kuptoj që shtrimi i këtij problemi duket paradoksal, por katandisja e specialistëve të bujqësisë në atë farë feje sa të mos kenë një mjet që të lëvizin sipas programit, është fatkeqësi. Në të njëjtën gjendje ka qenë edhe Institucioni i AZHBR-së. Vetë fermerët kanë financuar lëvizjen e specialisteve me mjete transporti.

b) **Specialist për kultura të veçanta.** Tashme ka ardhur koha që të ketë specialist të veçantë për kultura të veçanta, madje duke u përpjekur të testohet edhe raporti i pranueshmërisë nga fermeri midis shërbimit këshillimor publik dhe atij privat. Mbështetja më e fuqishme e bujqësisë, e konceptuar si mbështetje edhe për shërbimin këshillimor, duhet të çojë në zgjerimin e shërbimit këshillimor me specialistë të tregut, industrisë përpunuese, kultivimit të bimëve mjekësore dhe manipulimit të tyre

c) **Matje e kostos dhe efektit të shërbimit këshillimor**,

Kam patur mjaft diskutime me specialistë të bujqësisë, blegtorisë e pedagogë të UBT në lidhje me matjen e kostos dhe efektit të shërbimit këshillimor, por kemi rënë në një mendje që ajo edhe pse është më se e domosdoshme, sot nuk bëhet. Mendoj se është koha për të mbështetur ngritjen e një praktike të tillë, duke e bërë realitet.

INVESTIMET EMERGJENTE

a) Sistemi i ujitjes. Është pjesa me nevralgjike e infrastrukturës së përmirësimit të prodhimit bujqësor. **Adresimi i mundësive të ujitjes dhe kostos së saj përbën hapin e parë.** Pjesa e kostos duhet ndarë më dysh: 1) Kostoja e shpronësimit me çmimin e tregut 2) Kostoja e veprës. Pas kësaj dhe më i rëndësishëm është menaxhimi i veprave ujitëse.

b) **Institucioni i projektimit dhe menaxhimit të veprave dhe ujitjes**. Mendoj se rikrijimi i ndërmarrjeve të ujërave dhe bonifikimeve, me një koncept të ri të misionit e funksionimit të tyre përbën një urgjencë. Ndër problemet me kritike të ujitjes në fazën e sotme janë: 1) rivënia në punë e rezervuarëve të mëparshëm, 2) Rivënia në punë e stacioneve të pompimit, 3) Adresimi i mundësive të reja për hapjen e kanaleve vaditëse me rrjedhje të lirë; 4) Adresimi i mundësive të reja të ndërtimit të rezervuarëve, lerave dhe stacioneve te pompimit; 5) Mbështetja në masë e futjes me skemat e kontrolluara në ujitjes me pika.

Çështja se cili do të jetë kufiri pronësor institucional i menaxhimit të kanaleve e ujërave nga komuniteti është për t'iu nënshtruar një debati, bazuar në treguesit e efektivitetit të deritanishëm.

c) **Ndërtimi i tregjeve të produkteve bujqësore dhe vendeve të zhvillimit të panaireve.** Të dhënat e deritanishme tregojnë se tregjet rajonalë përbejnë mbi 30% të tregut total të produkteve dhe se panairet janë aktiviteti që i ka shërbyer më së miri krijimit të tregjeve dhe zhvillimit të turizmit.

Projektimi i tyre fillimisht dhe pastaj financimi përbën një mbështetje në funksion të kthimit të bujqësisë në gjenerues të të ardhurave. Është për të të ardhur keq si shembull, që me gjithë trajtimet e herëpashershme, asnjë qytet i Dibrës nuk disponon treg fruta perimesh me standarde dhe as vend të zhvillimit të panaireve.

d) **Ngritja e stacioneve meteorologjike; të prognoze-**sinjalizimit dhe analizave të tokës.

e) **Mbështetja e sistemit rrugor bujqësor**, duke synuar lidhjen e prodhimit me rrugët kryesore në ato zona që nuk e kanë këtë sistem.

SKEMA E SUBVENCIONIT BUJQËSOR

Skema e subvencionit e aplikuar që nga viti 2007, mendoj se krijoi një eksperiencë të mirë e cila duhet shfrytëzuar edhe për të ardhmen. Pavarësisht efekteve pozitive dhe mënyrës së mbështetjes direkte të fermerit, mënyrës përgjithësisht korrekte të zbatimit nga specialistët, disa aspekte të saj duhen përmirësuar.

a) Buxheti midis rajoneve duhet t'i shërbejë zbutjes së disproporcioneve të shkaktuara deri tani.

b) Buxheti rajonal për kultura të veçanta të jetë kompetencë e Drejtorive të Bujqësisë.

c) Buxheti të zbusë shkallën e disproporcioneve të deritanishme midis zonave fushore-kodrinore dhe malore të vetë rajonit.

d) Skema e subvencionit të marrë në konsideratë shkallën e punësimit që krijon çdo kulturë e veçantë dhe për çdo kulturë që krijon një vend punë e lart, të subvencionohet në një masë të caktuar, referuar kostos së vendit të punës. Masa e buxhetit ka qenë shumë përjashtuese. Unë po përmend vetëm rastin e bimëve mjekësore. Sipërfaqja minimale e pemëtarisë së mbjellë për efekt aplikimi ishte 2 dynym ndërsa e bimëve mjekësore ishte 5. A nuk flet kjo për një pa arsyetueshmëri në marrjen e një vendimi të tillë? Me siguri që po.

a) Skema e subvencionit të marrë në konsideratë jo vetëm instalimin e investimeve por edhe efektivitetin e shfrytëzimit.

b) Skema e subvencionit të marrë në konsideratë edhe marrëdhëniet e fermës me ambientin.

c) Skema e subvencionit të shohë me kujdes raportet midis mbështetjes së fermës që prodhon për treg dhe asaj që vetëpunësoj dhe është për mbijetesë, duke synuar një raport jo përjashtues

d) Skema e subvencionit të mbështesë më shumë se deri tani sistemin e ruajtjes së prodhimeve dhe mekanizimin e bujqësisë e sistemin e rrugëve bujqësore

MBËSHTETJA E KRIJIMIT TË PROFESIONEVE BUJQËSORE DHE MOTIVIMIT TË MJESHTËRIVE TË FERMËS MODEL

Duke punuar për një kohë të gjatë në sistemin e bujqësisë, kam patur mundësinë të shoh problematikën kryesore të saj, si kyçe në zgjidhjen e një situate të caktuar. Disa profesione punësimi mungojnë në bujqësi, duke shtruar nevojën e krijimit të të rejave nëpërmjet kurseve një vjeçare. Kostoja e këtyre kurseve mund të ndahet në një proporcion të caktuar me sipërmarrësin. Unë mund të rendis disa profesione:

a) Bletërritës,
b) Përpunues qumështi,
c) Frutikulturist,
d) Mbrojtës bimësh,
e) Menaxhues frigoriferik,
f) Spërkatës,
g) Krasitës,
h) Agronom praktik i bimëve mjekësore.
i) Njohës i bimëve mjekësore dhe standardeve të grumbullimit e tregut.
j) Përpunues ushqimesh

Financuesi i përgatitjes së këtyre profesioneve të vendosë kusht në parim ndaj prodhuesit të profesioneve aftësinë e të trajnuarit për të prodhuar një produkt apo për t'i shërbyer një produkti. Sugjerimi i mësiperm nuk zëvendëson aspak nevojën për ngritjen e arsimit të mesëm profesional bujqësor.

Aspekti i dytë që unë vë re është suksesi i mjaft fermave, duke krijuar eksperienca mjaft të vlefshme në funksion në krijimit të punësimeve të reja duke e shtrire këtë eksperiencë. Shtrydhja, dokumentimi dhe motivimi i kësaj eksperience në funksion të shtrirjes së saj mendoj se është me mjaft interes dhe kërkon dakortësinë e një buxhetimi në të ardhmen.

Buxheti i Bujqësisë,

Di që rajoni i Dibrës nuk merr më shumë se 100-120 mln lekë në vit për bujqësinë. Nevoja për ta shndërruar bujqësinë në gjenerator punësimi kërkon që kjo shumë minimalisht të dhjetëfishohet. Atëherë unë garantoj se edhe efekti në punësim e të ardhura do të jetë jo me përqindje, por 10 fishi. Kush mbështet zhvillimin e bujqësisë dhe të pyjeve ka mbështetur zhvillimin e kombit.

STATISTIKAT E BUJQËSISË

Vënia në funksion e këtij institucioni që prej kohës ka funksionuar keq dhe pastaj nuk funksionon fare është emergjencë e ditës. Nuk mund të funksionoje statistika pa specialistin dhe raportimi i përgjegjshëm i të dhënave duhet të jetë pjesë e mandatit të një specialisti, por pa e kthyer atë kryesisht në funksion të statistikave.

Për të arsyetuar atë që them, unë pyes: në çfarë mase statistikat lokale i kanë shërbyer qeverisjes lokale për të marrë vendime? Sa e kanë orientuar ato fermerin në vendimmarrjen e tij? Sa kanë shërbyer statistikat lokale për të formuluar projekte e pastaj financuar investime me rëndësi lokale? Kjo do të thotë se mbështetja e statistikave të drejtuara e zbatuara nga profesionistët mbetet prioritet.

Ferma të mos ketë asnjë detyrim financiar, kontributi i fermës në punësimin dhe të ushqyerit meriton që jo vetëm të mos ketë detyrime, por të stimulohet, pasi është mburoja e qytetërimit.

Ndarja definitive e fermës nga biznesi detyron fermën të mbajë shënimet e aktivitetit të saj dhe të presë dokumente e t'i ruajë ato për prodhimet, pavarësisht në dalin apo nuk dalin në treg. Ndoshta është herët, por do të thoja që po vjen koha e pajisjes së fermerit me një regjistrues të thjeshtë të shpenzimeve dhe të ardhurave të tij. Kjo do të kërkonte deklarimin nga qeveria të mostaksimit dhe ruajtjes së privacisë së të dhënave. Ky lloj regjistrimi mund të ishte një kriter i përfitimeve nga mbështetja që qeveria do të bëjë në të ardhmen.

TVSH-ja e produkteve bujqësore,

Deri më sot biznesi bujqësor është shumë më i rënduar ekonomikisht se bizneset e tjera. TVSH-ja e zbritshme është 6% e vlerës së produktivitetit, kur për bizneset e tjera është 20%. A nuk është kështu bizesi bujqësor mbi 14% më i rënduar se bizneset e tjera?

Atëherë, me pak fjalë, cilat janë zgjidhjet apo prioritetet e zhvillimit të bujqësisë?

1. Dokumentimi i pronësisë mbi tokën.

2. Zgjerimi i dukshëm i aftësisë ujitëse dhe fuqizimi i pronësisë menaxhuese.

3. Rritja e rolit dhe motivimit të shërbimit këshillimor dhe zgjerimi i games së shërbimeve këshillimore.

5. Ndërtimi i tregjeve rajonale.

6. Përmirësimi rrënjësor i strukturës së kulturave të fermës dhe i të ardhurave nga ajo.

7. Ulja e kostos së produkteve bujqësore.

8. Përmirësimi i imazhit të fermës dhe vlerësimi i saj në përmasa shumë më të mëdha tek institucionet financiare.

9. Përmirësimi i skemës së subvencionit duke ngushtuar përjashtimin e fermerëve që kontribuojnë në punësim dhe sigurimin e ushqimit në përmasa të caktuara dhe mbështetja e funksionimit të bankave bujqësore.

10. Rritja e cilësisë së inputeve bujqësore.

Duke mos pretenduar se mendimet dhe konkluzionet e mia janë më të mirat, ftoj specialistët e bujqësisë dhe te interesuarit për çështjet e zhvillimit bujqësor të komentojnë mbi atë se çfarë unë kam shkruar.

** Ekonomist bujqësie*



Koshere bletesh.



Mollë.

Rruga e Arbërit nr. 88

Intervistë me shkrimtarin Xhafer Martini: Media, letërsia, folklori, botimet, sponsorët, planet krijuese dhe realiteti shqiptar. Një vështrim kritik dhe realist i shoqërisë, parë në realitetin e sotëm socio-kulturor.

intervistë

Libri, *zgjatim i kujtesës dhe i përfytyrimit të njeriut*

"Nga të gjitha instrumentet e njeriut, libri është, pa dyshim, më i çuditshmi. Të tjerët janë zgjatime të trupit të tij. Mikroskopi dhe teleskopi janë zgjatime të të vështruarit të tij, telefoni zgjatim i zërit. Kemi gjithashtu parmendën dhe shpatën, zgjatime të krahut. Po libri është tjetër gjë: libri është zgjatim i kujtesës dhe i përfytyrimit të njeriut" - (Jorge Luis Borges)



Shkrimtari dhe studiuesi Xhafer Martini. Foto © B.Karoshi

Sh. Skarra: Në fillim duam t'ju falënderojmë për bashkëpunimin tuaj me gazetën "Rruga e Arbërit", pasi jeni njëri nga bashkëpunëtorët më kryesorë dhe më seriozë. Ne si redaksi e çmojmë shumë kontributin tuaj, por nuk dimë se si shihet ky kontribut nga ana juaj?

Xhafer Martini: Unë e vlerësoj gazetën "Rruga e Arbërit". Ajo ka ardhur gjithnjë në rritje të nivelit të shkrimeve, të zgjerimit të tematikës dhe problematikës, të rritjes së numrit të bashkëpunëtorëve, të kualifikimit të tyre, të rritjes së autoritetit si gazetë duke u radhitur, me disa shkrime, me gazetat më të mira të vendit. Mbi të gjitha ka rritur numri e lexuesve. Kjo gazetë nuk është bërë tribunë shpifjesh dhe fjalësh të ulëta të autorëve të ndryshëm për njëri-tjetrin, siç ndodh rëndom në shtypin tonë. Ka ruajtur stilin polemik, por brenda normave të lejueshme, pa shkelur etikën e gazetarisë. Kjo gazetë e ka bërë të njohur Dibrën dhe dibranët, ka bërë të njohur historinë e tyre, duke pasqyruar ngjarjet më të rëndësishme, ka shkruar për kulturën, traditat, doket, zakonet, jetën e dibranëve në përgjithësi.

Nëse në fillim gazeta kishte një numër të vogël bashkëpunëtorësh, tani numri i tyre është pesëfishuar; nëse me fillimet e saj ajo kishte uri për shkrime, sot ka shumë shkrime që presin radhën për t'u botuar. Të gjithë këto tregues dëshmojnë se gazeta "Rruga e Arbërit" është në ngritje.

Por, unë si bashkëpunëtor dhe dashamir i saj, vërej edhe të meta, disa prej të cilave, mjaft të rëndësishme, që, po nuk u vunë në dukje dhe po mos të bëhen përpjekje për t'u eliminuar dora-dorës, do ta dëmtojnë shumë gazetën. Dashuria për një gjë, duke filluar nga dashuria për atdheun, do të thotë jo lavdërime dhe tamtame delirante, por vënia nën zjarrin e kritikës. Sipas meje, gazeta "Rruga e Arbërit" ka disa të meta dhe dobësi, të cilat po i rendis më poshtë:

E para, gazeta "Rruga e Arbërit" duhet të jetë gazetë e gjithë dibranëve, këndej dhe matanë kufirit të imponuar . Unë e di që ka ndonjë gazetar nga Dibra e Madhe që, herë pas here, shkruan në gazetën "Rruga e Arbërit", por kjo është e pamjaftueshme që ajo të bëhet e krejt Dibrës. Nuk është puna që faqet të ndahen në mënyrë të barabartë, por të mbulohet me sa më shumë shkrime edhe Dibra matanë kufirit. Qyteti i Dibrës është i lashtë dhe me tradita. Peshkopia ende nuk ishte themeluar kurse në Dibër të Madhe kishin ndodhur ngjarje me rëndësi për Lëvizjen tonë Kombëtare; atje kanë lindur, janë edukuar dhe kanë kontribuar për kombin shumë figura të shquara që do ta pasuronin historinë tonë në përgjithësi. Pavarësisht nga proceset demokratike të zhvilluara edhe në Maqedoni, si kudo në Evropën Lindore, prapë kombi shqiptar është nën trysninë maqedonase, prandaj pasqyrimi i asaj pjese të kombit në gazetë, të paktën të asaj që kap Dibra e Madhe, ka rëndësi të jashtëzakonshme. Por nuk është puna për një pasqyrim mekanik, në kuptimin e një informimi të thatë, por për një përpjekje të vazhdueshme për të lidhur dy arteriet e të njëjtit komb, prerë padrejtësisht njëqind vjet më parë, për të bërë kështu të mundur që gjaku të qarkullojë lirisht në tërë organizmin. Këtë mund ta bëjë vetëm populli me inteligjencien në krye, me njerëzit e diturisë, shkencës, kulturës, me shkrimtarët dhe artistët më të shquar. Politikanët e tre vendeve as që mundin dhe as që duan ta bëjnë një gjë të tillë. Dhe nuk bëhet fjalë për ndryshim kufijsh, por për lidhje shpirtërore. Fjalë të hidhura, por të drejta ka thënë një gazetar dhe krijues kosovar, lidhur me këtë problem: "Lidershipit të Kosovës i mjafton Kosova e pavarur, sado e rrudhur të jetë ajo, madje edhe pse proceset integruese e çojnë në lidhje më të fuqishme me Serbinë dhe Maqedoninë sesa me Shqipërinë. Lidershipit të Shqipërisë i mjafton Shqipëria si e tillë, siç është, jostabile dhe manipuluar nga qendra të jashtme të vendosjes. Lidershipit shqiptar të Maqedonisë i mjafton një pjesëmarrje më e madhe e shqiptarëve në ndarjen e pushtetit me maqedonët dhe duket se nuk synojnë asgjë më shumë... Kjo klasë politikanësh shqiptarë, e shpërndarë në këto njësi, ka krijuar edhe bazën e vet botëkuptimore dhe aleancat me njera-tjetrën, pavarësisht nëse bëhet fjalë për ata që janë në pushtet ose në opozitë" (Mehmet Kraja: Një luftë tjetër, Tiranë 2002, f 275)

Qeveritë vendore të të dyja palëve janë përpjekur t'i afrojnë të dyja Dibrat, por përpjekjet e tyre kanë qenë anemike e burokratike. Nuk mjafton ndonjë veprimtari e përbashkët midis komunës së Dibrës së Madhe dhe Bashkisë së Peshkopisë, nuk mjafton, pra, kur kryetarët e tyre dhe disa pushtetarë të tjerë vendorë takohen e mbajnë fjalime, por kur njerëzit e kulturës dhe vlerat kulturore të të dyja Dibrave shkrihen dhe integrohen në njëra-tjetrën. Edhe disa shoqata që janë krijuar, pak kanë bërë për bashkimin shpirtëror dhe kulturor të dibranëve në të dyja anët e kufirit. Edhe kur ka pas ndonjë rast për të festuar ndonjë ngjarje të rëndësishme të popullit dibran, ose për të promovuar ndonjë vepër arti, nëse veprimtaria është bërë në Dibër të Madhe, nga Peshkopia e Tirana kanë shkuar ata që nuk e kanë merituar ose e kanë merituar më pak se disa të tjerë; nëse veprimtaria është bërë në Peshkopi, ka ndodhur e njëjta gjë. Natyrisht, këtë detyrë nuk mund ta plotësojë një staf fare i vogël i gazetës "Rruga e Arbërit", sidomos kur ka edhe mungesa financiare. Por problemi ekziston. "Bota është e atyre që digjen, jo e atyre që ngrohen!"

E dyta, gazetën "Rruga e Arbërit" e kërcënon mungesa e realizmit. Fluturime në stratosferë dhe lavdërime pa masë ka pothuaj në çdo shkrim. Njerëzit për të cilët shkruhet në gazetë (të vdekur e të gjallë), ngrihen në qiell dhe ti që i ke njohur dhe i njeh protagonistët jetësorë mbetesh i shokuar nga rrenat me bisht, siç shprehet populli. Kështu, si shembull, pajiset me veti të larta morale, me zotësi dhe aftësi një njeri që ka vuajtur shumë nga mungesa e tyre. Botimi i një libri fare të dobët cilësohet si botim i shekullit dhe autori i tij krahasohet me Balzakun, Eseninin, Dostojevskin dhe autorë të tjerë të shquar; ngjarjet historike zmadhohen e ndryshohen sipas dëshirës; zona të ndryshme në Dibër, parë me syrin e mallit dhe të nostalgjisë, paraqiten në gazetë si parajsa tokësore dhe plot xhevahire të tjera. Rexhep Qosja ka thënë: " Shqipëria ka dy lloj armiqsh: ata që e lavdërojnë pa masë dhe pa vend dhe ata që e bëjnë qesharake me festime të tepruara".

Gazeta "Rruga e Arbërit" e ka bërë të njohur Dibrën dhe dibranët, ka bërë të njohur historinë e tyre, duke pasqyruar ngjarjet më të rëndësishme, ka shkruar për kulturën, traditat, doket, zakonet, jetën e dibranëve në përgjithësi. Por, unë si bashkëpunëtor dhe dashamir i saj, vërej edhe të meta, disa prej të cilave, mjaft të rëndësishme, që, po nuk u vunë në dukje dhe po mos të bëhen përpjekje për t'u eliminuar dora-dorës, do ta dëmtojnë shumë gazetën. Dashuria për një gjë, duke filluar nga dashuria për atdheun, do të thotë jo lavdërime dhe tamtame delirante, por vënia nën zjarrin e kritikës.

E treta, një dobësi tjetër e gazetës "Rruga e Arbërit" janë shkrimet e stërzgjatura. Kjo e metë lidhet pak a shumë me të parën, sepse shumë bashkëpunëtorë të gazetës kujtojnë se po shkrove gjatë, ke më shumë mend dhe do t'i kënaqësh të tjerët më shumë. Në gazetë sigurisht do të ketë edhe shkrime të gjata. Numri i radhëve ose faqeve të një shkrimi varet nga tema, problemi që ngrihet. Por ndryshe janë shkrimet e gjata, ndryshe shkrimet e stërzgjatura, këto të fundit janë zgjatur pa nevojë, kanë përsëritje, përshkrime banale e pa ide. Kudo ku mungon ndjenja e masës, kemi të kundërtën e asaj që është synuar. "Asgjë e tepruar nuk është hyjnore, vetë masa është hyjnore. Masa është baza e moralit dhe virtyti i parë i njeriut. Pa të njeriu është vetëm një kafshë e egër. "(Dimitri Merezhkovski). Duke mos pasur masë ne ecim kundër traditës dibrane, kundër odave dhe mexheliseve të Dibrës, ku flitej shkurt, qartë, ku asnjë nuk kishte të drejtë të bëhej uzurpues i bisedës. Ky është një nga aspektet e demokracisë së odës së Dibrës dhe për demokracinë ka më shumë nevojë edhe gazeta. Ata që shkruajnë gjatë, nuk kanë nderim për fjalën. Ne nuk duhet ta largojmë, por ta afrojmë gazetën me filozofinë popullore, me mënyrën lakonike dhe të pasur të të shprehurit të dibranit.

E katërta, gazetës "Rruga e Arbërit" i mungon lajmi. Edhe pse botohet në kryeqytet dhe shpërndahet kryesisht këtu, ajo është gazetë lokale, se u intereson më shumë një komuniteti të caktuar siç janë dibranët. Mungojnë pothuaj plotësisht lajmet nga Dibra brenda kufijve shtetërorë, por ca më shumë nga Dibra matanë këtyre kufijve. Ngjarje për lajme ka edhe komuniteti dibran që jeton në kryeqytet, në periferi të tij ose në zona të tjera. Lajmi e gjallëron gazetën, e bën atë të lexueshme dhe, fundja, gazeta kryen rolin kryesor të saj, siç është informimi. Natyrisht, nuk e kam fjalën për ato lajmet e dikurshme të ATSH-së që botoheshin në rubrikën "Sot në Dibër", sepse gazeta është mujore, por për lajme që presin, që nuk u ikën aktualiteti brenda muajit. Lajmi edhe e demokratizon gazetën sepse shton firmat për çdo numër, pakëson shkrimet që zënë një faqe ose më shumë, rregullon edhe faqosjen e bën shumë të mira të tjera.

E pesta, në gazetë, për mendimin tim, duhet të ketë edhe përkthime, si për shembull, ndonjë tregim i bukur, poezi, ese, portrete për njerëz të shquar etj. Tani kemi përkthyes të mirë, që mund t'ia ofrojnë gazetës një shërbim të tillë. Gazetës i mungojnë faqet kulturore në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale.

Sh.S.: - Ju njiheni si një ndër shkrimtarët e njohur të Dibrës, të cilët, për fat, janë shumë. Disa prej tyre edhe të njohur brenda e jashtë kufijve. Si i shikoni ju ato dhe si e lexoni suksesin e tyre?

Xh.M.: Është shumë vështirë t'i përgjigjesh kësaj pyetjeje. Dibra ka shumë që kanë botuar libra, por të jesh shkrimtar është pak ndryshe sesa të botosh një libër, qoftë edhe dhjetë apo njëzet. Ashtu si nga një mijë drurë të shtrembër nuk bëhet dot një dru i drejtë, ashtu si nga një mijë budallenj nuk bëhet një njeri i mençur, edhe nga një mijë libra nuk bën dot një libër për të qenë. Po ne duhet të na ngushëllojë fakti që letërsia është reliev; ka male, por ka edhe hone, ka fusha, por ka edhe kodrina. Të gjitha bashkë formojnë një plotshmëri me përpjesëtime ekuilibruese dhe harmonike. Unë kam nderim për të gjithë dhe pothuaj të gjithëve ua kam lexuar librat. Kam preferencat e mia për secilin prej tyre. Natyrisht, disa i vlerësoj më shumë, disa më pak, gjithnjë duke u nisur nga librat që kanë botuar. Në gjykimin e këtyre librave nisem nga vlerat kombëtare, kjo është mënyra e krahasimit. Steka nuk mund të ulet më poshtë rezultateve të arritura. Nuk i krahasoj autorët dibranë me njëri-tjetrin, siç më duket se ata bëjnë mes veti, ndonëse në mënyrë të heshtur. Jemi në kohën e qarkullimit të vlerave në një hapësirë shumë më të gjerë se sa dikur. Sot, po qe se je shkrimtar, je shkrimtar i gjuhës shqipe, i letrave shqipe, pavarësisht nga vjen. Krijuesit e të gjitha niveleve japin kontributin e tyre në pasurimin e kulturës së një kombi. Muri nuk bëhet vetëm me gurë të gdhendur për qoshe, ka nevojë edhe për gurë më të vegjël.

Prej shkrimtarëve dibranë ka edhe një pakicë që bëjnë pjesë në elitën e krijuesve të kombit. Ti tillë janë Eqerem Basha, Agim Vinca dhe Agron Tufa. Ndër studiues është Shaban Sinani. Këta të katër janë ballkanistë dhe europeistë në tematikë dhe problematikë, në mendësi dhe në koncepte, gjithnjë me prirjen për t'iu larguar krahinores dhe për të përqafuar e për t'u matur me vlera të tjera. Shkrimtarët dhe studiuesit që i pasojnë, edhe kur janë mjaft afër tyre, vlerat i shikojnë tek krahinorja jo vetëm si tematikë dhe problematikë, por edhe si koncepte dhe mënyrë të menduari dhe të kuptuari të gjërave. Po krahinorja është njëkohësisht edhe katapultë, edhe grackë. Parashuta është për të ta shpëtuar jetën në rast rreziku. Por ajo ta merr jetën po nuk e hape në çastin e duhur. Po përpiqem të japë idenë e domosdoshmërisë së largimit me kohë nga provincialja.

Sh.S.: - Kohët e fundit shumë intelektualë dibranë janë aktivë në lotimet për Rrugën e Arbrit, ndërsa ju keni qëndruar në heshtje. Pse ndodh kjo?

Xh.M: Unë jam prononcuar ndër të parët, por ju quani prononcime vetëm ato në Facebook. Që kur nismëtarët e ngritën problemin e hapjes së rrugës së Arbrit, unë botova shkrime në dy gazeta qendrore në mbështetje të kësaj nisme. Dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe.

Qeveritë vendore të të dyja palëve janë përpjekur t'i afrojnë të dyja Dibrat, por përpjekjet e tyre kanë qenë anemike e burokratike. Nuk mjafton ndonjë veprimtari e përbashkët midis komunës së Dibrës së Madhe dhe Bashkisë së Peshkopisë, nuk mjafton, pra, kur kryetarët e tyre dhe disa pushtetarë të tjerë vendorë takohen e mbajnë fjalime, por kur njerëzit e kulturës dhe vlerat kulturore të të dyja Dibrave shkrihen dhe integrohen në njëra-tjetrën.

Një shkrimtar nuk mund të jetë kurrë kundër ndërtimit të rrugëve që është treguesi kryesor i zhvillimit të një vendi, sidomos shkrimtari nuk mund të jetë kundër asaj rruge që e lidh sa më shpejt me vendlindjen e tij. Prandaj mos gjykoni nga sipërfaqja. Jam me gjithë shpirt që rruga e Arbrit të ndërtohet sa më shpejt dhe sipas standardeve të caktuara. Për Dibrën, përveç asaj rruge, asgjë tjetër nuk mund të bëhet. Po të bëhet ajo, të tjerat bëhen vetë. I kam vlerësuar lart nismëtarët që kanë ngritur idenë e hapjes së rrugës së Arbrit. Përshëndes dhe z. Gëzim Alpioni që e masivizoi dhe sensibilizoi ndërkombëtarisht opinionin për rrugën e Arbrit. Gazeta "Rruga e Arbërit" ka bërë shumë punë për ta sensibilizuar opinionin brenda dhe jashtë Shqipërisë për këtë rrugë. Sikur vetëm këtë arritje të kishte kjo gazetë, duhet lavdëruar, por ne kërkojmë më shumë.

Sh.S.: - Ju keni një krijimtari të pasur dhe cilësore. Nuk di nëse shoqëria ju ka nderuar në raport me çka keni dhënë apo keni ndonjë hatërmbetje ndaj saj?.

Xh.M.: Vlerësimet, dekorimet, gradat e titujt shkencorë i jep shteti (gjoja merren vetë) dhe jo shoqëria. Kur shikoj se kush është dekoruar dhe kush ka marrë grada shkencore, jua them me sinqeritet se nuk dua të jem në anën e tyre. Në sistemin totalitar nuk prisja të vlerësohesha, sepse mohimi i vlerave dhe ngritja e antivlerave ishte natyra e atij sistemi. Nuk them se ndodhte gjithnjë kështu, se janë përkrahur edhe njerëz me merita. Po flas për të përgjithshmen. Mohimi i vlerave nuk ishte thjesht një cilësi e sistemit, sepse cilësia është e tillë që edhe e ke, por edhe mund të mos ta kesh, është diçka e shtuar, pa të cilën bën, pa të cilën jeton. Për shembull: ai është bujar. Bujaria është një cilësi. Por ai do të bënte për bukuri edhe pa qenë bujar. Kurse natyra është diçka tjetër, diçka e brendshme, vetja jote, pa të cilën nuk bën, nuk jeton. Për shembull, nuk jeton dot pa frymëmarrjen, pa rrahjet e zemrës. Kështu, frymëmarrje dhe rrahje zemre ishte për atë sistem nëpërkëmbja e të aftit. Frymëmarrje dhe rrahje zemre ishte për atë sistem mbështetja tek të paaftët. Maks Veber ka thënë: " Në qoftë se duam të vlerësojmë si duhet një sistem shoqëror, duhet të shohim se cilit tip të njeriut i krijon gjasa (shanse) më të mëdha, më të përshtatshme që të mbisundojë". Por edhe sistemi demokratik nuk tregoi ndonjë vëmendje për mua dhe për shumë krijues të tjerë. Demokratët qenë shumë të zënë me veten. Postet dhe përgjegjësitë që zunë, i hutuan fare. Besnik Mustafaj ka thënë një gjë të vërtetë dhe të mprehtë kur ka deklaruar: "Prandaj gabimi i një pjese të mirë të tyre (intelektualëve të PD të ngritur në pushtet-XhM) qëndron në mënyrën se si e pranuan pushtetin, jo si një sakrificë të përkohshme, por si diçka që u takonte" (Fletorja rezervat, Prishtinë 1996). Këtë ata e manifestojnë edhe tani. Po nuk u dhe post dhe përgjegjësi, inatosen dhe mohojnë atë çfarë u është dhënë për shumë e shumë vjet. Kujtojnë se ishin meritat e tyre që i ngritën aq lart. Por Majakovski ka shkruar se "njëshi është fyll...", partia është uragan. Çdo të ishin ata pa partinë? Asgjë. Për të mësuar vlerën e vërtetë të një njeriu, duhet t'i heqim atij pushtetin, makinat, paratë dhe postet që i janë dhënë. Shumë njerëz, ose pothuaj të gjithë, kur i zhvesh prej atyre që përmendëm, mbeten pa asgjë. Unë nuk kam asgjë nga ato që thashë. Nëse kam ndonjë vlerë, e kam timen, jo të shtuar prej të tjerëve. Mua nuk më ka shqetësuar kurrë mungesa e titujve dhe gradave, dhe nuk jam përpjekur për to. Unë kam nderim për veten dhe kjo më jep forcë dhe më mjafton.

Sh.S.: - Në librat që keni botuar, por edhe në artikujt nëpër gazeta kemi vërejtur se ju kujdeseni shumë për frazën. Kjo ka të bëjë me stilin e të shkruarit. Edhe kur keni të bëni me artikuj e vepra që merren me politikë, mënyra e juaj e të shkruarit nuk është e vrazhdët dhe nuk shkakton bezdi dhe ndjenja negative tek lexuesit. Kështu, si shembull, librin tuaj për Halil Alinë me titull "Kaq shumë gurë janë hedhur përmbi mua" e kanë pëlqyer, megjithëse për protagonistin e tij ka shumë kontestime.



Mes shkrimtarëve dibranë A.Tufa dhe R.Gjini. Foto © B.Karoshi

Xh.M.: Në qoftë kjo gjë e vërtetë, atëherë unë kam arritur shumë. Stili, sipas meje, nuk ka të bëjë thjesht me mënyrën e të shkruarit, sepse, po të ishte kjo e vërtetë, do të shtrohej pyetja tjetër: po mënyra e të shkruarit me kë ka të bëjë? Dhe si përgjigje do të ishte kjo: Të gjitha këto kanë të bëjnë me mënyrën e të menduarit. Por edhe mënyra e të menduarit është pasojë, ajo varet nga pasuria dhe begatia e mendimeve. Duhet të kesh mendime që të kesh një mënyrë të menduari të gjerave. Sa më shumë mendime të kesh, aq më tepër ata bëjnë presion të shfaqen. Begatia e tyre e gjallëron stilin. Prandaj stili është vetë njeriu. Stili është personalitet, se njeriu është i tillë. Stili i të shkruarit është një pjesë e stilit të njeriut. Çdo njeri ka stilin e vet në të menduar, në të folur, në të veshur, në të ecur, në mënyrën e sjelljes, në gjithçka. Por tani kjo fjalë lidhet më shumë me mënyrën e të shkruarit, sepse të shkruarit, më shumë se gjithçka, do individualitet, do stilin e vet. Një stil i gjallë, tërheqës, me nerv, emocionues, i larmishëm, nuk është vetëm shprehje e individualitetit dhe personalitetit të njeriut, por edhe fryt i një pune të madhe dhe e ndërgjegjshme e krijuesit. Stili është begati, por një begati e organizuar. Unë kujdesem shumë për mënyrën e të shkruarit, sepse, në fund të fundit, libri është gjuhë, është mënyrë e të shprehurit, është mënyrë e të shkruarit, është stil. Floberi thoshte se çmonte së pari stilin, pastaj të vërtetën. E vërteta nuk të bind pa stil. Gënjeshtra duket e vërtetë prej stilit. Nuk ka rëndësi nëse shkruan për vepra me temë politike. Temat nuk i prishin veprat, se nuk ka temë të keqe, ka trajtim të dobët. Politika ka vendin e saj në jetë, dhe në letërsi. Por tjetër është të shkruash në mënyrë politike, kurse krejt tjetër që për politikën të shkruash në mënyrë letrare. Shkrimtarët pa përvojë për politikën shkruajnë në mënyrë politike, kurse ata të talentuarit shkruajnë në mënyrë letrare. Të patalentuarit kanë hallin ta ngrenë cilësinë e shkrimit deri në nivelin e të marrurit vesh, deri në nivelin që të kuptohen nga të tjerët. Por kjo arrihet edhe nga dy bashkëbisedues që nuk e dinë gjuhën e njëri-tjetrit. Shkrimtari i talentuar synon që komunikimin ta ngrejë në nivelin më të epërm, që komunikimi të mos ketë brenda vetëm përmbajtje, kuptimin, por edhe atë formë, atë mënyrë të shkruari, ato modele, atë cilësi, atë stil që e vesh kuptimin me emocione. Një shkrimtar i patalentuar e jep dhunën, si shembull, me mjete të dhunshme, me fjalë të dhunshme, të përgjakura. Një i talentuar nuk vepron në këtë mënyrë. Le të kujtojmë tmerrin e burgut tek romani "I Huaji" i Kamysë. Shkrimtari nuk jep dhunë, tortura, gjak, vrasje, shantazh, rrahje dhe të tilla gjëra me të cilat zakonisht burgjet janë mbushur plot. Ai jep vetëm një rrjetë prej hekuri që ndanë të burgosurit nga njerëzit e tjerë që jetojnë në liri. Kjo rrjetë i ndanë edhe nga ta që kanë shkuar për t'i takuar. Ata duhet të bisedojnë me zë shumë të lartë për t'u marrë vesh me njeri - tjetrin. Zhurma e zërave të tyre kthehet në një mjet torture. Ata janë të detyruar që edhe gjërat më intime t'i thonë me zë të lartë. Fjalët dhe shprehjet ngatërrohen dhe nuk kuptohet kush i thotë dhe cilit i takojnë. Shkurt, nuk merren vesh. Ka humbur intimiteti dhe komunikimi njerëzor. Stili është i qetë në dukje, shkrimtari vetëm rrëfen. Dhuna është nga më të egrat, por mjetet e shprehjes janë tjetër gjë. Ja, pra, çfarë është stili. Stili nuk është brutalitet, dhunë fizike, as lajle e lule gjoja për të poetizuar situatat, stili është vërtetësi, jetë, është mjeti nëpërmjet të cilit shfaqet nderimi për gjuhën, për funksionin e saj si mjet komunikimi, por jo çdo komunikim, por në nivelin më të lartë dhe në mënyrën më të bukur. Stili është hall. Pa patur hall, mos shkruaj. Shkrimtari i vërtetë pëlcet po të mos shkruaj. Të shkruarit për të është çlirimtar. Pasionet që ka përbrenda do ta mbysnin po të mos i nxirrte me anë të të shkruarit. Kurse tjetri që nuk është shkrimtar, thotë me vete : pse të mos shkruaj edhe unë, pse të mos bëhem shkrimtar!?

Sh.S.: - Ju keni ndihmuar talentet e rinj kur ishit mësues, por edhe më vonë. Ç'mund të na thonë për këtë përvojë?

Xh.M.: Punën me talentet e rinj e kam pasur pasion të madh dhe e kam filluar menjëherë sa më emëruan mësues në shkollën shtatëvjeçare të Fushë Alies, në vitin 1961. Nuk i kam ndihmuar vetëm unë talentet e rinj. Në atë kohë ata ndihmoheshin nga shumë mësues shkrimtarë. Gjimnazet ishin vatrat e poetëve të rinj që premtonin shumë, sepse në këto shkolla jepnin mësim poetë e shkrimtarë të talentuar: poeti dhe përkthyesi Vangjush Ziko jepte mësim në gjimnazin e Korçës; poeti Dhori Qiriazi, një nga zërat më të fuqishëm dhe origjinal të poezisë sonë, jepte mësim në gjimnazin e Ersekës; Koçi Petriti, liriku i ëmbël, jepte mësim në gjimnazin e Librazhdit; Esenini shqiptar, avanguarda e poetëve njëzetvjeçarë, Musa Vyshka, jepte mësim në Elbasan; Anton Papleka, një tjetër poet i mirë jepte mësim në gjimnazin e Tropojës; Ferhat Cakaj dhe Agim Spahiu në Kukës e kështu me radhë në shumë rrethe të tjera që tani nuk më kujtohen. Ishte një luks i madh që në rrethe kishte mësues shkrimtarë si këta që përmenda. Një mësues shkrimtar e njeh laboratorin krijues. Ai e di rrugën e mundimshme të krijimit. Një dijetar ka thënë se burrat do t'ua dinin grave tmerrin e lindjes vetëm kur të lindnin vetë. Një mësues që nuk është shkrimtar, ua tregon nxënësve nga libri se ç'është, fjala vjen, romani, kurse mësuesi shkrimtar që ka shkruar vetë romane, e di shumë mirë si krijohet një roman dhe ua shpjegon ndryshe nxënësve.

Në kohën për të cilën bëjmë fjalë, unë jepja mësim në tetëvjeçare, megjithëse isha autori i njëmbëdhjetë librave, midis tyre edhe një romani. Romancier në Peshkopi!? Ishte një ngjarje. Po zyrtarët e Peshkopisë nuk e donin një luks të tillë, ata më kishin gozhduar në tetëvjeçare, ku më mbajtën tridhjetë vjet. Në tetëvjeçare nuk jepej letërsi, por lexim letrar. Në vend tim në gjimnazin e Peshkopisë mësimin e letërsisë e jepnin mësues që vendosnin qetësinë me teserën e partisë, sepse nxënësit nuk i dëgjonin. Për këta njerëz kishte plot vende ku të merrnin rrogën pa bërë punë, por edhe pa bërë dëm. Në gjimnaz ata bënin dëm. Kjo është arsyeja që nga ajo shkollë për 30 vjet nuk ka dalë asnjë talent, kurse në shkollën 7-vjeçare të Fushë Alies ku kam punuar gjashtë vjet kanë dalë një varg poetësh, si: Ilir Spata dhe të ndjerët Garip Troci, Maliq Bitri, Miftar Mena e të tjerë. Kjo nuk është aspak rastësi.

> Unë kam nderim për të gjithë autorët dibranë dhe pothuaj të gjithëve ua kam lexuar librat. Kam preferencat e mia për secilin prej tyre. Natyrisht, disa i vlerësoj më shumë, disa më pak, gjithnjë duke u nisur nga librat që kanë botuar. Në gjykimin e këtyre librave nisem nga vlerat kombëtare, kjo është mënyra e krahasimit. Steka nuk mund të ulet më poshtë rezultateve të arritura. Nuk i krahasoj autorët dibranë me njëri-tjetrin, siç më duket se ata bëjnë mes veti, ndonëse në mënyrë të heshtur. Jemi në kohën e qarkullimit të vlerave në një hapësirë shumë më të gjerë se sa dikur. Sot, po qe se je shkrimtar, je shkrimtar i gjuhës shqipe, i letrave shqipe, pavarësisht nga vjen. Krijuesit e të gjitha niveleve japin kontributin e tyre në pasurimin e kulturës së një kombi. Muri nuk bëhet vetëm me gurë të gdhendur për qoshe, ka nevojë edhe për gurë më të vegjël.

Mënyra e parë për t'i ndihmuar talentet është ta japësh mësimin me pasion, t'i nxitësh nxënësit për të lexuar, pastaj t'i ndihmosh si ta përvetësojnë mjeshtërinë e të shkruarit. Unë këtë e bëja. I ndihmoja nxënësit të botonin. Megjithëse ajo ishte shkollë e thellë fshati, në vitin 1963 gazeta "Pionieri" botoi një faqe letrare me krijimet e nxënësve të shkollës së Fushë Alies. Injorantët dhe dashakeqësit bënin aluzion sikur krijimet e asaj faqeje letrare i kisha shkruar unë. Por koha vërtetoi se ata ishin nxënës të talentuar që më vonë patën sukses si poetë.

Në gjimnaz më dërguan mësues kur filloi shkrirja e akujve. Vitet e ndërrimit të sistemeve, siç e dimë, janë shoqëruar me trazira të shumta; shkolla ra, vëmendja e nxënësve u shpërqendrua dhe nuk ishte më ai pasion për letërsinë si dikur. Megjithatë, mua nxënësit më donin shumë. Tani qenë ata që më gozhduan që të mos vija me kohë në Tiranë dhe të kërkoja një punë tjetër, siç bënë shokët e mi shkrimtarë nga rrethet e tjera. Në gjimnazin e Peshkopisë e gjallërova shumë jetën letrare. Kishte me dhjetëra nxënës dhe nxënëse që shkruanin dhe krijimtaria e tyre ishte, pa asnjë dyshim, jo vetëm në nivel botimi, por edhe cilësore.

Sh.S.: - Mund të na përmendi ndonjërin prej tyre?

Xh.M.: Sigurisht. Të parin përmendi Fatos Vladin nga Lura. Unë nuk e kisha nxënës direkt, se atë e mësonte një mësues tjetër, por ai me mua i mbante lidhjet, unë ia vlerësoja poezinë. E kisha nxënës shpirtëror, siç kisha edhe të tjerë. Ia pëlqeja edhe shpirtin e bukur, poetik. Vite më vonë, kur Fatosi kishte mbaruar studimet në Fakultetin e Filologjisë, e kam takuar në Tiranë. Nuk mbaj mend në çfarë shoqate punonte. Ishte bërë shumë fetar.

> Unë kam karakteristikë improvizimin. Kur i hyjë një gjëje, nuk e kam të qartë ku do të dal dhe sa kohë do të udhëtoj. Në punë e sipër më ndriçohen objektivat dhe më bën dritë udha. Do të isha i lumtur që problemet që kam ngritur, të jenë të asaj rëndësie që të tërheqin vëmendjen e studiuesve të tjerë, që me dijet dhe përkushtimin e tyre, t'i çojnë punët më para.

(Vijon në faqen 14)

Përfaqësues të shoqatave dibrane bëjnë një ekspeditë në rrugën e Arbrit.



Shpëtoni Rrugën e Arbrit!

Më 31 gusht të vitit 2013, një grup intelektualësh dibranë, përfaqësues të shoqatave "Lidhja e Intelektualëve Dibrane" dhe "Nisma Dibrane", nën drejtimin e Prof. Dr. Bashkim Lleshit, bënë një eskursion në zonën ku do të kalojë Rruga e Arbrit nga Ura e Vashës në Gurin e Bardhë të Matit, në Qaf Murrizë, Bastar Kaçu, Shpal e Zall Dajt të Tiranës.

Grupi përbëhej nga këto pjesëtarë njëri nga autorët e studimit të fizibilitetit, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, nënkryetari i Shoqatës LID dhe botues i gazetës "Rr.A", Musa Riçku dhe anëtari i kryesisë Demir Osmani, si dhe nga përfaqësues të shoqatës "Nisma Dibrane", Hysen Uka, Bujar Karoshi, Afrim Karoshi.

Qëllimi i këtij eskursioni ishte për tu njohur me ecurinë e punimeve të kryera për gjatë aksit ku kalon Rruga e Arbrit në këtë zonë, vonesat dhe mangësitë e vërejtura në kryerjen e punimeve për të krijuar një ide për punimet e kryera deri tani si dhe për të parë mundësinë e bashkërendimit të punës mes shoqatave dibrane, për të krijuar mundësinë e lobimit pranë qeverisë shqiptare, për të bërë përmirësime në këtë aks, sidomos nga Tirana në Bulqizë.

URA E VASHËS DHE TUNELI I GURIT TË BARDHË

Ndalesa e parë ishte përball Urës së Vashës, në pjesën ku vrojtohej më mirë kjo nyje problematike e Rrugës së Arbrit. Nga vrojtimet e kryera rezultoi se gjatë këtij viti ka vazhduar puna për hapjen e trasesë së rrugës nga fundi i Planit të Bardhë në drejtim të Urës së Vashës.

"Propozimi fillestar për Urën e Vashës në skicide, tha Prof. Dr. Bashkim Lleshi, ka qenë që ajo të ndërtohet në pjesën ku lugina e lumit është më e ngushtë, pra mbi Urën e Vjetër me harqe të Vashës. Vazhdimi i mëtejshëm i rrugës në drejtim të Gurit të Bardhë do të ishte në shpatin e përroit të Dishit deri në vendin ku bashkohen dy përrejt që zbresin nga fshati Guri i Bardhë, për të vazhduar me tunelin e Gurit të Bardhë, poshtë Petralbës me gjatësi rreh 870m. Ose poshtë lagjes Laskaj me gjatësi 1500m. Në të dy rastet tuneli do të dilte në përroin e Mashnorit për të vazhduar sipas rrjedhjes së përroit në drejtim të Murrizës. Në të dy rastet shmanget kalimi i rrugës në nyjen shumë problematike poshtë fshatit Shkallë ku fillon zbritjen përroi i Mashnorit dhe eliminohen shpenzimet e tepërta për kalimin e kësaj zone të vështirë".

"Në prag të miratimit të Studimit të Fizibilitetit, tha ai, pozicioni i kësaj ure ndryshoi, duke ndryshuar edhe pozicionin e tunelit të Gurit të Bardhë, mbi fshatin Fshat. Lugina e lumit në këtë zonë është më e gjërë, rrjedhimisht ura del më e gjatë dhe rruga zbret më poshtë me pretendimin për t'ju afruar më shumë Klosit. Megjithëse janë bërë debate për këtë problem qysh në vitin 2008, projektet teknike të zbatimit vazhduan në të njëjtën linjë".

TUNELI MURRIZËS

Nga Guri i Bardhë deri në Qafën e Murrizës rrugën e përshkuam pothuajse në këmbë duke vrojtuar luginën e përroit të Mashnorit nga pjesa e poshtëme e fshatit Shkallë deri në pjesën e poshtëme të fshatit Xibër Murrizë, në përroin në veri të shkollës së vjetër fillore të fshatit, ku mendohet të jetë gryka e tunelit nga ana e Matit.

"Pavarësisht nga problemet gjoja gjeologjike e hidrogjeologjike që janë përdorur për të justifikuar vonesat e fillimit të punës në këtë tunel, pretendimet e paraqitura deri tani për pengesat që mund të lindin nga ujrat e shumta që mund të dalin gjatë hapjes, apo për formacione të shkatërruara e të pakalueshme në hyrje e në dalje të tunelit nuk qëndrojnë", citon Prof. Dr. Bashkim Lleshi.

"Për të hapur një tunel nuk është një punë e lehtë, pa tjetër që është një sipërmarje e vështirë, ka vështirësi, por ne në vendin tonë nuk është hera e parë që hapim tunele, edhe të këtyre përmasave. Nuk ka qenë më e lehtë hapja e tunelit të Qaf Thanës, në formacione më të vështira se ky tunel dhe me prurje ujrash të konsiderueshme, apo 12 km. tunel të Traverbankut të Klosit po ashtu me prurje uji, e disa kilometra tunele të përmasave të mëdha të niveleve kryesore që lidhin Bulqizën me Batrën, pa përmendur tunelin e Kalimashit dhe së fundi atë të Krrabës".

Afro 80 % e gjatësisë së tunelit do të përshkohet nga depozitime të shkëmbinjve gëlqerorë pllakorë, me ndërtim kompakt e të qëndrueshëm, me pak ose aspak ujë, pa probleme të vështira teknike për hapjen e tunelit. Edhe depozitimet flishore në dalje të tunelit nga ana e Matit nuk paraqesin probleme të vështira teknike. Pak vështirësi paraqet vetëm hyrja e tunelit nga ana e Tiranës, poshtë lagjeve Lila e Kaçu, në afërsi të tyre, për shkak të rrëzimeve të dukëshme në sipërfaqe, të ardhura nga pjesët e sipërme të shpatit. Por pasi të fillohet e sigurohet hyrja e tunelit depozitimet flishore ranoro argjilore do të kalohen pa vështirësi. Bile ato kanë shumë pak ujë kryesisht në afërsi të kontaktit me depozitimet flishore me ndërtim karbonatik, pra edhe uji nuk përbën ndonjë problem se në depozitimet flishore nuk kemi të zhvilluar fenomenin e karstit si në gëlqerorët e Malit me Gropa në pjesën jugore të Qafës së Murrizës, nga burojnë gurrat e Linosit e të Gurit të Bardhë.



Depozitimet ranoro argjilore në rrugë mbi lagjen Selçune në J-L të lagjes Kaçu në lartësinë 1080m. Foto © Bashkim Lleshi

Formacionet mesatarisht të qëndrueshme alevritoranore të pjesës së fillimit të tunelit nga ana e Tiranës dhe ato flishore të daljes nga ana e Matit, që të dyja së bashku nuk bëjnë as 20% të gjatësisë së tunelit, nuk janë më të paqëndrueshme se formacionet e përzjerjes ofiolitike me prurje uji të tunelit të Qaf Thanës, ato ranore e argjilore të tunelit të Krrabës, apo formacionet e disa kilometrave tunele të rrugës nga Janina në Selanik të fqinjit tonë jugor.

Në rast se duam të ndërtojmë rrugë me cilësi të standarteve të kohës tuneli i Murrizës nuk duhet të ngrihet mbi 850m nga ana e Tiranës dhe jo mbi 850-900m nga ana e Matit, prandaj për derisa puna nuk ka filluar akoma, mendojmë se kemi kohë për të rishikuar lartësinë e hapjes së këtij tuneli si nga ana e Matit ashtu edhe nga ana e Tiranës. Bile në vartësi të lartësisë së daljes së tunelit nga ana e Matit, në përroin poshtë shkollës së vjetër fillore të Xibër Murrizës duhet të dalë pozicioni më i përshtatshëm dhe lartësia e hyrjes së tunelit nga ana e Tiranës. Në vartësi të këtyre lartësive do të dalë gjatësia e tunelit të Murrizës.

Ngjitja e rrugës nga Zall Dajti në drejtim të Shpalit, Marecit, deri poshtë lagjes Lile e

cyan magenta yellow black

Duhet një koordinim sa më i mirë i shoqatave dibrane, në mënyrë që të ndikojmë sa të mundemi, që aksi i Rrugës së Arbrit nga Tirana në Bulqizë, të ndërtohet sipas standardeve, duke qënë një shembull i infrastrukturës në vend, jo vetëm nga cilësia e ndërtimit, por edhe siguria rrugore.



Shoqëria civile duhet që krahas kërkesës për përfundimin sa më shpejt të rrugës, t'i kërkojë qeverisë së ardhshme që projektet e zbatimit të bëhen publike para se të fillojnë punimet, pasi siç ka rezultuar deri më tani, në shumë vepra të rëndësishme të ndërtuara, ka pasur devijime apo përpjekje për ndryshime nga projektet e miratuara, pa pasur më parë një miratim institucional.

asaj Kaçu nuk është problematike. Në afërsi të ketyre lagjeve, poshtë tyre duhet gjetur vendi më i përshtatshëm për të filluar hapjen e tunelit nga ana e Tiranës.

Nga një vrojtim i përgjithëshëm i punës së kryer deri tani gjatë gjithë aksit që përshkon Rruga e Arbrit, pothuajse vetëm traseja e hapur nga Tuneli i shkurtër në afërsi të Zall Dajtit deri tek ish Uzina e Artilerisë në afërsi të Urës së vjetër të Brarit dhe një pjesë e trasesë në luginën e Planit të Bardhë e mbi Urën e Vashës, mund të quhen trase të Rrugës së Arbrit, ndërsa në pjesët e tjera kemi ose rikonstruksion të rrugës ekzistuese ose shmangje nga aksi i Rrugës së Arbrit. Shmangja më e madhe është ajo ku duhet të hapet Tuneli i Qaf Buallit e cila është trajtuar që në vitin 2008 e në vazhdim", tha për gazetën Prof. Dr. Bashkim Lleshi.

Demir Osmani, njëri nga organizatorët e këtij marrshimi, tha për gazetën se "duhet një koordinim sa më i mirë i shoqatave dibrane, në mënyrë që të ndikojmë sa të mundemi, që aksi i Rrugës së Arbrit nga Tirana në Bulqizë, të ndërtohet sipas standardeve, duke qënë një shembull i infrastrukturës në vend, jo vetëm nga cilësia e ndërtimit, por edhe siguria rrugore. Sot tha ai, nga aksidentet në rrugë, si rezultat i ndërtimit pa cilësi të rrugëve, mungesës së sinjalistikës apo vendosjes gabim të tyre, kemi rreth 8 të vdekur në jave dhe rreth 57 të gjymtuar. Ne duhet të kërkojmë ndërtimin e kësaj rruge me të gjitha parametrat dhe rruga e Arbrit të jetë jashtë statistikave për aksidentet."

Hysen Uka, njëri nga nismëtarët e parë që kanë kërkuar ndërtimin e kësaj rruge, tha se tani është koha jo të ndërtojmë "një rrugë të mirë për dibranët, por të kërkojmë një aks rrugor të standardeve më të larta në vend". "Ne nuk po kërkojmë një trill teknologjik, tha ai, por po kërkojmë dhe duhet të vazhdojmë me kërkesën tonë për Rrugën e Arbrit, e cila do ta kthejë Dibrën në një qendë të rëndësishme të zhillimit të vendit, si dhe do të krijojë mundësinë më të shkurtër të lidhjes së metropolit të Tiranës dhe Durrësit me portin e Varnës dhe Stambollit. Rruga do të integrojë krahinat shqiptare në Maqedoni si dhe do të kountribojë në përmirësimin e marrëdhënieve mes Maqedonisë dhe Shqipërisë. Por me mënyrën se si është punuar deri më tani në Rrugën e Arbërit, duket se kërkesat tona nuk duhet të jenë "Ndërtoni rrugën e Arbrit, pasi ndërtimi i saj nuk ka më kthim,

"Ne duhet t'i ftojmë gjithë qytetarët, sidomos deputetët, të vijnë një vizitë këtu në Qafë Murrizë dhe kur të shikojnë në lindje Dibrën dhe në Perëndim Tiranën, do ta kuptojnë se Rruga e Arbrit nuk është një ëndërr, por një realitet që duhet prekur sa më shpejt".

por shpëtoni Rrugën e Arbrit!".

Musa Ricku, nënkryetar i Shoqatës LID, i mrekulluar nga natyra në këtë aks, tha se "Rruga e Arbrit do t'i kthejë Dibrës dinjitetin e munguar si dhe do të krijojë shumë hapsira për biznesin në të gjitha drejtimet."

Musai ka një kontribut të madh në promovimin e rrugës së Arbrit. Ai ka financuar disa veprimtari për këtë cështje, si dhe ka kontribuar në koordinimin e faktorit dibran brenda dhe jashtë kufijve, për realizimin jetik të projektit të rrugës së Arbrit. "Ne duhet t'i ftojmë gjithë qytetarët, sidomos deputetët, të vijnë një vizitë këtu në Qafë Murrizë dhe kur të shikojnë në lindje Dibrën dhe në Perëndim Tiranën, do ta kuptojnë se Rruga e Arbrit nuk është një ëndërr, por një realitet që duhet prekur sa më shpejt", thekson ai.

Grupi ra dakord, që në vazhdim të kërkesës së shoqërisë civile për përfundimin sa më shpejt të rrugës, t'i kërkojë qeverisë së ardhshme që projektet e zbatimit të bëhen publike para se të fillojnë punimet, pasi siç ka rezultuar deri më tani, në shumë vepra të rëndësishme të ndërtuara deri më tani, ka pasur devijime apo përpjekje për devijime nga projektet e miratuara, pa pasur më parë një miratim institucional.

Korresp. Rr. Arb.



Lugina e përroit të Mashnorit poshtë fshatit Xibër Murrizë. Foto © Bashkim Lleshi

cyan magenta yellow black

Rruga e Arbërit nr. 88

intervistë

Mbledhja dhe kodifikimi i “Kanunit të Dibrës” është një punë e madhe që më ka kushtuar shumë kohë, por unë nuk kërkoj ndonjë kryevendi.

Unë kam **nderim** *për veten dhe kjo më jep* **forcë**

Vijon nga faqeja 11

Me njerëzit e fesë kam pasur komunikim të vakët. Fatosi ishte një mendimtar fetar, filozof, si të thuash. Më duket se ishte ithtar i krishterimit. Ishte shumë i ditur në atë fushë. Edhe nëse mund të mos ishe dakord me të, nuk mund të mos admiroje mënyrën se si i shtjellonte mendimet. Nuk di kush ka thënë se shumë klerikë ta nxjerrin qejfit fenë. Fatos Vladi, pa qenë klerik, të bënte të hyje në rrugën e besimit me vullnet dhe dëshirë. E lamë që të takoheshim prapë, por nuk u takuam më. Që atëherë nuk kam rënë më në gjurmë të tij. U bënë njëzet vjet. E kujtoj me mall se shpirti ëngjëllor i kishte mbetur i paprekur nga tufani i të keqes.

Nuk kisha nxënëse direkt as Irma Myftarin, por unë ia lexova vëllimin me poezi, unë ia përzgjodha dhe ia paraqita për botim me një parathënie serioze. Kurse Shkëlqim Agollin që ka botuar një vëllim me poezi, e kisha nxënës direkt. E ndihmova shumë jo vetëm për talentin, por edhe për atë shpirt të lulëzuar prej ndjenjash të mira. Tani ai jeton në Amerikë. Për shumë vjet mirënjohja e tij ka kaluar oqeanet për të ardhur tek unë. Tani ka disa vjet që nuk vjen më. Nga gjimnazi i Peshkopisë përmend këta që kanë botuar libra, por kishte plot nxënës të tjerë që më kanë dhënë për shqyrtim vëllime me vjersha dhe me tregime. Sidomos vajzat. Sikur, të paktën, pesë-gjashtë vajza të gjimnazit të Peshkopisë të kishin edhe nxitjen e prindërve sikur kishin nxitjen time, me siguri sot do të kishim disa poete të mira më shumë. Por në Peshkopi për vajzat si krijuese ekziston një mentalitet shumë i prapambetur. Një vajzë duhet të gatuajë mirë, por jo të bëhet shkrimtare. Kanë mbaruar shkolla të larta, por nuk di ç’kanë bërë më tej. Për mua është festë kur takoj ish-nxënësit.

Sh.S.: - Ku i ndieni pozitat më të forta: si shkrimtar apo si studiues? Kam parasysh se keni botuar kohët e fundit dy romane: “Fshati Mosqofsh”, “Kur vdiste Kanuni”, një vëllim me Novela, por edhe studimet e njohur si: “Gjakmarrja”, “Perlat e Dibrës”, “Pajtimi në traditën popullore”, “Proza popullore në prerjet rrethore”, sidomos veprën voluminoze studimore “Kanun”, që shpejt do të dalë nga shtypi. Por arritja juaj më e madhe mendojmë se është botimi e ribotimi i “Kanunit të Dibrës”, që të radhitë përkrah Gjeçovit.

Xh.M.: Mos na ço deri tek Gjeçovi. Janë ca maja që nuk arrihen kollaj. Një shkrimtar mund të merret edhe me studime. Këtë e them në përgjithësi. Mbasi mbarova universitetin më 1970, deri në vitin 1980 jam marrë rregullisht me kritikë letrare. Kritika letrare kishte të metat e veta për shkak të parimeve që duhet të zbatoheshin, por edhe në atë klimë të thatë që ishte krijuar, megjithatë, kam ndonjë shkrim të mirë. Po t’i mbledhësh, si sasi, bëjnë një libër voluminoz. Me këtë dua të them se studimeve iu futa me një farë baze, mbase edhe me një farë prirjeje. Kam punuar me përkushtim edhe si shkrimtar, edhe si studiues. Për nivelin tim nuk mund të flasë, sepse me sinqeritet them që nuk e di. Njeriu vetëm veten nuk mund ta gjykojë. Pata fat që u mora me mbledhje folklori, mblodha çfarë më dilte përpara. Folklori nga Instituti i Kulturës Popullore (dikur Instituti i Folklorit), mblidhej me përzgjedhje, duke pasur parasysh mësimin e Leninit për dy kulturat: njëra e shtresave popullore (e pranueshme), kurse tjera e klasave sunduese (e papranueshme). Kjo e fundit ishte ajka dhe unë me këtë jam marrë. Por ajo nuk ishte e klasave sunduese, ishte e popullit, sepse arti i tij nuk ka karakter klasor. Kur merresh me artin e popullit, ke një përparësi se vetë ai sikur të tregon në ç’rrugë duhet të ecësh. Mbledhja dhe kodifikimi i “Kanunit të Dibrës” është një punë e madhe që më ka kushtuar shumë kohë, por unë nuk kërkoj ndonjë kryevendi. Mua m’u dha me e krye atë punë dhe e kreva si dita. Kështu, pa shumë pretendime, iu futa edhe studimit me titull “Kanun”, që së shpejti do të shohë dritën e botimit. E mendova si një ese të shkurtër, por çdo gjë që arrija, më sugjeronte një gjë tjetër, që as nuk më kishte shkuar ndërmend më parë. Kështu, hap pas hapi, doli një studim i gjatë mbi katërqind faqe dhe përgjithësisht me probleme që nuk janë rrokur ndonjëherë. Unë kam karakteristikë improvizimin. Kur i hyjë një gjëje, nuk e kam të qartë ku do të dal dhe sa kohë do të udhëtoj. Në punë e sipër më ndriçohen objektivat dhe më bën dritë udha. Do të isha i lumtur që problemet që kam ngritur, të jenë të asaj rëndësie që të tërheqin vëmendjen e studiuesve të tjerë, që me dijet dhe përkushtimin e tyre, t’i çojnë punët më para. Për dy romanet dhe librin me novela nuk di ç’të them. Në gazeta janë botuar disa shkrime entuziaste, por mendimin e publikut të gjerë nuk e di. Autorët sot kanë fatkeqësinë se i kanë humbur lidhjet me lexuesit. Jemi krijues pa lexues.

> Jam me gjithë shpirt që rruga e Arbrit të ndërtohet sa më shpejt dhe sipas standardeve të caktuara. Për Dibrën, përveç asaj rruge, asgjë tjetër nuk mund të bëhet. Po të bëhet ajo, të tjerat bëhen vetë. I kam vlerësuar lart nismëtarët që kanë ngritur idenë e hapjes së rrugës së Arbrit. Përshëndes dhe z. Gëzim Alpioni që e masivizoi dhe sensibilizoi ndërkombëtarisht opinionin për rrugën e Arbrit. Gazeta “Rruga e Arbërit” ka bërë shumë punë për ta sensibilizuar opinionin brenda dhe jashtë Shqipërisë për këtë rrugë. Sikur vetëm këtë arritje të kishte kjo gazetë, duhet lavdëruar, por ne kërkojmë më shumë.

Sh.S.: - Një fushë e dashur për ju janë edhe monografitë për figura të ndryshme. E keni si prirje apo ju shtyjnë, nganjëherë, edhe motive të tjera...


Xh.M.: Ato motivet e tjera mua nuk më kanë shtyrë kurrë, nëse është fjala për libra me porosi që paguhen nga familjet. Unë i kam zgjedhur figurat për të cilat kam shkruar. Kam shkruar dy libra për Elez Isufin, një figurë shumë interesante jo vetëm për kontributin atdhetar, por edhe për jetën personale. Librin e parë për Elez Isufin e pata shkruar në sistemin totalitar. U botua në vitet e para të demokracisë. Iu ktheva pas shumë vjetësh që të thosha çfarë kisha lënë pa thënë, që, ato që kisha thënë, t’i thosha ndryshe. Kam shkruar për Halil Alinë, një njeri të jashtëzakonshëm, që u përpëlit nën kontradiktat e kohës së luftës dhe, në fund, u vra nga forcat komuniste. Por më shumë se për Halilin, siç mund të vihet re, kam shkruar për shpirtin antikomunist të krahinës së Dibrës së Poshtme dhe për hakmarrjen e PK ndaj kësaj zone. Jam përpjekur të jem i drejtë, objektiv në shpjegimin dhe analizën e ngjarjeve. Autori, në çdo rast, kuptohet anën e kujt mban. Megjithatë, unë përpiqem të jem i paanshëm. Vetëm tregoj dhe jap fakte, përfundimet t’i nxjerrë vetë lexuesi. Por kjo është një gjë tejet e vështirë dhe zor t’ia kem arritur për çdo rast. Kam shkruar për Rrahim Gjikën një mjek gjenial i cili në kushtet e Shqipërisë, madje të Peshkopisë, zhduku sterilitetin e femrave. Kishte mbaruar të gjitha kategoritë e shkollave shkëlqyeshëm dhe zotëronte shumë gjuhë. Vetë ishte mjek gjinekolog në Peshkopi, studentët e universitetit të mjekësisë në Tiranë mësonin me librat e tij. Katërqind burra nga e gjithë Shqipëria mbajnë sot emrin Rrahim në nderim të mjekut gjenial që i solli në dritë, ndonëse nënat e tyre kishin njëzet vjet martesë pa lindur. Kam shkruar për një Hoxhë nga Blliçja, figura e të cilit është një simbiozë midis Krishtit dhe Muhametit. Nuk i shkruaj monografitë si historian, por si eseist. Mua nuk më interesojnë shumë datat, kronologjia, që për historianin profesionist janë tabu. Kam një kapitull me titull Dashuria tek libri më i ri për Elez Isufin “Gjenerali me shajak”. Në fakt atje janë grumbulluar dasmat e Ndreve, të paktën një e Elezit, një e Mehdiut, djalit të Elezit, që si kohë, janë mjaft larg nga njëra-tjetra, por unë i kam bërë në një ditë. Në monografi jam krijues, fantazoj dhe abstragoj brenda asaj që ka ndodhur. Në ato dy dasma janë ngjeshur njohjet, pasionet, dashuritë, martesat, konfliktet. Në atë kapitull ka gëzim, lot, këngë e valle, paradë kostumesh popullore, festival, Mis Bukuria e kohës, ku merrnin pjesë shumë nuse e vajza, veshur e stolisur me fundet e arkave, praruar gjokset, gushën, llërët me floririn e ardhur nga ana e anës. Por aty ka edhe vdekje, dhunë, vrasje, varje në litar, plot tragjedi dhe drama familjare. Dikush mund të thotë se e paske bërë çorbë derrash. Jo, nuk është çorbë derrash, por pasione të llojllojshme, të endura hollë me mjeshtërinë e shkrimtarit. Të gjitha këto i thashë për të bindur ju dhe lexuesit që nuk shkruaj monografi me porosi. Shkruaj monografi për njerëz të shquar. Përfitoj nga mënyra se si kanë shkruar shkrimtarët më të mëdhenjtë e botës për njerëzit më të shquar të botës. Vështroj çdo gjë me vëmendje dhe u vë rëndësi detajeve. Në monografinë për Napoleonin lexojmë edhe një pasazh shumë të shkurtër, treguar si kalimthi, kur fshatarë në departamentin e Lionit blejnë tek bujtinari, për t’i mbajtur si relike, kockat e zogut që Perandori (Napoleoni) kishte ngrënë për drekë. Ose kur një zonjë e moshuar, diku në brigjet e Atlantikut, në restorantin e të cilës dëfrenin një grup ushtarakësh të rinj që festonin marrjen e diplomave, futet midis tyre me gazetë në dorë ku në faqen e parë ishte botuar fotografia e Xhek Londonit, dhe u thotë: Pushoni një çast! Ka vdekur Xhek Londoni!Monografia, thënë me figurë, është punë dore, ku një metër pëlhurë të duhen disa muaj për ta qëndisur me motive floriale, kurse fabrika atë metër e bën po ashtu brenda një ore. Po në punën e fabrikës nuk pulson zemra e njeriut. Në monografi më mirë se kudo shfaqet individualiteti i krijuesit. Për shembull, për Napoleon Bonapartin ka shumë e shumë monografi. Ndryshojnë njëra nga tjetra. Monografitë e Cvajgut ndryshojnë nga ajo e Merezhkovsit, Tarles etj. Napoleoni i Cvajgut është më mbresëlënës, por kështu edhe Balzaku i Cvajgut, po kështu edhe Xhek Londoni i tij.


Sh.S.: - Shumë nga botimet tuaja janë bërë të mundur falë dashamirësisë së disa biznesmenëve. Si i mbani marrëdhëniet me ta?


Xh.M.: Ky nuk është një problem që më takon vetëm mua, por gjithë shoqërisë ose rendit kapitalist, prandaj do ta trajtoj pak gjatë. Në këtë rend ka shumë të pasur siç ka edhe shumë të varfër. Ekziston dhe shtresa e mesme. Kur kjo e fundit përbën shumicën, në atë vend ka stabilitet dhe qetësi. Në mungesë të saj, ka destabilitet dhe trazira deri në shkatërrimin total të rendit dhe të sistemit. Tek ne nuk ka shtresë të mesme ose ajo është fort e pakët. Një dhjetëpërqindsh kanë pasuri që nuk llogariten, kurse nëntëdhjetë përqindët e tjerë janë të varfër. Nëse të pasurit e një shoqërie nuk e kuptojnë se duhet ta japin një pjesë të pasurisë për të varfërit, ajo shoqëri është e destinuar të shkatërrohet. Herët apo vonë kjo ka për të ndodhur. Askërkush nuk e ka të sigurtë pasurinë në një vend ku nuk ka rend dhe qetësi, ku nuk ka stabilitet. Dhe rendi e stabiliteti nuk mund të krijohen në një shoqëri të polarizuar. As korrupsioni në një shoqëri të tillë nuk mund të luftohet. Duhen gjetur mekanizmat që një pjesë e pasurisë t’u kalojë atyre që janë më shumë në nevojë. Mekanizmat i gjen shteti në ato vende ku ka shtet në kuptimin e plotë të kësaj fjale. Në vendin tonë shteti është sa për formë.

Por ka vende me kapitalizëm qindravjeçarë. Në përpjekjet e tij për t’u zhvilluar më tej, kapitalizmi bëhet më human, të pasurit, pa ndërhyrjen e askujt, japin një pjesë të pasurisë për ata që janë më shumë në nevojë. Gjithkush e kupton se nuk mund të jesh i lumtur mes mjerimit. Ndihma për të tjerët në mos të bën të lumtur, të krijon përherë një gjendje shpirtërore që të jep kënaqësi. Të pasurit duhet të kuptojnë se kanë një armë të madhe, të fuqishme në dorë. Jo armë për të nënshtruar të tjerët, siç e kuptojnë dhe siç e përdorin pasurinë, por armë për ta zbutur dhe për të shëruar plagët e shoqërisë. Përdorimi i saj me vend është një avantazh i madh për ata që e kanë. “Për mendimin tim, - thotë filozofi Dalai Lama, - e vetmja epërsi e të qenurit i pasur, është se mund të ndihmosh më mirë të tjerët”. Filozofia popullore ngre lart dhurimin për njerëzit në nevojë. Kur ndonjë njeri shpëton nga ndonjë rrezik i sigurt, populli thotë: “ E shpëtoi një kafshatë bukë e dhanme. ” Natyrisht, kështu shprehet populli, por nuk është fjala për bukën, por për shumëçka. Por kur tjetri e përdor pasurinë për të nënshtruar dhe për të vrarë të tjerët, do të vrasë veten. Këtë e shpjegon mirë përralla “Për vete e ke”, botuar në vëllimin “Dasma me 300 nuse” (f.439).


Marrëdhëniet e mia me sponsorët, ndonëse janë të thjeshta dhe personale, nuk mund të mos kenë vlerë shoqërore, nuk mund të mos kenë edhe aspektin e tyre shoqëror, përveç atij personal.















> Unë kam parë me dhimbje plot njerëz, që e hapin gojën vesh më vesh duke buzëqeshur gjoja me shakatë dhe humorin plotë kripë të një idioti vetëm e vetëm pse ai është i pasur. Sponsorët e mi e sfidojnë këtë mentalitet të kastës së vetë. Dora që ata më zgjasin nuk është lëmoshtare. Dora që merr nuk është lypsare.

Unë jam shkrimtar dhe si i tillë, prodhoj vepra letrare ose diturore të fushave të tjera. Letërsia dhe arti janë për shoqërinë si mjete që amortizojnë goditjet shkatërrimtare. "Arti e zhduk dhunën dhe vetëm ai mund ta bëjë këtë. Misioni i tij është të krijojë mbretërinë e Zotit, domethënë Dashurinë" (Romen Roland). Kjo është aspirata e shoqërisë dhe të gjithë krijuesit që e meritojnë këtë emër, në mos e realizofshin këtë aspiratë, e kanë si synim të përhershëm. Njerëzit nuk janë të ndërgjegjësuar për këtë mision të artit. Madje ka edhe njerëz të ditur që thonë se arti nuk e bëri kurrë më të mirë jetën. Por ne nuk dimë si do të ishte jeta pa artin. Mbase do të ishte shumë herë më e varfër dhe më e keqe. Me sponsorët e mi ndryshon puna. Unë dhe ata jemi në një front. Ata janë njerëz të ditur dhe të kulturuar, gjysma e tyre kanë botuar vetë libra. Njeri prej tyre është piktor i mirë. Ata të gjithë kanë diploma që i kanë marrë me aftësi, disa kanë tituj dhe grada të merituara. Ata janë kolegët e mi të punës krijuese dhe unë ndiej kënaqësi të madhe kur me ta diskutoj probleme nga më të ndryshmet. Të tillë janë sponsorizuesit e mi: Faik Bruçi, Zabit Muda, Ramazan Biba, Shaban Bitri, Huzri Hoxha, Latif Miha, Musa Rriçku, Dilaver Laçi, Hasan Lleshi, Zyber Gjoni, Liman Hoxha, pa harruar edhe të ndjerin Agim Reçi që ka qenë sponsorizuesi im i parë. Unë këtyre njerëzve u jam shumë mirënjohës, sepse pa bujarinë e tyre librat e mi nuk do ta kishin parë dritën e botimit. Ata jo vetëm më kanë dhënë para, por këtë e kanë bërë me mënyrën më të mirë, me fisnikëri e delikatesë duke mos më vënë për asnjë çast në pozitën e vështirë të atij që detyrohet të kërkojë diçka. E theksoj një gjë të tillë se është shumë vështirë t'i drejtohesh dikujt për sponsorizim dhe të mos e ndjesh veten keq, për arsye se vepron ai ligji i përgjithshëm, i të gjitha shoqërive dhe i të gjitha kohërave, kur të pasurit dhe të varfërit kanë një hendek në mes. Në shoqërinë tonë, si rezultat i pasurimit vetëm të disave, janë krijuar kasta, që e brejnë shoqërinë nga brenda. Ja si shkruan Mark Tuen për një shoqëri të tillë: " . . . në një vend ku ka hierarki dhe kasta njeriu nuk është krejtësisht njeri, është vetëm pjesërisht njeri. Mjafton t'i tregojmë se qëndrojmë më lart si pozitë, në kategori shoqërore, në pasuri, dhe ai ul kryet para jush. Pas kësaj s'mund ta fyeni më. " Unë kam parë me dhimbje plot njerëz, që e hapin gojën vesh më vesh duke buzëqeshur gjoja me shakatë dhe humorin plotë kripë të një idioti vetëm e vetëm pse ai është i pasur. Sponsorët e mi e sfidojnë këtë mentalitet të kastës së vetë. Dora që ata më zgjasin nuk është lëmoshtare. Dora që merr nuk është lypsare.

Sh.S.: - Ju punoni shumë. Si e kaloni kohën, por edhe ku e gjeni kohën? A bëni plane krijuese?

Xh.M.: Përgjigja është një për të dyja pyetjet e para. Njerëzit e zakonshëm, përfshirë këtu edhe njerëz shumë të nderuar, por që kanë dalë në pension dhe që janë në moshë të shtyrë, e kanë problem si ta kalojnë kohën. Unë kam problem si ta përdor kohën. Krijuesi e ndërpret punën kur bëhet i pamundur për të punuar ose kur këtë gjë e bën vdekja që vjen papritur. Krijuesi vetë në mënyrë vullnetare nuk e le punën. Tek puna hyn edhe të lexuarit (unë lexoj shumë), edhe ndonjë udhëtim, qoftë edhe lëvizjet e vogla. Edhe një kafe, kur del dhe e pi jashtë Tiranës, të shijon më shumë dhe ke përfitim më të madh emocional nga pikëpamja e grumbullimit të mbresave. Megjithatë, kur nuk je i pasur, disa herë ngelesh edhe vetëm. Po duhet të dish të mësohesh edhe me vetminë. I pasuri blen gjithçka, edhe kohën që nuk blihet. Ka një tregim shumë të bukur O'Henri: djali i qahet babait sepse dashuronte një vajzë të klasës së tij (për nga pasuria), por, ngaqë ajo rrinte avion më avion duke shëtitur, ky nuk kishte arritur t'ia shfaqte dashurinë dhe kishte shumë frikë se këtë do ta bënte ndonjë tjetër para tij. Ajo edhe atë ditë ishte në udhëtim. Do të kthehej për pak kohë në qytetin ku jetonte djali. Babai i tha të merrte makinën dhe ta priste në aeroport, por rruga nga aeroporti në qytet bëhej për njëzet minuta. Çfarë mund t'i thoshte për kaq pak kohë? Nisu, se nuk dihet ç'bën Zoti, i tha i ati dhe ai u nis. Vajza zbriti dhe ajo pranoi të kthehej me makinën e djalit. Për fat rruga u bllokua. Qindra makina, autobusë, karroca, zetora, çdo gjë që është me rrota, kishte dalë në ato pak kilometra dhe vetëm mbas tri orësh rruga u zhbllokua. Djali jo vetëm ia shfaqi dashurinë vajzës, por edhe kishte filluar të mërzitej sado pak. Shkoi në shtëpi i qeshur dhe plot hare dhe i tha të atit se vërtet e kishte ndihmuar Zoti. Por atë moment dera u hap dhe hyri një zotëri që i kërkoi një çek babait të djalit. Ky i fundit kishte paguar shumë për bllokimin e rrugës që djali i tij të bisedonte me të dashurën. Blihet, pra, edhe koha nga të pasurit. Ne, me mjete jetese të kufizuara, duhet të kënaqemi me mënyra të tjera. Unë e kaloj kohën në punë. Jam familjarizuar me kompjuterin, por, ka raste, që shkruaj edhe me dorë. Dora i jep më mirë emocionet dhe mbresat se është pjesë organike jotja dhe, ndonëse është më e ngadaltë, është një përcjellës shumë interesant. Punoj në mënyrë të çrregullt, si të thuash. Herë shkruaj, herë korrektoj, herë i kthehem ndonjë libri për ta përmirësuar me shpresë se mund ta ribotoj, herë thjesht lexoj atë që e kam shkruar disa muaj, por edhe disa vite më parë. Shkrimtari nuk ka plane pesëvjeçare apo dhjetëvjeçare, por, sidoqoftë, ka plane. Si më të afërt kam realizmin e një botimi me studime, me rreth pesëqind faqe dhe ndahet në pesë prurje sipas fushave:

- Studime historike, kryesisht për ngjarje që janë trajtuar nga kënde të kundërta nga historiografia jonë në periudhën e sistemit totalitar; janë studime ndryshe, por jo ndryshe me fjalë, por me argumente, me fakte, me analiza sa historike aq edhe logjike. Shikohen ndryshe edhe ngjarje kulmore si Lidhja e Prizrenit, për shembull. Këtu hyjnë edhe ato libra historikë që mua më kanë pëlqyer për këndin e shikimit dhe që i kam analizuar.

- Studime letrare (vepra të letërsisë botërore) që shikohen nën një dritë të re. Kështu, si shembull, analizoj në këtë kapitull të gjatë veprat "I Huaji" i Kamysë, "Metamorfoza" e Kafkës, "Autostrada e Jugut" e Kortasarit, "Shtëpia e Matrionës" të Shollzenicinit, "Ora e gjermanishtes" e Zifrid Lenc etj. Nuk janë analiza të mërzitshme të kritikës së realizmit socialist. Janë ese me plot zbulime të reja, origjinale. Janë vepra me probleme të mëdha. Për shembull, "Ora e gjermanishtes" ka si problem qëndror të kuptuarit e detyrës. Sa shumë përfitohet nga një vepër e tillë!

- Studime (minimonografi) për njerëz të shquar, si Napoleoni, Abraham Linkolni, Niçe, Balzaku, Xhek Londoni, Tolstoi etj. I kam shkruar në formë eseje, rreth dhjetë-dymbëdhjetë faqe secila prej tyre, por me detaje, me elementë të zgjedhur në mënyrë që lexuesi të përfitojë gati sikur ta ketë lexuar secilën prej librave më vete. Unë jam mbështetur tek shumë monografi të plota për të dhënë ato dhjetë faqe. Por kryesorja qëndron në faktin se jam mbështetur tek zemra dhe dashuria ime për këto figura. Monografitë për njerëzit e mëdhenj janë shumë të dashura për mua. Unë frymëzohem shumë nga jetët e njerëzve të mëdhenj. Por dua që edhe të tjerët, sidomos të rinjtë, të frymëzohen nga jetët e njerëzve të mëdhenj.

- Studim për veprën "Lahuta e Malcis" të Gjergj Fishtës, për të dhënë nëpërmjet këngëve të ndryshme mesazhet kryesore të poetit të madh. Por kam zgjedhur pikërisht ato mesazhe që korrespondojnë me një kuptim të ri, ndryshe, të shumë ngjarjeve historike, ndryshe, siç kuptoheshin dhe interpretoheshin në sistemin totalitar.

Nuk nisem nga fakti që nëse një gjë që është thënë në sistemin totalitar në një mënyrë, tani të thuhet krejt ndryshe, të përmbyset. Jo, përmbysja e kuptuar kështu në mënyrë mekanike, kthyer kokëposhtë, nuk ka të bëjë me mendimin ndryshe. Për këtë na jep një mësim të mirë studiuesi i thellë dhe origjinal Hysamedin Feraj që thotë: "Antienverizmi nuk është e kundërta e thjeshtë e enverizmit, por e kundërta reale e tij. Kështu antienverizëm nuk është veprimi që thotë "meqenëse Enveri thoshte se jemi të rrethuar me armiq, për të qenë antienveristë, duhet thënë se jemi të rrethuar me miq. . . Antienverizmi është aftësimi i njerëzve për të menduar në mënyrë konkrete e reale dhe jo përgjithësuese shabllone totalizuese-jodalluese, që fut në një thes miq dhe armiq, të mirën dhe të keqen, politikën antishqiptare dhe politikën proshqiptare etj. " Në vitet e para të sistemit demokratik, kur plehrat rreth pallateve kishin arritur deri në gju, gratë e disa burra dolën për t'i pastruar, por një nga kuadrot drejtues i futi brenda duke u thënë: "Mos doni të na ktheni në kohën e Enverit ?"

Pra, unë nuk nisem nga kjo bazë e gabuar për ta kundërshtuar apriori atë që është thënë ose bërë ndryshe në sistemin totalitar. Edhe kur kam shkruar për Halil Alinë, ngjarjet e luftës i kam parë në mënyrë konkrete, me pasoja konkrete dhe të zhvilluara në një skenë konkrete, me një popullsi me një mentalitet konkret, larg çdo shabllonizmi dhe përgjithësimi.

Natyrisht, Fishta që nuk e ka jetuar sistemin totalitar shqiptar, nuk kishte si të nisej nga dëshira për ta kundërshtuar atë sistem. Por duhet ta dimë se totalitarizmi në Shqipëri është i vonë, por si sistem, si mënyrë të menduari dhe të gjykuari, ai ka qenë i hershëm, prandaj edhe Fishta shumë gjëra i koncepton dhe i mendon në kundërshtim me këtë sistem. Kështu, si shembull, Fishta jep shpjegime të tjera dhe origjinale për probleme të tilla historike, si: përse u islamizuan shqiptarët, përse shqiptarët duhej të zgjidhnin midis dy armiqve atë që ishte më pak i rrezikshëm, përse shqiptarët gabuan në shumë kthesa me rëndësi në Lëvizjen tonë Kombëtare, përse shqiptarët ishin kundër Luftës Ballkanike etj. Ta shikosh veprën e Fishtës edhe nga këto aspekte, kam mendimin se është një kontribut për studimin tërësorë të saj, sepse i hiqet sadopak ai lëmashku që i është hedhur përsipër në regjimin diktatorial.

- Studimi për thënie të njerëzve të shquar të njerëzimit. Këtu janë përfshirë edhe pak autorë shqiptarë, nga më të mirë. Ky është një kapitull i gjatë, që ia sjell lexuesit me mbresat dhe përftesat e mia nga leximet gjatë dyzet vjetëve, kryesisht në formë citatesh, në ligjëratë të drejtë, nga vepra dhe autorë botërorë. Por nuk kanë formën e aforizmave, ka edhe argumentime nganjëherë të gjata. Shkurt, nuk janë thjesht për të bërë përshtypje, por për të të bërë të mendosh. Ka thënie nga të gjitha fushat.

Edhe këto shënime unë i kam dhënë si krijues, sepse janë jo vetëm zgjedhja dhe parapëlqimi im, por që edhe çdo mendim sjellë risi, ka një kënd të ri shikimi. Gjithmonë kur shkruaj, çfarëdo gjëje, kam parasysh atë që ka thënë një dijetar se "Vepra artistike është formë dhe përmbajtje, rrëfim e mashtrim, lojë e porosi, afër dhe larg natyrës, ka edhe s'ka qëllim, historike e johistorike, personale e mbipersonale në të njëjtën kohë. "(Izetbegoviq)

Intervistoi: Shaqir Skarra

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?
SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!
< rrugaearberit@gmail.com >

Në Zakynthos ndodhen afërsisht 6000 emigrantë shqiptarë.
Shumica prej tyre janë nga Dibra dhe me familje.

emigracion

Në ishullin grek të dibranëve



Nga Zakynthos-i
MENTOR HOXHA

Zakynthos-i është një ndër dyqind ishujt më të bukur që ka Greqia. Shquhet për ujërat e kristalta, pafundësinë e gjelbërimit, rërën e shkrifët dhe shpellat nënujore fantastike. Ndodhet tre orë larg nga qyteti i Patras. Rruga nga Patra për në Zakynthos zgjat 1 orë e 15 minuta me autobuz dhe një orë e 20 minuta me traget, i cili niset nga porti i Kilinit. Simboli i ishullit është breshka e detit Kareta-Kareta. Ullishtet dhe vreshtat nuk kanë të mbaruar. Zakynthos-i është përfshirë në të gjitha guidat, kalendarët, kartolinat dhe portalet turistike si një ndër bukuritë greke që duhet vizituar patjetër. Ishulli është vizituar nga miliona turistë nga mbarë globi. Muajt e verës janë muajt më të bukur të ishullit.

NË RRJEDHËN E HISTORISË

Zakynthos-i njihet në historinë greke si ishulli i dytë i banuar. Zakynthianët ishin të famshëm që në kohën antike. Pjesa më e madhe e mëtënjësve të pallatit mbretëror të Odyseut në Ithaki (Itaka) që kërkonin të martoheshin me Penelopën, pas mungesës 18 -vjeçare të Odiseut, i cili kishte marrë pjesë në Luftën e Trojës për të marrë Helenën e bukur greke, gruan e mbretit grek, Menelaut ishin nga Zakynthos-i. Ky ishull është sunduar nga maqedonasit, venetianët, bizantët dhe britanikët. Më 1809 britanikët formuan shtetin e Jonit dhe Zakynthos-i u bë kryeqytet. Më1863 anglezët i dhanë fund dominimit të ishullit dhe ishulli u bë pjesë e Greqisë.

VENDLINDJA E POETIT KOMBËTAR TË GREQISË

Në Zakynthos kanë lindur shumë figura të shquara greke, emrat e të cilëve ndodhen në muzeumin "Zakynthianët e famshëm". Ndër ta spikat figura e Dionisios Solomos-it, i cili ka shkruar Himnin Kombëtar të Popullit Grek. Fama e tij në Greqi dhe në botë i detyrohet poemës së famshme "Imnos is tin Eleftehria" (Hymni i Lirisë), i cili është Himni Kombëtar i Greqisë. Njëra nga pjesët e kësaj vepre u inspirua nga lufta e grekërve kundër ushtrive pushtuese turke më1821. Me vdekjen e tij më1857 mbarë Greqia vajtoi për të. Figurë tjetër e letrave greke nga Zakynthosi është edhe poeti Kavlos. Figura më e dashur për Zakynthianët është padyshim Sainti Dyonysios, i konsideruar si mbrojtësi i ishullit. Çdo 24 korrik, trupi i tij i balsamosur në një kuti xhami nxirret nga vendi ku ruhet dhe qarkullon në mbarë qytetin nën vështrimin e mijëra zakynthianëve. Kjo ditë është festa më e madhe për banorët e këtij ishulli. Në Zakynthos ka lindur edhe bukuroshja dhe prezantuesja më e talentuar e media-s greke,Eleni Menegaki, si dhe shumë figura të tjera të shquara. Në Zakynthos më 7 tetor 2009 ka lindur edhe djali im i vetëm Mario, i cili tre vite i ka kaluar këtu. Po në këtë ishull, ka kaluar një pjesë të jetës së tij si azilant politik edhe ish presidenti i parë komunist Omer Nishani. Pas rrëzimit të qeverisë së Fan Nolit nga Ahmet Zogu në dhjetor 1924, Nishani bashkë me ish kryeministrin Fan Noli dhe mjaft figura të tjera patriotike shqiptare lanë atdheun nga frika e hakmarrjes politike nga regjimi i Ahmet Zogu. Omer Nishani, u vetëvra gjatë regjimit komunist.

Qyteti i Zakynthosi-t ndodhet në jugperëndim të bregdetit. Pas tij lartësohet kështjella venetiane. Më tej "Stralli Hills" me pamje fantastike. Brenda qytetit ndodhet një shëtitore e madhe me ndërtesa neoklasike, kisha me kulla të larta, rrugë të gjera, shtëpi me harqe e porta dekorative. Një qytet pothuajse i rindërtuar pas tërmetit të fuqishëm të 1953-ishit që e shkatërroi atë pothuajse krejtësisht. Rrugët nga qyteti të çojnë në të gjithë ishullin.

Vende për tu vizituar janë "Museum of Solomos", "Zakynthianët e famshëm" dhe "Kisha e Sainti Dyonysios". Rrethina më bukur e qytetit është Bohali. Teksa hanim këtu një darkë me mikun tim, Rakip Suli, qyteti na dukej si në pëllëmbë të dorës. Ekonomia e vendasve varet nga turizmi, ullishtet, vreshtaria dhe peshkimi. Pjata e preferuar e vendasve është peshku, ndërsa nga pijet është vera. Jeta e natës është një tjetër mrekulli e ishullit, ku mijëra turistë gjatë muajve të verës shijojnë deri në mëngjes baret, diskot dhe buzuqet me muzikë greke. Plazhet e Cilivisë dhe diskot e Laganasë janë të njohura në mbarë Greqinë dhe në botë për jetën e natës që bëhet.

ZAKYNTHOS-I, DESTINACIONI I PREFERUAR I DEPUTETËVE DIBRANË

Ky ishull me plot plazhe të mrekullueshme dhe bukuri marramendëse ka tërhequr edhe vëmendjen e politikanëve dhe të deputetëve nga Dibra. Njëri ndër ta është deputeti i Tiranës, por i lindur në Dibër, Rakip Suli. Ai ka shëtitur në çdo cep të Evropës dhe të Amerikës, por Zakynthosi i ka pëlqyer më shumë. Kështu që për dy vite radhazi ai i kalon pushimet familjarisht në këtë ishull. "Ajo që më tërheq më shumë nga ky ishull,-thotë ai,është pastërtia e detit, gjelbërimi i paanë, qetësia, shërbimi dhe peshku i freskët i gatuar mjeshtërisht nga taverna e njohur greke "Limanaki" dhe "Zorbas". Vizitorë të ishullit këtë vit u bënë edhe nipat dhe mbesa ime, të cilët mbetën shumë të impresionuar. Ishullin e kanë vizituar dhe shumë turistë të tjerë nga Dibra.


KONTRIBUTI I DIBRANËVE NË ZHVILLIMIN E ISHULLIT

Në Zakynthos ndodhen afërsisht 6000 emigrantë shqiptarë. Shumica prej tyre janë nga Dibra dhe me familje. Kriza në Greqi ka venitur shpresën e shumë prej tyre, të cilët mendojnë të rikthehen në vendlindjen e tyre. Emigranti i parë nga Dibra që shkeli në këtë ishull është Haki Ferhati, një sipërmarrës dhe gurëgdhendës mjaft i njohur në ishull. Gjatë një bisede me të për gazetën "Rruga e Arbërit" ai na tregon gjithçka mbi ishullin." "Rrugën e parë në Greqi, na thotë ai, e kam bërë më 1990 me Arif Micin, Selami Lamin dhe Mina Elezin. Selami Lami kapet në Patra nga policia greke, ndërsa unë dhe Minai përfundojmë në Zakynthos. Zakynthosi nuk kishte kaq shumë ndërtesa, bare, taverna, restorante dhe hotele luksoze sa sot. Ishin kaq pak sa numëroheshin me gishtat e dorës. Në Cilivi, më e njohura ishte taverna "Limanaki", aq sa për të ngrënë një darkë atje duhej prenotuar më parë. Unë tërhoqa edhe vëllezërit e mi dhe byrazerin tim Bilal Danin, i cili edhe ai tërheq nipërit dhe mbesat e tij.

Kështu gradualisht numri i dibranëve në ishull u shtua shumë. Si rezultat i investimeve nga shteti dhe nga vendasit puna u shtua shumë, kështu që u rrit edhe numri i turistëve.

Në sajë të punës titanike të mjeshtërve duarartë dibranë dhe të shqiptarëve të tjerë u ndërtuan të gjitha banesat, hotelet dhe baret e bukura që sot janë në ishull. Emigrantët dibranë po kujdesen dhe po i mirëmbajnë ato duke shërbyer me përkushtim e devotshmëri. Dibranët i gjen si gurgdhendës, pllakaxhinj, suvaxhinj, bojaxhinj, armaturë, servitorë, kuzhinierë, banakierë,etj. Armand Karoshi dhe Ilir Mikli janë banakierët më të njohur të ishullit, ndërsa Valter Kola një bojaxhi i talentuar që ka lyer gjysmën e ishullit. Pothuajse të gjitha punët në ishull mbajnë dorën mjeshtërore të gurëgdhendësve dibranë Haki Ferhati, Idriz Ferhati, Lutfi Ferhati, Flamur Ferhati, Shpëtim Buci, Bilal Buci, Ali Krrashi, Fatmir Krrashi, Ymer Lika, Fil Suli, Lam Plaku, bojaxhijnjve Bilal Dani, Valter Kola, Alban Lusha, pllakaxhinjve Skënder Dani, suvaxhijve Avdi Kaca, Besnik Mikli, saldatorëve Shpëtim Mikli dhe Fitim Lleshi. I ndjeri Shpëtim Mikli,u shua përgjithmonë nga jeta në kulmin e moshës më të bukur. Vdiq nga një sëmundje e rëndë. Duke lënë pas një vajzë 3 vjeçe, të lindur në këtë ishull. Një punë të madhe në ishull kanë bërë edhe Shkëlzen Hasani, JaheLusha, Zabit Karoshi, Jetmir Karoshi, Rrem Loka, Arben Shehu, Miklovan Ashiku, Nard Ashiku, Bedri Ashiku, etj. Shumë prej të rinjve emigrantë që banojnë në ishull, kanë lindur këtu,ose kanë ardhur shumë të vegjël. Disa prej tyre studiojnë edhe në Universitetet e njohura greke, si Lena Hasani, e cila është në vit të dytë në Universitetin e Larisas, në degën e turizmit.

Zakynthos, 26 gusht 2013



NË ZAKYNTHOS

...Këtu qielli është blu
Det e rërë sheh ngado
Gjithë bota vjen këtu
Mrekullitë që të shoh.

Nëpër rrugët me asfalt
Gjëmon zëri i turistëve
Dashuria rrjedh si mjaltë
Në bregdet e në ullishte.

Porsi zogu rend dhe unë
Përmes rërës dhe qytetit
I kaloj netët pa gjumë
Dehur keq nga jodi i detit.

Rrugët mbushur me turistë
Ardhur nga ana e anës
Kurse unë në shtetin fqinj
Sjell aromën e Tiranës.

Më gëzon kjo lumturi
Shpirtin keqaz po ma ndez
...Që do iki ndjej mërzi
Të rikthehem mezi pres.

lajme

Ish ushtarët e UÇK-së, rikthim pas 14 vitesh në Mat

Një grup ish ushtarësh kosovarë të stërvitur në Mat, pas 14 vitesh, janë rikthyer në repartin ushtarak të Mollzave, në rrethin e Matit, ku dhe janë stërvitur për tu rreshtuar më pas në radhët e UÇK-së, për çlirimin e Kosovës. Kështu rreth 40 ish rekrutë kosovarë të stërvitur në rrethin e Matit, për pjesëmarrje në formacionet ushtarake të UÇK-së për çlirimin e Kosovës nga pushtuesit serbomëdhenj, janë rikthyer gjatë këtyre ditëve të gushtit, për të bërë një vizitë në rrethin e Matit, në memorie të stërvitjes së tyre në repartin ushtarak të Mollzave, për tu rreshtuar më pas në radhët e UÇK-së, për çlirimin e Kosovës. Natyrshëm që vizita e parë e tyre ka qenë në repartin e Mollëzave, ku dhe u stërvitën për tu rreshtuar në radhët e UÇK-së. Më pas ky grup kosovarësh është drejtuar në repartin ushtarak "Kodra e Palit". Kjo vizitë ishte një ritakim me ish eprorët ushtarak shqiptar ku me këtë rast kujtuan shumë ngjarje dhe mbresa të asaj kohe, kur dhe ata plot pasion stërviteshin për të çliruar Kosovën martire. Në fjalën e tyre ata u shprehën se kemi një respekt të veçantë për popullin e Matit, që u tregua mjaft mikpritës e dashamirës ndaj nesh. Një gjë e tillë u tregua edhe gjatë mikpritjes së një numri mjaft të madh refugjatësh nga Kosova, të cilët u strehuan në rrethin e Matit, si shkak i depërtimit të tyre nga serbomëdhenjtë, gjatë luftimeve në Kosovë.

Në këtë vizitë, grupi i ish ushtarëve të UÇK-së, ishte i shoqëruar edhe nga nënkryetari i Bashkisë Burrel z. Mexhit Sina. Ai i falënderoi miqtë kosovarë të ardhur nga Kosova, të cilët ndërmorën këtë udhëtim për tu njohur me mirë me rrethin e Matit, i cili gjatë periudhës së luftës së Kosovës u bë një epiqendër për përgatitjen e ushtarëve të UCK-së dhe pritjen e refugjatëve kosovar.

Në këtë promemorie e mori fjalën Enver Rustemi, ish Komandant i Drejtimit te UCK-së, i cili tregoi ngjarje dhe histori të cilat ishin të lidhura si me përgatitjen e ushtarëve të UCK-së, ashtu edhe me mikpritjen e qytetarëve të Burrelit të cilët akomoduan rreth pesëmijë persona të deportuar nga Kosova si pasojë e represionit serbomadh.

Më pas e mori fjalën ish komandanti i qendrës stërvitore



për logjistikën Burrel, z. Rexhë Krasniqi, i cili tha ndër të tjera se ato ditë të vështira unë kujtoj me mirënjohje e nostalgji mikpritjen që bëri populli i Matit për ne dhe popullsinë e deportuar nga Kosova.



Edhe shumë ish ushtarakë dhe përfaqësues të tjerë të UÇK-së, u bënë pjesë e kësaj vizite të zhvilluar në rrethin e Matit të cilët kujtuan me nostalgji pjesë nga koha kur ata ishin në qytetin e Burrelit, ku dhe u stërvitën dhe u rreshtuan më pas në radhët e luftëtarëve të UÇK-së.

Ish komandanti i UÇK-së, Rexhë Krasniqi, në lidhje me akuzat e ish Prokurores së Hagës Karla Del Ponte dhe më pas të Dick Marty, për transplant organesh të ushtarëve serbë, nga UÇK-ja, në të ashtuquajturën "Shtëpia e Verdhë" në fshatin Gurrë të Burrelit, tha se kjo është një absurditet i kohës dhe kokave të sëmura serbe, pasi unë jam një prej atyre që kam qenë tërë kohës në Burrel, si komandant i qendrës stërvitore në Mollxa. Ne në atë kohë ballafaqoheshim me vështirësitë tona për të stërvitur ushtarët dhe për përballimin e furnizimit me ushqime dhe me armë e mjete të tjera të nevojshme për të përballuar represionin serbomadh.

Askujt nuk duhet ti shkojë mëndja për çfarë flet zonja Karla Del Ponte dhe Dick Marty të cilët kanë rënë nën ndikimin e mendimit të kuzhinave serbe për të trilluar imagjinata të tilla të tmerrshme në Burrel apo në të ashtuquajturën "Shtëpia e Verdhë".

Une, ka vijuar në fjalën e tij Krasniqi, i quaj këta njerëz të sëmurë, që u duhet të bëjnë kontrolle mjekësore, pasi fantazitë dhe imagjinatat e sëmura të tyre, janë të hedhura poshtë, pasi nuk kanë asgjë të përbashkët me realitetin.

Hysen Likdisha

Vëzhgim

Bulqizë, kur të shtrohesh në spital, merr lugën me vete

Nëse shtrohesh për mjekim në spitalin e Bulqizës, duhet me patjetër që të marrësh edhe lugë me vete.

Aktualisht ky spital nuk plotëson as kushtet optimale të një qendre shëndetësore, pasi prej vitesh aty mungojnë shërbimet kryesore shëndetësore ndaj pacientëve si ai kirurgjikal, anestezisto-reaminator, otorinolaringolog, obstetër-gjinekolog etj, etj, ku rreth 50 mijë banorë të këtij rrethi duhet të marrin rrugën drejt Peshkopisë, Burrelit dhe Tiranës, për marrjen e këtyre shërbimeve, kuptohet me kosto tejet të larta për ta.

Të gjitha këto shërbime shëndetësore, por veçanërisht ai kirurgjikal për Bulqizën, më tepër se i nevojshëm mbetet i domosdoshëm, pasi në pellgun krommbajtës Bulqizë-Tërnovë-Martanesh, punojnë mbi 100 firma private me mbi 1200 punëtorë, përfshirë edhe atë koncensionare ACR aktualisht Balfin grup, të cilat shfrytëzojnë galeri kromnxjerrëse, ku aksidentet për minatorët që punojnë në to mbeten permanente dhe për trajtimin e tyre nevojitet shërbimi kirurgjikal. Por, ky shërbim çuditërisht në spitalin e Bulqizës mungon prej vitesh. Dhe si të mos mjaftonte kjo, gjendja në këtë spital ka ceduar edhe në drejtime të tjera.

Kështu aktualisht kushtet në këtë spital kanë rënë dukshëm dhe lënë shumë për të dëshiruar duke nisur që nga ata higjienosanitare të ambienteve, ushqimi etj. Bajram Duka, minator i shtruar në këtë spital pasi gjatë muajit gusht u aksidentua gjatë punës në minierë, ku për pasojë "humbi" dy gishta të njërës dorë në një nga galeritë e kromit ku punonte, thotë për "Rruga e Arbërit", se prej tri ditësh i shtruar në këtë spital, nuk kishte provuar gjellë me mish, por vetëm fasule.

Madje çuditërisht, thotë ai, në spital mungojnë edhe lugët e gjellës, të cilën çdo i shtruar duhet ta sigurojë atë nga shtëpia, ndryshe mbetesh pa ngrënë edhe fasulen që gatuan spitali si gjellën më të përdorshme për pacientët.

H. Likdisha

lajme - Bulqizë

Aksidenti në Zonën D të minierës, vdes minatori

Fillimgushti ka përkuar me një ngjarje të rëndë në minierën e Bulqizës, më saktë në Zonën D të kësaj miniere, ku ka humbur jetën një minator, teksa punonte në një nga galeritë e pasigurta dhe të paligjshme të kësaj zone. Ka qenë ky një tjetër aksident i radhës dhe i paqartë si për vendndodhjen, ashtu edhe për mënyrën se si ka ndodhur, pasi asnjë nuk ka preferuar të flasë në lidhje me këtë aksident.

Ngjarja e rëndë ndodhi në një nga galeritë e paligjshme dhe tejet të pasigurta të Zonës D të minierës. Burime nga policia lokale bënë me dije, në lidhje me këtë ngjarje, se gjatë punës për nxjerrjen e mineralit të kromit, në një nga galeritë që shfrytëzohen në rrugë të paligjshme në këtë zonë, ka humbur jetën në rrethana misterioze minatori Shahin Peti, 30 vjeç.

Po sipas këtyre burimeve, u mësua se minatori i vrarë ishte nga Fushë-Bulqiza, baba i dy fëmijëve të mbetur tashmë jetimë. Fakti që galeria shfrytëzohej në rrugë të jashtëligjshme si dhe mjaft të tjera në këtë zonë me rrezikshmëri të lartë, ka bërë që të mos jepen detaje për ndodhjen e këtij aksidenti të rëndë, ku humbi jetën 30 vjeçari.

Ndërkohë burime të tërthorta nga miniera, artikuluan se aksidenti ka ndodhur sapo viktima ka nisur punën, por kufoma është dërguar pranë morgut të spitalit të Bulqizës vetëm gjatë orëve të mbrëmjes, pasi askush nuk ka preferuar të japë detaje për ndodhjen e kësaj ngjarje. Sipas policisë mësohet se ajo ka shkuar në vendngjarje për zbardhjen e kësaj ngjarje tejet të rëndë, ku dhe e ka klasifikuar atë si të ndodhur aksidentalisht, ku viktima punonte në një galeri të paligjshme për nxjerrjen e mineralit.

Përplasen dy furgonë, 5 të plagosur njëri prej të cilëve në gjendje të rëndë

Një tjetër ngjarje e rëndë e regjistruar gjatë dyjavorit të parë të muajit gusht, në rrethin e Bulqizës, ka qenë edhe përplasja e dy furgonëve, ku për pasojë u plagosën 5 persona, njëri prej të cilëve në gjendje të rëndë.

Ngjarja është regjistruar në të ashtuquajturën Rruga e Arbërit fare pranë qytetit të Bulqizës, në dalje të tij drejt Peshkopisë, në vendin e quajtur Ura e Vocit. Burime nga policia konfirmuan se dy furgonë njëri me pasagjerë dhe tjetri mallrash, janë përplasur me njëri tjetrin teksa po udhëtonin drejt Peshkopisë. Si rezultat i kësaj përplasje dy furgonët kanë përfunduar në dy krahët e segmentit rrugor. Furgoni i pasagjerëve me targa AA 418 FY me drejtues Klodian Nuredini, që vinte nga Elbasani drejt Dibrës, për një rast familiar gëzimi, ka përfunduar në anën e sipërme të segmentit rrugor, ku si pasojë janë plagosur 5 persona që udhëtonin me të.

Po sipas burimeve nga policia, u bë me dije se njëri nga të plagosurit, drejtuesi i mjetit, Klodian Nuredini, 26 vjec, është plagosur në gjendje të rëndë. I plagosuri në gjendje të rëndë edhe për mungesë të mjekëve specialistë në spitalin e Bulqizës, është transportuar me helikopter drejt Spitalit Ushtarak në Tiranë, për të marrë një ndihmë mjeksore më të kualifikuar.

Ndërsa 4 personat e tjerë, u mjekuan në spitalin e Bulqizës, jasht rrezikut për jetën. Në vendngjarje kanë shkuar edhe forca të policisë rrugore për të përcaktuar shkaqet e kësaj ngjarje.

Libër i ri



Selman Mëziu
ANJSHTAJNI I PËRCËLLUEM

Gentgrafik
ISBN: 978-99956-51-52-7
Çmimi: 700 lekë

Skica, tregime, shënime udhëtimi, reportazhe, meditime.


Rruga e Arbërit nr. 88

Vështrim për librin e autorit Arian Kadiu
“Enciklopedi - Edhe 100 figura dibranësh”

kritikë

Kur sjell thëngjijtë e një zjarri të pashuar në një enciklopedi

***Nga* NAMIK SELMANI**, *Shkrimtar*



Kur nisa të sythoj mendimet për librin që kemi të gjithë sot në duar të Profesor Arian Kadiut “ Edhe 100 figura dibranësh” që është vazhdimi i librit “Enciklopedi” që u botua me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipqrisë përnjëherë më shkoi mendja te Motivi i Krushqërimit. E këtë përurim do ta quaja edhe një lloj “dasme librore”. Bash si në Dibër ashtu edhe në Çamëri në Labëri, në Kosovë, në Myzeqe e në i liridë. Motivi i Krushqërimit të një dasme është gati i njëjtë si pika e ujit të një strehe, pavarësisht se në cilin varg njerëzor vihesh për të shkuar në një shtëpi tjetër. Pavarësisht se cilët rite të veçanta që mund të ketë ajo. Apo dhe ku mund të rreshtohesh si kryekrushk apo si krushk i zakonshëm. Përtej shendit që mbulon shpirtin njerëzor, si në asnjë ditë tjetër të jetës kolektive e përtej asaj dore që mund të mbajë një bajrak, është detyrimi për ta bërë sa më mirë detyrën në kohën e duhur e në vendin e duhur, për të dërguar në kullë apo në vilën e mbytyr nga blerimi nusen e bukur mes këngës e valles.

E pra, unë, po mendoj se edhe ju do të jeni të një mendjeje me mua, do të thoja se, kur prekim këtë vepër të bukur, të dobishme për të gjithë ata që bëhen krushq me Bajrakun e Fjalës, uroj për këtë libër autorin. E uroj pëer susese të reja për këtë libër që do ta quanim ndryshe edhe “Libër të librave”

Libra të tilë si ky që kemi në duar e kanë të sigurtë jetëgjatësinë e tyre. Ato nuk janë vetëm libra nënjastëku, po janë libra që mbeten në tavolinë dhe e ke të vështirë që t’i heqësh që andej. Me këto 100 personalitete ai të ngjit në Monumentin e Kujtesës së Ndritur për ata që i kanë shërbyer apo edhe që i shërbejnë jo vetëm Dibrave, po edhe mbarë kombit. Motivi i dytë që dua t’ju kujtoj e t’ju përcjell është kujtesa se libri botohet në kuadrin e 1000-vjetorit të copëtimit të trojeve shqiptare nga Fuqitë e mëdha. Atëherë të ndarë forcërisht e shumë dibranëve merrnin udhët e maleve me shumë sfida udhe për të ardhur në Tiranë,\. Mes atyre dhjetra veprimtarive historike kulturore që organizohen në Dibër e në Tiranë unë do të shtoja edhe këtë përurim libri që ka brenda vetes simbolikën më të spikatur të një Bashkimi njerëzor i dealesh të personaliteteve të të dy Dibrave. Dikur mbetën pas gardhit të piramidave kufitare dhe kloneve Dibra, Kosova, Çamëria, Ulqini, Tivari. Me shkronjën e mençur .

Ashtu të vënë pranë njëri-tjetrit sheh në të personalitete të këndej e matanë kufirit me një ndarje simbolike që ka në qendër fjalën “ Dibër” Sheh mësuesët, mjeshtërit, rilindasit, veprimtarët shoqërorë, arkeologët, skulptorët piktorët, mjekët, gjeologët pushtetarët, sportistët, gazetarët, shkrimtarët, këngëtarët, luftëtarët, klerikë, etj ata duket se janë vënë në një Sofër, në një Odë dibrane të vetme duke u kujdesur që secili të ketë vendin e vet, dritën e vet. Edhe tani, kur formalisht kufinjtë janë ende të ndarë, libri i Profesor Arian Kadiut simbolikisht ka bashkuar ka i deuar dhe ndërtuar një Shqipëri pa kufinj. E kur sheh se si janë bashkuar kaq mirë personalitete të fushave të ndryshme edhe çdo bashkim tjetër është më se i mundshëm. Është shumë profesonist ky libër se ai nuk është ndalur vetëm në trajtimin e figurave që mund t’i takosh në Dibër, në Tiranë ose në ndonjë rrethinë, po ai i ka parë këta personalitete edhe në aktivitetin që ata kanë patur në vende të ndryshëm deri në SHBA që natyrisht i ka kushtuar shumë kohë dhe shumë energji.

Rituali që të vjen në mendje në këtë dasëm librore është pa dyshim edhe testi njerëzor që tregon fuqinë dhe fqinjësinë më të mirë gati hyjnore jo vetëm për Dibrën, por edhe për mbarë trojet shqiptare. Përballë një jete sociale që i largohet paksa edhe kolektivitetit e aq më tepër edhe humanizmit. Duket paksa e vjetëruar ai ndërrim gjellësh, frutash, ëmbëlsirash që bëhet në shtëpitë e fqinjëve të mirë e vëllezërve të mirë. Zonja e shtëpisë i dërgonte fqinjës një pjesë të gjellës të së veçantë, ëmbëlsirë dhe të nesërmen pjata bashkë me urimet shumë të ngrohta i kthente pjatën medoemos edhe me një gjë tjetër . Ndoshta me një grusht arra, . Me një ftua erëmirë të nxjerrë nga sepetet një shegë, një varg me fiq Kurrë, kurrë bosh.

Sot dibrani i mençur dhe i dashuruari pas librit Arian Kadiu ka shkuar në jo më pak se 200 shtëpi të personaliteteve që ai ka rreshtuar në enciklopedinë e tij . Jo , ai ka shkuar në qindra shtëpi të fëmijëve të tyre , të pasaardhësve të tyre. Ka vrapuar më shumë bujari në sa e sa biblioteka të lexuesve dibranë, të Dibrës së Madhe, që kendej e tutje kanë një libër shumë serioz të tillë që do t’i referohen për ngjarje të mëdha të jetës së tyre historike kulturore folklorike etj E ashtu si themi në atë këmbin të një gjelle të një byreku po shumë më tepër se ka të gjithë me shumë dashuri e respekt “Faleminderit e t’u rritë ndera, profesor!” Përtej këtyre riteve do të bënim atë pyetje së cilës nuk i shpëton asnjë libër pavarësisht se ku shkruhet e se ku botohet. Në këtë botë të madhe ku botohen shumë libra në në sasi por edhe në cilësi e në përmbajtje, në numër, në cilësi kapakësh specialë apo të thjeshtë në foto me e pa ngjyra do të drejtojë pyetjen: “Cili është libri që do t’i qëndrojë sa më shumë në garën e Kujtesës?”

Ky është një libër që e vëmë në vendin më të ndritur të tavolinës e ku jo vetëm ai që e ka sjellë në shtëpi por të gjithë brezat e familjes e shfetojnë atë vazhdimisht. E ka këtë libër në tavolinë historiani etnografi, folkloristi, komunitetet fetare, stafet e komunave e të bashkive që të shohin njerëzit më të nderuar të pjesës së tyre gjeografike të krahinës e më gjërë. Jo më pak këtë libër do ta përdorin edhe shkrimtarët, poetët, tregimtarët që mund të gjejnë në të sa e sa subjekte i nteresante për veprat e tyre të ardhshme, për romanet për studimet e ndryshme.


E kërkojnë atë sociologët. Jo më pak e shohin atë e duhet ta shohin e ta studiojnë edhe kundërshtarët tanë tradicionalë për të parë pjesën tone, të vërtetën tonë historike sociale. Ne, si komb kemi një përvojë të hidhur të botimit të enciklopedive ku shtrembërohet e vërteta e gjëja më e mirë që duhet të bëjmë veç denoncimit të tyre eshtë shkrimi i librave që i sfidojnë këto vepra dashakeqe që lënë gjurmë të hidhura në historinë e në bashkëjetesën mes kombeve në Ballkan

Një lexues i çfarëdo niveli qoftë apo një shkronjshkrues i të gjithë gjinive letrare përherë e ka parë enciklopeditë si një majë të vërtetë të i nformacionit, të këmbënguljes, të pasionit të shkrimit, të dashurisë për atë që shkruan. Ndjesia që të vjen në kur lexon, shfleton e rishfleton enciklopedinë në dy vëllimet e Profesor Arian Kadiut jeton brenda një ndjesie të re të bukur e pse jo edhe emocionuese, pavarësisht se nga cila krahinë je e se në cilin vend jeton. Besoj se të gjithë jemi të një mendjeje se enciklopeditë e shkruara në kohëra kanë qenë dhe mbeten fryt i një pune shumëpla-nëshe, shumë këmbëngulëse, e pse jo edhe shumë të dobishme për sot dhe për nesër. Duke e bërë falenderimin dhe urimin për suksese të mëtejshme në botimin e librave të tjerë, sot m’u kujtua edhe pasioni i madh i një rilindasi të shquar të kombit tonë që në shekullin XIX botoi Encikopedinë në gjuhën turke Sami Frashëri që edhe sot e kësaj ditë në këtë vend me kulturë të zhvilluar mbetet një botim unikal dhe shumë e vlerësuar në qarqet akademike turke e botërore. Nuk e teprojmë që të themi se edhe kjo enciklopedi që po marrim në duar është në vazhdën e vlerave të rilindasve tanë të mëdhenj kësaj radhe të ditëve tona Në një kohë të caktuar kur ato botohen në kujdesin e shtetit sipas specifikës dhe objektit që ato kanë padyshim që pas asaj kopertine që ne shohim në të, nuk duhet të harrojmë se janë më dhjetra njerëz që rrinë pas saj. Janë stafe të mëdhenj, janë stafe të tëra e qëmtues, me radhitës, me disenjatorë, me sekretarë, arkivistë. Në këto raste që janë pa dyshim të rralla këtë punë të madhe vetëmohuese e ka bërë një njeri i vetëm. Madje nuk kemi një libër në duar po kemi dy. Po, po, janë dy libra të botuar në një periudhë kohe gati një vit nga njëri-tjetri. Edhe pse në kopertinë ka të shkruar “Pjesa e parë” dhe Pjesa e dytë” padyshim ato janë dy libra. Në të vërtetë po të shohim edhe botimin e disa viteve më paëë për Dibrën bindemi për këtë. Edhe pse nuk fliste për emra të veçantë, ai libër i shte pararendësi i kësaj enciklopedie që e kemi në duar. Është e natyrshme që në këtë libër për vendlindjen e tij të ketë vënë si në asnjë libër tjetër të botuar deri tani UNIN e tij. Motivin si do ta quajmë në fushën pedagogjike. E për këtë ai do ta thotë në mënyrë metaforike në titullin e parathënies që e ka shkruar vetë: “Thëngjij nga prushi i Dibrës”

Simbolika e Thëngjillit të një vatre të dalë nga një zjarr i fortë, i shndritshëm është më i spikaturi për Dibrën, që ka edhe simbolikën e Odës po kaq të spikatur në jetën e saj sociale kulturore. Librat enciklopedikë janë sfida më e madhe që kanë bërë letërshkruesit e botës. Në shumë raste ato kanë qenë e mbeten vepra kolektive në hartimin e tyre në gjetjen e materialeve e pastaj të përgatitjes teknike të tyre deri në daljen nga botimi të tyre. Kur këto libra kanë një autor të veçantë si ndodh edhe me autorin Arian Kadiu atëherë edhe sfida është më e madhe. Përballë sekretareve studiuesve, por edhe arkivuesve në këto libra kur këto bëhen vetë nga një autor atëherë edhe vlera e librit rritet shumë më tepër. E më tej ai thotë se secili personalitet që ka vënë në këtë enciklopedi dyvëllimshme janë parë në disa plane për të kaluar sa më mirë e sa më ndershmërisht testin e jetëgjatësisë në kujtesën e një krahine e më tej edhe të kombit, të cilit i përkasin. Ata janë parë në planin psikologjik sociologjik, etnokulturor. i vënë në një garë të heshtur e të dukshme për shumë enciklopedi që janë botuar e do botohen në të ardhmen, autori është munduar dhe i a ka arritur me shumë sukses që të largohet nga një lloj uniformiteti që “grackon” libra të tillë . Risia shumë e dukshme e kësaj enciklopedie është gjetja e figurave jo vetëm për pjesën që administrativisht ndodhet në Kufirin e Republikës së Shqipërisë, por edhe ato të Dibrës së Madhe që ndodhet në shtetin maqedonas. Mesazhi është shumë i qartë. Edhe në kohën më të vështirë të dy pjesët e Dibrës kanë patur jetën e tyre të përbashkët krushqitë, vajet, luftrat, lindjet, profesionet, besimet fetare, këngët, vallet, urtinë e odave, traditën e gurgdhendjes e dashurinë shumë të madhe për ujin e tokën. Duket se ky bashkin shumë i natyrshëm ka “bashkuar“ edhe dy kryetarët e bashkive të dy qyteteve dibrane si ai i Peshkopisë dhe i Dibrës së Madhe respektivisht i lir Krosi dhe Argëtim Fida që kanë kontribuar së bashku për financimin e pjexsës së parë. Këta pushtetarë fisnikë e dinë se të drejtosh qytete të tilla me kulturë, duhet të i nvestosh edhe në këtë fushë. Kjo Enciklopedi na bën që të rizgjiojmë sot një njeri me një botë të madhe shpirtërore, një njeri të ditur si i rfan Findo. E sot për këtë libër të dytë ne kemi një zonjë të deruar shumë të nderuar që rizgjon filizët më të bukur e më fisnikë të traditës dibrane. Është vajza e i rfan Findos zonja Melika Leka (Findo) dhe bashkëshorti i saj z. Luan Leka që kanë bërë të mundur mbështetjen financiare të librit. Nder e mirënjohe për atë që shkruajnë vepra të tilla, po nder dhe respekt edhe për ata që bëjnë këto libra të futen në dyert e lexuesve me bujarinë e tyre

Janë me dhjetra e dhjetra libra të botuara në ditët tona, por jo më pak edhe në vitet e kaluara që ngjajnë si gurët e një kalaje të madhe me shkronja për historinë, luftrat e kulturën e Dibrës duket me plot gojë se libri i Arian Kadiut është një gur i rëndë dhe i ardhur në kohën e duhur. Na mbetet vetëm ta prekim të lumturohemi me të.

Botime të reja



HAKI PËRNEZHA
KRAHINA E ÇIDHNËS

Botimet “M&B”
ISBN 978-9928-172-13-6
Çmimi: 800 lekë

Në faqet e librit koha vjen e fiksuar si shenjë konkrete, me të gjithë treguesit e nevojshëm: E dikurshmja, e largët, por e pashqitshme në mbamendje, që realisht përfaqëson pjesën më të madhe të shqiptarëve, ku shpërfaqen tiparet e zanafillës së genit shqiptar: liria, mençuria e trimëria, por jo vetëm.

Haki Përnezha vjen te lexuesi me një vlerë të shtuar për Çidhnën. Aty është historia, aty është tradita, aty është toka me gjithë pasuritë e saj, aty është mosnënshtrimi e lufta për liri. Aty është Kanuni, vetëqeverisja e organizimi shoqëror me rregulla të prera... Te këta njerëz frika duket se ishte zhdukur e guximi jetonte në çdo zemër.

Çidhna ka kodin e vet të fjalës, të zakonit e qëndresës. Aty është ‘gatuar’ shëmbëlltyra, manaja, alegoria dhe fjala e mençur! Shumë nga veprimet dhe cilësitë e njerëzve të këtij trualli i gjejmë në këtë libër.

Dr. Fejzulla Gjabri

Qeveria provizore **e Dibrës** dhe kryengritja e shtatorit 1913

Nga **GAFUR ZOTA**

Fitorja e kryengritjes së Dibrës, e shtatorit 1913, solli një situatë të re politike në viset e çliruara. Patriotët dibranë e shfrytëzuan atë duke formuar administratën e tyre, që njihet me emrin "Qeverina Provizore e Dibrës". Ismail Strazimiri atë e quante "Komision".1) Kristo Frashëri e njeh si një "Këshill Administrativ".2) Gafur Zota, më 1993, me rastin e 80-vjetorit të kryengritjes së Dibrës, për herë të parë Qeverinë Provizore të Dibrës të dalë nga kryengritja e Shtatorit 1913, e trajtoj si çështje më vehte.3) Pra për administratën e re që u formua në Dibër ka patur emërtime të ndryshme. Ne, do i referohemi në çdo rast vetëm burimit dokumentar, ku e ndeshim me emërtimin "Qevera Provizore e Dibrës".

Qeveria provizore e Dibrës kishte kryesinë e saj dhe kryetarin Sefedin Pustina. Disi e çuditshme mungesa e tij në punimin më të plotë "Historia e Dibrës", Tiranë 2012. Çudija është akoma më e madhe, kur në vend të Tij Prof. dr. Kristo Frashëri njeh si të tillë Hafiz Sherif Langun.4) Në gjykimin tim mendoj se profesori i nderuar jo se nuk e njeh ngjarjen, aq më pak të mos ketë konsultuar lidhjen me dokumente: "Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj", Tiranë 1963, ku në të gjitha rastet si kryetar i qeverisë Provizore të Dibrës përmendet Sefedin Pustina. Menjanimi me pa të drejtë nga kjo ngjarje madhore ndoshta është bërë nga lidhjet e tij të mëvonshme me Esat Pashë Toptanin. Veç kësaj përgatitja e këtij volume shumë vite të shkuara, kur figura të tilla shiheshin bardhë e zi, por edhe mosha në të cilën e solli te lexuesi, ndoshta nuk ia mundësuan të njihej me këndvështrime të reja për ngjarjen në fjalë.

Përkundrej kësaj korespondenca me prefekturën e Elbasanit, prefektin, Aqif pashë Elbasani, qeveritë Provizore simotra në Strugë e Ohër, me Vehbi Dibrën, Ahmet Irfan beun (Ohri) etj. në të gjitha rastet ka patur vulën e qeverisë dhe firmimin e kryetarit të saj, Sefedin Pustina.

Në ndonjë rast është theksuar për lidhje të qeverisë Provizore të Dibrës me Qeverinë e Përkohëshme të Vlorës. Madje, theksohet se ajo i nënshtrohej asaj. Në të vërtetë qeveria Provizore e Dibrës dhe ato simotra në Strugë e Ohër nuk vepronin parale me të, por si pushtet lokal që ishin, e njihnin atë. Për kushtet e vështira, lidhje direkte nuk u vendosën. Ato më së shumti ruheshin përmes prefektures së Elbasanit, prefektit të saj Aqif Pashë Elbasani (Biçaku), haxhi Vehbi Agollit (Dibra) etje. Lidhjet mes tyre fillimisht bëheshin me postë e cila siç shkruajnë burimet e kohës dërgohej me kalorës. Më pas, me vendosjen e linjës telegrafike, ajo kryhej përmes saj.

Veprimtaria e qeverisë Provizore të Dibrës duhet parë në disa plane. Natyrisht hapi i parë i saj ishte përcjellja e lajmit të fitores së kryengritjes dhe e gëzimit që kishte përfshirë dibranët. Duke bërë fjalë për heroizmin e kryengritësve, enthuziazmin deri në lot gëzimi të popullsisë që kish rifituar lirinë, qeveria Provizore e Dibrës, që të nesermen e formimit të saj, me lutjen që sihariqin tia përcillnin edhe Vlorës, i shkruante Aqif Pashë Elbasanit "…Në luftimin që zhvilluan heronjtë e Dibrës së Poshtme, me ndihmën e Perëndisë dhe me frymëzimin e të shenjtit Profit, me plot gëzim, u dukën shenjat e suksesit dhe mbrëmë, natën, armiku u përzu deri në fshatin Obok. Me luftën që vazhdoi dje, aty nga ora tetë, armiku u dëbua edhe nga qyteti, deri përmbrënda Zhupës dhe Rekës. U zunë topat dhe mitraloza dhe armiku u tërhoq në formë të çrregullt. Kështu, shyqir Zotit, u dërmua pothuajse krejt…".5) Këtë sihariq të gëzueshëm Aqif Pasha ia përcillte edhe Qeverisë së Përkohshme të Vlorës së cilës i shkruante: "… Në një letër që erdhi me nënshkrimin e kryetarit të qeverisë së Përkohshme (Provizore shën. im)të Dibrës, Sejfudin Pustinës, thuhet se ushtrija e sërbëve është dëbuar; pothuajse ka dalë krejtë jashtë luftimit".6)

Në radhën e detyrave që shtroheshin para qeverisë Provizore të Dibrës, parësore ishin sigurimi i rendit publik dhe organizimi i administrates së përgjithshme. Dibranët nuk e kishin njohur kurrë administratën serbe. Vetëm dhuna e egër i kishte mbajtur nën të. Te qeveria Provizore e Dibrës tash duhej të shikonin pushtetin e tyre. Pikërisht këtë shqetësim e merak, por dhe përpjekje plot përkushtrim, Sefedin Pustina ia përcillte prefektit të Elbasanit të cilit i shkruante: "…tani po përpiqemi që të sigurojmë rendin publik dhe administratën".7)

Paralel me sigurimin e rendit publik dhe organizimin e administratës rëndësi mernin: kujdesi për të sëmurët e të plagosurit, regullimi i rjetit të ndërlidhjes aq i domosdoshëm për lidhjen me Elbasanin, Strugën, por edhe me Dibrën e Poshtme, vazhdimi i kryengritjes deri në kurorzimin e saj me sukses të plotë, sigurimi i armëve dhe municioneve, por dhe i njerëzve që dijnë t'i përdorin ato. Duheshin bërë përpjekje për të kërkuar nga faktori ndërkombëtarë njohjen e realitetit të ri politik, bashkimin e Dibrës me Shqipërinë. Sigurisht realizimi i tyre kërkohte sakrifica, përkushtim, por edhe njerëz të aftë. Pikërisht për këto në një letër që kryetari i qeverisë Provizore të Dibrës, Sefedin Pustina i drejtonte prefektit të Elbasanit shkruante: "… po punët më me rëndësi dhe reziqe paraqiten për tani e tutje…, ndaj kemi nevojë për njerëz të zotët që dinë të punojnë"8).

Pas masave të para për sigurimin e rendit publik dhe organizimin e administratës, rëndësi merrte organizimi i shërbimit shëndetsorë. Duheshin siguruar ilaçe, por edhe mjek. Kërkesat e para u nisën në drejtim të prefektures së Elbasanit me lutjen që nevojat t'i bëheshin të njohura edhe qeverisë së Vlorës. Nga korespondenca me prefekturën e Elbasanit mirret vesh se kërkesa për ilaçe kishte gjetur mbështetje. Në një letër që qeveria Provizore e Dibrës i dërgonte Aqif Pashës theksohej:"… Dibra nuk ka doktor. Pa doktor ilaçet që njoftuat se do t'i dërgoni, s'ka kush t'i përdorë. Prandaj, ju lutem nisni nja dy a tre doktorë". 9)

Natyrisht drejtimi kryesore i veprimtarisë së qeverisë provizore të Dibrës ishte kurorëzimi me sukses i kryengritjes. Në këtë aspekt përkushtrimi i saj, i kryesisë dhe kryetarit Sefedin Pustina, kanë qënë në shkallën më të lartë. Ajo është gjithmonë afër frontit të luftës, ndjek dinamikën e zhvillimeve, jep udhëzime, përpilon plane veprimi, kujdeset duke dërguar luftëtarë në frontin më të vështirë. Ismail Strazimiri shkruan:"…komisioni i formuem për administrimin e vendit me një anë çonte ndër ballina ushqim e forca ndihmëse dhe mbanën tjetër hynte në korespondencë me Qeverinë



e Përkohshme të Shqipërisë, në Vlorë, prej së cilës kërkonte ndihmë". 10)

Shqetësimi i qeverisë Provizore të Dibrës për kurorzimin me sukse të kryengritjes ishte permanent. Kryefjalë e tërë përpjekjeve të saj ishte sigurimi i armëve. Që të nesermen e rënjes së qytetit të Dibrës në duart e kryengritësve, Sefedin Pustina do i drejtohej Aqif pashë Elbasanit: "…Po, në situatën e sotme, jemi të shqetësuar me që nuk kemi armë e municione për të qëndruar e për t'i bërë ballë një fuqie të rregullt (ushtria e regullt serbe shën. im) që mund të vijë (të na sulmonë përsëri shën. im). Zoti mos e dhëntë, por në rast se qyteti ynë kalon përsëri në dorë të armikut, kjo do të vijë vetëm nga mungesa e armëve dhe municioneve". 11) Suksesin, por dhe shqetësimin e Sefedin Pustinës, prefekti i Elbasanit Aqif pashë Elbasani ia përcillte edhe kryesisë së qeverisë së Vlorës të cilit i shkruante:"…Për të mos dështuar ky marshim burrëror i këtyre heronjëve dhe që të mos t'a humbasim këtë pjesë të çmuar të atdheut tonë, vallë a është e mundur që të pergatiten (sigurohen shën.im) armë nga ndonjë anë dhe të sillen? Si urdhëroni Zotërija Juaj"?12)

Si rezultat i kryngritjes armikut serb iu kapën shumë armë e municion.13) Qeveria provizore e Dibrës shprehte shqetsimin se nuk kishte specialist për t'i përdorur. Është kjo arsyeja që në kërkesën e paraqitur për Aqif Pashën shkruan: "…Prandaj bashkë me armët e municionet që na premtuat, nëse keni na dërgoni edhe një oficer artilerie, që të mund të marr vesh nëse topat dhe mitralozat e zaptuara (kapur armikut shën. im) janë në gjëndje të përdoren… Në rast se këta janë në gjendje të mirë, në Dibër s'ka njeri që të dijë t'i përdorë, prandaj një oficer i tillë është tepër i nevojshëm".14) Nevoja për armë ishte e madhe. Është kjo arsyeja që në drejtim të prefekturës së Elbasanit kërkesat për armë vijonin njëra pas tjetrës. Më 25 vjeshtë e parë 1913, një tjetër kërkesë niset në drejtim të prefektures së Elbasanit. "Siç ju është parashtruar edhe më parë, kemi nevojë të madhe për municione dhe për pushkë. Armiku po zë vend në Mavrovë. Ju lutemi një orë e më parë të na dërgoni armë e municione. Ju lutemi edhe që t'ju jepni rëndësi të jashtzakonshme tërë sa ju kam paraqitun, Zotëria Juaj".15)

Situata e vështirë në Mavrovë e shtyn qeverinë Provizore të Dibrës të vihet në lidhje me ato simotra në Strugë e Ohër, por edhe me Selim Demën. Korespondenca e zhvilluar mes tyre dhe Sefedin Pustinës dëshmon për zhvillimet luftarake në Ohër, por dhe situatën në Mavrovë. Lidhur me gjëndjen këtu, Sefedin Pustina i kërkon qeveris së Strugës dhe posaçërisht Selim Demës që me 200 dibranë të niset nga Ohri dhe arrij në Mavrovë. Në një letrër dërguar nga Sefedin Pustina shkruhet: "… Pasi u informuam që ushtria jonë në Mavrovë është e pakët dhe pasi armiku po forcohet, me të arritur kjo letër, merrni nja 200 vetë nga shokët që keni aty dhe vraponi, duke ecur natë e ditë, që të arrini në Mavrovë…Duhet të veproni në këtë mënyrë dhe të mos jetë nevoja t'ju shkruhet përsëri…".16) Dokumenti ndoshta nuk është përkthyer mirë, ndaj dhe pak kontraditorë. Se sa i rëndësishëm ishte fronti i Mavrovës, dëshmon edhe nxitimi i Elez Isufit dhe Ahmet Zogut për aty. Kjo miret vesh nga korrespondenca e zhvilluar mes tyre dhe Sefedin Pustinës dhe e këtij të fundit me Aqif Pash Elbasanin të cilit i shkruan: "…Nga letra që u muar prej Elez Isufit, kuptohet se Elezi asht duke u nisur për Gostivar me një fuqi të madhe, bile prej telegramit që u muar prej Komisionit të Dibrës së Poshtme merret vesh se u nis. Edhe Ahmet beu erdhi tani".17) Dhe përsëri i njëjti shqetësim i kahershëm: "…Pa dyshim municione posa t'ju arrijnë do t'i nisni menjëherë. Është nevojë e domosdoshme të luftohet vazhdimisht. Prandaj ndërmjetsoni përsëri për dërgimin e municioneve".18)

Kurorë lavdie në vepromtarinë e qeverisë Provizore të Dibrës dhe kryetarin e saj Sefedin Pustina shënojnë përpjekjet për bashkimin e Dibrës dhe trevave për rreth, me shtetin amë, Shqipërinë. Përpjekjet e bëra në këtë drejtim, aq më tepër në situate lufte, meritojnë vlersim me nota të larta atdhetarie. Që gjatë kryengrtjes, madje fill pas çlirimit të Dibrës, drejtues të kryesisë së qeverisë Provizore të Dibrë, figura të shquara në vite, ngrinin zërin për sensibilizimin e Fuqive të Mëdha me situatën e re politike të krijuar në Dibër dhe viset tjera të çliruara nga kryengritësit. Të vetëdijshëm se lufta nuk mund të vazhdonte gjatë, ngrejnë zërin që të ndërhyhej pranë Fuqive të Mëdha për gjetjen e një zgjidhje diplomatike. Lidhur me këtë Sefedin Pustinës, kryetar i qeveris Provizore të Dibrës, ka patur korespondencë në vazhdimsi me Aqif Pash Elbasani dhe Vehbi Agollin. Në një letër për ta shkruhej: "Patëm nderin të marrim letrën e përbashkët Tuajën (Letër e Aqif Pashës dhe Vehbi Agollit shën. im.) me plot lajme gazmore. Ju falëm mirësisë hyjnore përsëri, dhe i bëmë lutje për vazhdimin e sukseseve. Derdhëm lot nga gëzimi. Natyrisht, një popull nuk mund t'ja dalë dot të vazhdojë luftën shumë kohë me një mbretëri. Të tilla gjëra, bile edhe në mes qeverive të rregullta, zgjidhen në mënyrë diplomatike. Prandaj hyni në korespondencë edhe me Vlorën, merrni sa më shpejtë masat që do t'i shihni të nevojshme dhe kini mirësinë e na njoftoni përfundimin si edhe mendimin e Zotnisë Suaj…"19)

Kërkesat e para shkojnë në adresë të Aqif Pashë Elbasanit dhe haxhi Vehbi Agollit (Dibra). Ky i fundit ishte një figurë e shquar Dibrane. Ishte bashkëluftëtar, por dhe bashkëvuajtës i tyre si rezultat i genocidi serb. Ishte i zgjedhur në forumet e larta të qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Si i till gëzonte gjithë besimin e dibranëve, të qeverisë Provizore të Dibrës. Ai ishte mandatuar nga Dibranët dhe qeveria e tyre provizore të ngrinte zërin, të protestonte dhe nënshkruante në emër të tyre. Në letrën drejtuar Aqif pashës dhe vehbi Agollit Sefedin Pustina shkruan: "… mbetet në dorë të Zotërisë Suaj që të vazhdoni të bëni në emër ton ankime dhe kërkesa meqë është e vështirë të bëhen për ditë letra ankimi(distance, tereni, mungesa e mjeteve të komunikimit dhe mbi të gjitha situate e luftës e vështirësonin komunikimin në mënyrë permanente me Vlorën shën. im). Zotria Juaj aty, padyshim i regulloni çeshtjet, prandaj ju lihet në patriotizmin Tuaj…"20)

Në këto përpjekje qeveria Provizore e Dibrës kishte një bashkrendim të veprimeve edhe me Strugën dhe Ohrin ku zhvillonte veprimtari kombëtare Ahmet Irfani, i biri i Numan Beut . Ndoshta fjala është për Irfan bej Ohri, nip i Iljaz Pashë Qokut, një dibran i shquar në lëmin kombëtar. Ky, i informuar me zhvillimet në Dibër, me mallin për të parë të realizuar ëndrën për bashkimin e saj me shtetin amë, Shqipërinë, më 30 vjeshtë e parë 1913, i shkruan kryesisë së qeverisë Provizore të Dibrës: "…duhet telegrafisht tja njoftoni mbretërive të mëdha se Dibra u aneksua(bashkua shën. im) Shqipërisë.... Me një shpejtësi rrufe mblidhni disa njerëz.... vini nënshkrimet…".21) Siç duket edhe nga letra drejtuar qeverisë Provizore të Dibrës, Ahmet Irfan Beu ishte në lidhje të vazhdueshme edhe me Haxhi Vehbi Dibrën. Në një linjë me qeverinë e Dibrës edhe ai shpreson shumë në angazhimin e Vebi Agollit për këtë çështje. Në letrën për qeverinë e Dibrës shkruan: " Myfti Efendiu (Vehbi Agolli shën.im.) vajti në Vlorë. Vajtja e Myfti efendiut në Vlorë, asht shumë me vend për të sjellë monicion e për të marrë masa diplomatike. Po e përsëris edhe një here, asht shumë e madhe randësija e telegramit që do t'ju jepet Fuqive të Mëdha…lypset ngutësi ".22) Jo vetëm kaq, por Ahmet Irfan, djali i Numan Beut, do të niste për qeverinë Provizore të Dibës edhe tekstin mbi të cilin do të nëshkruhej për bashkimin e Saj me Shqipërinë. Bashkë me teksti e telegramit dhe porosinë që pas firmosjes së tij të kthehej me urgjencë, me shpejtësi si rrufeja, pasi do i përcillej Fuqive të Mëdha.

(Vijon në faqen 22)

Rruga e Arbërit nr. 88

kujtime

Kujtime që m'i trazojnë **Çeliasit**



Nga **VESEL HOXHA***

NË VEND TË HYRJES

Ishte vera e vitit 1976. Po ktheheshim me një makinë 7 vendëshe kineze **BJ -212** nga Malësitë e Korabit dhe të Lumës për në Peshkopi, me disa koleg të punës të Ekspeditës Gjeologjike të Peshkopisë, së bashku me dy profesorë të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave të Tiranës, Andon Grazhdanin dhe Jorgo Kananin. Kishin ardhur nga Tirana e largët për të na ndihmuar. Ishte viti i parë i punës time në Zonën Tektonike të Korabit, pas dy viteve pune në Dhoks dhe Bulqizë. Do të konsultoheshim në terren për disa probleme që kërkonin studime më të thella shkencore, mundësi që ne të bazës në atë kohë nuk i kishim. Edhe pse makina ishte flakë e re, pluhuri futej nga të katër anët, pasi ishte e mbuluar me një lloji mushamaje që e lejonte atë. Ajo thithte shumë edhe rrezet e diellit dhe ne, aty brenda në veturë, kur i thonë, ishim si në furrë. Ktheheshim nga fshati Vasie i Kalasë së Dodës, ose më saktë nga Vorrezat e Matranxhit, fshat kufitar midis Dibrës dhe Kukësit. Në fakt kemi të bëjmë më kufi administrativ pasi të dy "fshatrat kufitare", si Vasiet dhe Matranxhi, janë pjesë e krahinës së Lumës, ku ne kishim takuar për herë të parë në vendin tonë disa mineralizime silikate hekuri. Aso kohe rruga ishte si rrugë traktori dhe, nga Kalaja e Dodës për të vajtur në Peshkopi nëpërmjet Sllovës, duheshin 3-4 orë udhëtim me veturë, ku aventura më e madhe ishte të kaloje Përruan e Veleshicës. Ajo e ndërron shtatin sa herë bie shi. Në popull, jo pa vend përdoret shprehja, mos lëviz si Veleshica. Kaluam me radhë shumë fshatra, kaluam dhe Rrenzin dhe kur po udhëtonim përballë fshatit tim, Blliçes (Komuna Fushë Çidhën –sot), **në vendin e quajtur Çelias**, po ju tregoja mysafirëve me dorë nga makina vendlindjen time, falë dhe faktit se ajo ecte tepër ngadalë për arsye të gropave të mëdha që kishte rruga. Ju tregova po ashtu edhe pllajën e Çeliasit në të dy anët e rrugës duke cilësuar që në këtë vend, që i vogël kam kullotur bagëtinë. Vazhdimisht kam folur me vete duke shtruar pyetjen pse nuk ndërtohej rruga për në Kala të Dodës nëpërmjet Çeliasit e Sllovës, një rrugë e shkurtër dhe e domosdoshme, jo pse mua me lidhte puna me të, por për të gjithë ato banorë të atyre zonave të thella malore ku punohej e jetohej, pa e shkuar as ndërmend asfaltimin, i cili u bë realitet 37 vite më vonë. Realitet u bë dhe asfaltimi i rrugës për në fshatin tim, por pasi erdhi demokracia. Ky është fakti. Kështu ka ndodhur. E meritonte atë rrugë fshati im dhe ndër të parët madje. E në atë kohë duhej të ecnin 110 km rrugë për të vajtur nga Peshkopia në Kala të Dodës, nëpërmjet Skavicës dhe Vilës, kur rruga nga Sllova nuk ishte as 40 km. Habitesha me të gjithë ato kuadro drejtues kryesor (ose e thënë ndryshe, me të gjithë ato kuadro të bindur të pushtetit të asaj kohe, që bënin ligjin kur i thonë), përse nuk këmbëngulnin që të ndërtohej ajo rrugë, jo me asfalt, pasi asfaltin as që e shkonte njeri ndërmend në atë kohë! Asfalti ishte luks e shkuar luksit. Mendoj se është një kërkesë minimale të kërkosh një rrugë pa asfalt!? Ndoshta nga që lëviznin vet me vetura e, nuk kujtoheshin për popullin, nuk merakoseshin shumë për të. Me sa dukej ashtu e donin atë, të varfër dhe të ecte në këmbë, që të qeverisej më lehtë. Ashtu ishte sistemi edhe pse e propagandonte shumë luftën për barazi shoqërore dhe nuk harronte as të kritikonte burokratizmin me lloj-lloj sloganesh. Por, edhe po të fliste e ashtuquajtur "klasa" ndonjëherë nën zë, rruga nuk bëhej pasi partia "maja e mprehtë e shpatës së klasës punëtore", mendonte se nëpërmjet saj do na vinte shumë shpejt armiku nga Mali i Sorokolit në Peshkopi, e do na pushtonte! Çfarë mendësie! Sot shumë gjëra duken të pabesueshme, por kështu ka qenë situata, kështu ka ndodhur vërtet, edhe kur duhej hapur një rrugë që do të zhvillonte zonën e do të hapte perspektivën e gjithanshme, duke vënë në qarkullim ekonomik resurset e tokës. Për resurset minerale për hir të së vërtetës, monizmi nuk i kursente shpenzimet në kërkimzbulimet gjeologjike që realizoheshin në atë kohë, pavarësisht kostos dhe vendit ku do gjendeshin ato. Kjo është një e vërtetë e madhe. Studimet dhe kërkimet gjeologjike vlerësoheshin shumë dhe konsideroheshin me leverdi të madhe dhe jetike për zhvillimin dhe industrializimin e vendit. Dhe, kështu ka ndodhur. Në shumë raste, me rezultatet e gjeologjisë hapeshin edhe kongreset e partisë. Një lumë kuadrosh, më shumë të pa aftë se sa të aftë, me shumë të pa shkolluar se sa të shkolluar, që nga sekretarët e parë, kryetarët e komiteteve e deri tek drejtorët e ndërmarrjeve e kryetarët e kooperativave etj., me rroga të mira, me vetura e me zyra, me telefona e me privilegje drejtonin të ashtuquajturën ekonomi socialiste, drejtonin punëtorët, fshatarët dhe shtresat e tjera të shoqërisë. Vetëm teorikisht drejtonte **Klasa Punëtore** në aleancë me **Fshatarësinë Kooperativiste**. Kjo shumatore kuadrosh qeveriste në emër të të ashtuquajturës, **Diktaturë e Proletariatit**. E keqja është se shumë gjëra jo të mira, në drejtimin e vendit në tërësi, po ndodhin edhe sot në demokraci dhe, në disa sektorë, më keq se në monizëm. Të shpresojmë se do të bëhet më e mira në të ardhmen, të ngushëllohemi me tranzicionin e zgjatur e, le të kthehemi tek rruga, tek udhëtimi ynë, t'ua lemë të tjerëve politikën, këtë marrëdhënie për sundim midis grupimeve njerëzore siç e kanë përkufizuar filozofët. Një vend pa rrugë **është i vdekur**. Kjo thënie **më ka ngelur në mendje**, që kur e dëgjova për herë të parë, në vitet e para të demokracisë në Shqipëri, nga një mik dhe koleg i imi nga Gjermania, nga Munihu i largët, Dr. Martin Holcapfel. Vinte në Shqipëri duke u interesuar për studimin e Gjipseve të Peshkopisë, me synimin e vetëm për të parë mundësitë e shfrytëzimit të tyre nga kompani të fuqishme gjermane. Pra, interesohej për të vënë në qarkullim ekonomik këtë pasuri përrallore. Pa rrugë nuk vijnë investitorët e huaj, sikur të kemi me shumicë në këto male e kodra edhe **rezerva floriri** pasi sot, **kostoja vendos për gjithçka**. Me këto fjalë ma mbylli bisedën rreth kësaj teme miku nga **Gjermania**. M'u kujtua fjala e urtë e popullit tonë: Është lirë kripa në Durrës, por e ha qiraja rrugës". Ku ta dinte miku nga Gjermania se në Shqipëri edhe kur të bëhen rrugët, do të gjendet një burokraci dhe do të hartohen disa ligje që nuk janë dhe aq joshëse për investitorët e huaj.

INTERMEXO LOKALISTE PROFESIONALE

Fshati im i Blliçes ka një pozicion të lakmueshëm dhe strategjik. Ai shtrihet në kurrizoren e kodrës që ndan **Fushën e Kastriotit** (Fushën e Thatë ose Hasin e Thatë, siç e thërrisnin rëndom të vjetrit e krahinës), me atë të fshatrave Laçes dhe Fushë Alie duke u zgjatur e duke lagur këmbët e gjata në Lumin e Drinit të Zi. Shtëpiat janë të vendosura në të dy anët e rrugës që kalon mes për mes kësaj kurrizoreje, duke ruajtur kësisoj tokat e bukës por, edhe duke i dhënë fshatit karakteristikat e një qyteze kodrinore në mes të gjelbërimit, ku asfalti i demokracisë ja ka shtuar edhe më shumë hijeshinë. Nga larg shtëpitë e banimit duken me vështirësi pasi drurët frutore dhe ato pyjorë e vështirësojnë së tepërmi pamjen e tyre. Vetëm minarja e xhamisë së fshatit duket pa pengesa. Për tokën bujqësore bashkëfshatarët kanë treguar vazhdimisht një kujdes të jashtëzakonshëm. Janë shumë të pakta rastet kur në to janë bërë ndërtime dhe ky fakt më gëzon shumë. Pse jo, mund të them se ndihem edhe krenar për këtë traditë të mirë të trashëguar ndër breza për të mos ndërtuar shtëpi banimi apo objekte të tjera ndihmëse në tokat bujqësore, në tokat prodhuese, duke i parë ato si burim kryesor jetese. Jo vetëm kaq por, fshati im i lindjes, Blliçja, edhe nga ana gjeologjike (kësaj shkence që i kushtova jetën dhe me të cilën rrita fëmijët e mi të dashur), është i vendosur mbi formacione gjeologjike të sigurta, ku, e thënë në gjuhën popullore mbi themele të forta (shtresat e tokës ku vendosen shtëpitë e banimit janë të ngjeshura, edhe në gjendjen e tyre natyrale) dhe shtresat e ngjeshura nuk janë shumë thellë sipërfaqes së tokës. Kjo do te thotë që pasi të gërmohet ose të hiqet një mbulesë toke përgjithësisht e butë me trashësi dheu nga 0.5 m deri 1 m, në të shumtën e rasteve mund të takojmë në shtresat e ngjeshura, që nga fshatarët thirret me emrin **celinë dhe ku ato, pas takimit në të, ndërpresin thellimin e themeleve**. Unë e mbaj mend këtë emër që kur isha i vogël (kohe në të cilën as që më shkonte ndërmend se do bëhesha gjeolog dhe do kisha sadopak haber, njohuri, për themelet e shtëpiave). Në gjuhën e profesionit **Celina populore,** emërtohet si formacion i përbërë kryesisht nga argjila me ngjyrë të kuqe, kafe deri portokalli, nga ranorë dhe më rrallë edhe nga konglomerate e mikrokonglomerate (copëra shkëmbinjsh të ndryshëm të rrumbullakosura dhe të çimentuar, por nuk përjashtohet dhe prania e coprave të pa rrumbullakosura) të moshës gjeologjike të Pliocen-Pleistocenit të Poshtëm (N_2-Q_p). Këto emërtime moshore gjeologjike flasin se ato janë formuar në kushte kryesisht liqenore, duke filluar të depozitohen në të, që para **5-6 milion vitesh** dhe mendohet se kanë dalë mbi ujë para **1-2** milion vjetësh. Sapo kalon lagjen Mazhe të fshatit Rrenz, kur udhëton për në Peshkopi, të shpalosen para syve **Çeliasit**. Një pllajë e pjerrët midis fshatrave Blliçe e Kastriot, e përshkuar nga përrenj dhe përroska të shumta por me ujë sezonal. Perroi i Lushit dhe ai i Shllinës janë dy nga më kryesorët. Pllaja në fjalë ndërtohet nga formacione gjeologjike jo shumë të forta, të karakterit rreshporë të moshës së Silurian–Devonianit (S-D) mbi të cilat në shumicën e rasteve mbulohen nga depozitime të reja (kuaternare). Mbi këto depozitime të reja kuaternare është zhvilluar ajo bimësi e butë dhe e shumëllojshme, ajo lloi kullose me shumë vlera të larta ushqimore për blegtorinë. Në përgjithësi depozitimet rreshpore argjiloro-ranorike etj. të ngjashme me këto që ndërtojnë pllajën në fjalë (pllajën e fshatit të Blliçes, fshatit tim të lindjes), pavarësisht nga mosha që kanë, krijojnë reliev të butë me kodra të rrumbullakosura dhe më lëndina të bukura të cilat në thellësi përmbajnë lëndë minerale të përshtatshme për bimësinë. Përbërja mineralogjike e tyre favorizon rritjen e një bimësie të butë dhe mjaftë produktive për blegtorinë. Jo më kot fshatarët e mi ndër shekuj kanë konstatuar se qumështi i kësaj pllaje kullosore, i Çeliasit, është si mjalti. Ato gurë të mëdhenj të shpërndarë në të, sot nga lartësitë e viteve të punës, janë për **mua jo vetëm një kujtim i çmuar** i fëmijërisë për lojërat e pafundme që më lidhin me to, por edhe një dëshmi e proceseve gjeologjike mjaftë të ndërlikuara që ka kaluar kjo zonë në milionat e viteve të shkuara. Guri i **Dali Pekut,** Guri **i Hajatit**, Guri i **Rrafshes** etj. përfaqësojnë blloqe të shkëputura të **kuarciteve** të moshës së Ordovikianit. Edhe sot e kësaj dite nuk jam në gjendje të shpjegoj me siguri nga kanë ardhur ato blloqe shumë të vjetër, të formuara në detin e Ordovik-Silurianit këtu e **488 milion vjetë më parë**, ku është vendi i formimit, kur dolën mbi ujë, si u transformuan në shkëmb dhe më vonë në kuarcite, ku, kur dhe si janë shkëputur? Kështu mund të vazhdoj gjatë me pyetje nga më të ndryshmet dhe përgjigjet do jenë shumë të vështira. Unë mund të "krenohem" se në këtë zonë gjenden shkëmbinjtë më të vjetër **të Shqipërisë Etnike ose, të Shqipërisë Natyrale**.

Kështu ka ndodhur dhe me peizazhin e kësaj pllaje të vogël por të madhe për mua, më të cilën, siç theksova më sipër, më lidhin shumë e shumë kujtime të paharruara të vegjëlisë.

Midis kujtimeve me bashkëfshatarët e mi do të veçoja ato me Sakip Dautin, Gani Bitrin e vëllain e tij, Lazamin, të ndjerin Nuri Noka dhe shokun e klasës Ilir Spatën etj.. Jam i lumtur se me të gjallët nga këto "miq të paleozoit" (në kuptimin alegorik, miq të kohës së hershme të fëmijërisë) edhe sot e kësaj dite i kam ruajtur sadopak ato marrëdhënie të dashurisë, respektit, vlerësimit e mirëkuptimit reciprok. Sa herë që vete në fshat, për punë, për sebepe apo për të shuar mallin, nuk mund të rri pa i takuar, qoftë dhe për disa minuta ata. Vetëm me Ilirin jo, takohem shumë rrallë pasi ai prej vitesh banon në kryeqytetin e botës, përtej Atlantikut. Kështu më erdhi jeta mua, **njerëzit dhe mineralet** të jenë në qendër të dashurisë e vëmendjes time të përditshme.

***

SAKIPI

Bashkëfshatari im **Sakip Daut Dauti** është dy vite në moshë para meje. Vjenë me një trup mesatar, i imët në fytyrë dhe me pak rrudha. Thinja ka, por flokët ende nuk i kanë rënë. Është energjik për nga natyra, revoltohet shpejt për padrejtësitë por, asnjëherë nuk e humb logjikën. Kurrë nuk bëhet me më të fortin por, me më të drejtin. Dhe kjo jo pak i ka kushtuar në jetë. Shpesh herë si me të qeshur i them se, më vjen pak inat, pse dukeni më i ri se unë në moshë. Ai nuk më përgjigjet me fjalë por, nëpërmjet mimikës së fytyrës me një nënqeshje të lehtë ne buzë, të lë të kuptosh shumë gjëra. Në vitet e para të vegjëlisë, më lidhi me të shkolla fillore dhe 7-vjeçare, dhe më vonë edhe shkolla e lartë. Afërsia e shtëpive tona në fshat dhe, mbi të gjitha, pllaja e vogël dhe e madhe e **Çeliasit** ku së bashku kullotnim bagëtinë, ishin ato që përcaktuan miqësinë midis nesh. Në fakultet për një periudhë gati tre vjeçare do të studionin bashkë, unë për gjeologji, ai për ekonomi. Edhe pse pati një shkëputje pas mbarimit të shkollës së mesme, Sakipi arriti ti kap shumë shpejt mësimet, sidomos ato të lëndëve të përgjithshme si matematika, fizika dhe kimia duke u bërë një student ndër më të dalluarit në fakultetin ekonomik. Edhe sot e kësaj dite ai është i freskët dhe ka njohuri të thella në fushën e ekonomisë, kjo falë leximeve të vazhdueshme të Tij, me një bibliotekë për t'ia patur zili. Sa herë që hapim biseda me të të lidhura me ekonominë, ajo që më ka mbetur në mendje është thënia e Tij: **Vetëm investimet prodhuese do na shpëtojnë nga papunësia dhe do na çelin perspektiva të sigurta zhvillimi.** Vite e vite më vonë, kur kisha mbaruar studimet dhe kisha filluar punë në Ekspeditën Gjeologjike të Peshkopisë, puna në kërkim-zbulimin e vlerësimin e mineraleve më lidhi më shumë me të. Një takim i rastin në vitet e monizmit u bë shkas që ai të fillonte punë në gjeologji. Sakipi ishte i vëmendshëm dhe i pjekur në shumë drejtime të jetës, ndaj në atë takim historik, që do ta ndryshonte rrjedhjen e marrëdhënieve tona, ai, nuk do të harronte të më kujtonte përpara se të ndaheshim se: **"mos ju thonë ndonjë gjë njerëzit e partisë, po më caktuat mua në punë"?** Që të mos zgjatëm në këtë histori, Sakipi pas atij takimi filloj punë shpejt, me zell e me përkushtim, edhe pse fillimisht si punëtor, edhe pse ishte me arsim të lartë. **Ashtu ishte koha e monizmit. Të gjeje punë në shtet edhe punëtor ishte privilegj.** Pas disa vitesh ai do të bëhej brigadier dhe zjarrmëtar i Ekspeditës Gjeologjike të Peshkopisë dhe këtë detyrë do ta mbante deri sa doli në pension, në një moshë relativisht të re, pasi punonjësit e nëntokës e kishin "privilegjin" e pensionimin në moshë, në raport me profesionet e tjera. Gjithçka e arriti me punë, duke frekuentuar të gjitha kurset e kualifikimit e, duke fituar hap pas hapi kategoritë e punëve të specializuara që kërkoheshin gjatë hapjes së punimeve minerare gjeologo-kërkuese. Kur do të punonim në përruan në jug të fshatit, **në Përruan e Vneshtëve**, për disa lloje **Bojrash Dheu** (Pikmente natyrore), ai do më thoshte si me të qeshur: "Ma lerë mua përgjegjësinë. Ti marrë unë të gjithë punëtorët nëpërmjet Këshillit të Bashkuar që të mos keni probleme, për disa gjëra që **Ju as nuk i mendoni dhe as nuk i duroni**". E kishte fjalën për pengesat që mund të na sillnin problemet e luftës së klasave që shtriheshin deri në nivele të tilla, për marrjen në punë të punëtorëve.

portrete

Edhe pse në krye të Partisë pas vitit 1985 ishte **Ramiz Alia**, përsëri dhe për inerci disa gjëra të tilla vazhdonin... por, jo më me atë intensitetin e më-parshëm. Kur i mendoj këto gjëra sot më vjen si gjë e pabesueshme, **por kështu ka ndodhur**. Ndoshta ishin edhe teprime e zmadhime të bazës. Midis punëtorëve që do fillonin punë atë verë, ku mund të përmend Xhetan Dautin, Halim Dautin, Fadil Nokën etj., Sakipi kishte vendos në krye të listës emrin e **Ilir Spatës**, shokut tim të klasës në shkollën fillore dhe 7-vjeçare. Mua më vjen zor ta shikoj Ilirin duke punuar si punëtor krahu në kanale dhe puse dhe, aq më tepër në fshatin e lindjes–i drejtohem me ndrojtje, dhimbje e me një ndjejnë përgjegjësie Sakipit. Unë isha para faktit se do të kisha punëtor (në një nga ekipet gjeologjike të Ekspeditës së Peshkopisë që drejtoja në atë kohë), shokun e klasës, nxënësin më të mirë të saj në mësime e kudo, që nga klasa e parë e deri në klasën e shtatë**! Por kjo është e vërteta dhe kështu ka ndodhur.**

***

ILIRI

Bashkëfshatari im, **Ilir Lazim Spata**, siç theksova dhe më sipër, është njeri ndër shokët e mi të fëmijërisë që shkëlqeu që në bangot e shkollës dhe u dallua nga të tjerët jo vetëm në mësime por dhe në fusha të tjera të jetës. Mund të shprehem pa frikë se që në atë kohe ai lexonte shumë e me pasion të madh libra jashtëshkollorë, sa që, edhe mësuesit gjendeshin shpesh në vështirësi në debate me të. Por, si shumë e shumë të tjerëve "Diktatura e Proletariatit" ja ndërpreu rrugët e shkollimit dhe të konkurrimit me librin e hapur të jetës. Unë nuk do të ndalem këtu në historitë e pafund që ndajë me të në kohën e vegjëlisë, veçanërisht në Çelias, as për historinë e gjatë e të dhimbshme të kalvarëve politike në jetën e Tij, gjerë në ditën kur në Shqipëri fitoj demokracia, kur ai u bë Kryetar i PD në degën e Dibrës apo deri dhe kandidat për deputet në ditët më të vështira të PD, në vitin 1997 etj.. Do përpiqem të risjellë në kujtesë vetëm dy nga ato mbresa që kanë gërvishtur memorien time. Nuk e mbaj mend mirë vitin por, mbaj mend se po kthehesha në këmbë nga vendi i quajtur **"Varri i Sejmenit"** në drejtim të fshatit Sllatinë, mespërmes Livadhit të Gjatë. Tek "Varri i Sejmenit", kolegët para meje, vite më parë kishin kryer disa kanale kërkimi për të kontrolluar disa dalje sipërfaqësore të mineralizimeve sulfurore të Arsenikut të cilat nga disa analiza më të detajuara rezultonin dhe me përmbajtje të Arit. Ndaj, sa herë që kthehesha për në shtëpi, e lakoja rrugën për ta vrojtuar mirë e mirë atë vend, për të goditur diçka dyshuese me çekiç, diçka që kisha në mendje, që më gërvishte (gërvishtje që vazhdon dhe sot) edhe pse detyrat në atë kohë i kishim për të tjera minerale dhe përqendrimi i punimeve ishte tek Gurët e Pëllumbave, në Bjeshkën e Shehut, në Avdanicë të Bjeshkës së Preshit dhe shumë vende të tjera. Vazhdonte në atë periudhë të hapej Kanali Vaditës i Sllatinës, që do të merrte ujë nga Përroi i Bjeshkës se Shehut (në se nuk gaboj), për ta sjellë atë në zonën e Sllovës për vaditje. Kanali vazhdonte të hapej në formacione gjipsore të forta (sulfate të kalciumit me ujë **-$CaSO_4$ 2H_20)** dhe vende vende në formacione shumë të forta Gjipsi që në gjuhën e gjeologjisë thirren Anhidrite (ose gjipse pa ujë **-$CaSO_4$**). Në formacione të tilla lëndët plasëse nuk kanë shumë efektivitet. Pikërisht në atë pjesë të kanalit ishte duke punuar Iliri. Po hapnin brimat me ca baromina dore siç thirrën rëndom në minierë. Ai mua nuk më shikonte.



Pamje e përgjithshme nga Google e zonës ku ndodhen Çeliasit

Ju afrova dhe pasi u sigurova mirë e mirë që ishte Iliri, pasi nuk doja tu zija besë syve, i përshëndeta dhe i urova me fjalën e thjeshtë por kuptimplote, punë të mbarë. Iliri, sapo dëgjoi zërin tim, ndali hovin e varresë që godiste barominat për të bërë brimat e minave, dhe, duke ulur varrenë në tokë pranë këmbëve, mu drejtua me fjalet: Ore, a me duket mua apo na paska ardh **Molla Veseli** (Gjyshi im e ka patur emrin Vesel dhe ka patur gradën fetare Mulla, kurse në popull thirrej Molla), pasi kështu e thirrnim njeri tjetrin në vegjëli me përkëdheli dhe humor, duke ja ngjitur ndonje nofkë, por jo pa ndonjë lidhje. Pasi u përqafuam me dashuri e u pyetëm, ku për hir të së vërtetës kishim shumë kohë pa u takuar, mu drejtua me fjalët që nuk do ti harroj kurrë: **Hoxha** (kështu ma thërrisnin në fshatin tim babain) bëri si bëri ju dërgoj në shkollë të lartë dhe këtë mos ta harroni asnjëherë, as ti, as Muniri, përndryshe dhe Ju do kishit patur fatin tim dhe fatin e shumë e shumë të tjerëve si unë.... Mbeta pa fjalë! Nuk kisha çfarë ti shtoja as ti hiqja asaj shprehje që i buroi nga thellësia e shpirtit të Tij dhe i doli aq natyrshëm nga goja, edhe pse djersët vazhdonin ti rrëshqisnin faqeve, nën rrezet përvëluese të diellit të Korrikut në Livadhin e Gjatë.....!

Kishte fituar demokracia në Shqipëri dhe Iliri në fillimet e para të saj ishte zgjedhur Kryetar i Komunës së Fushë-Çidhnës. Më e vogla detyrë që mund të meritonte ky njeri, e cili nuk e ndali studimin, me gjithë vështirësitë që pati, duke arritur të jap provim të gjitha lëndët mësimore sipas programeve në dy fakultete si dhe, të flas rrjedhshëm, veçanërisht gjuhën angleze. Vajta posaçërisht për ta takuar dhe për ta uruar së bashku me disa bashkëfshatarë e miq të mi. Na priti siç i ka hije Ilirit dhe fisit të tij. Mirëseerdhe Molla Veseli -mu drejtua mua me të njëjtat fjalë që mu drejtua kur u takuam tek kanali i Sllatinës -me buzën në gaz që instinktivisht **ja diktonte shqiptimi i nofkës** që më vinte para emrit, pa harruar për tu përshëndetur edhe me gjithë të tjerët.

Fillimisht **bëri "një shëtitje të vogël në kohën tonë të fëmijërisë",** duke risjellë në kujtesë disa ngjarje nga ajo kohë, ku për hir të së vërtetës njëra më ngacmonte mua dhe lidhet me "Mishin e Groshës", me mishin e pastërmasë aq të praktikuar në atë kohë për fasulet, për atë ushqim bazë, për mishin e fshatarëve siç thuhet rëndom.

Më pas biseda u fut shpejt në një temë interesante rreth Lumit të Drinit të Zi, jo pse i ka ngel ky emër, jo kush e ndërtoi dhe financoi Urën e Lushës, pse kjo urë ka këtë emër etj. etj..

Të jem i sinqertë me lexuesin unë nuk u përfshiva në bisedë, falë dhe njohurive të pakta e jo të plota të legjendave që qarkullonin në popull rreth saj, por më bëri shumë përshtypje diskutimi dhe pasioni i Ilirit rreth tyre dhe në veçanti rreth fisit Lusha, a thua se ky ishte fisi Spata.

Tani, që ka kaluar shumë kohë nga ajo bisedë dashamirëse, konstatoj se pasioni i Tij kishte patur rrënjë të thella. Jo vetëm që në periudhën e qënies si Kryetar Komune në Fushë Çidhën, bëri realitet rindërtimin e Urës që lidh dy brigjet e Lumit të Gjatë apo Lumit të Zi, siç parapëlqen shpesh ai ta emërtoj ndryshe Lumin e Drinit të Zi, por botoi dhe librin **"LEGJENDA E NJE FISI,** një **Rrëfenjë në vargje**, e shkruar me shumë pasion e nivel të lartë artistik për tu pasur zili, pse jo edhe nga shumë "kolosë" të letërsisë shqipe të këtij zhanri.

Më lejoni ta hijeshoj shkrimin tim me disa vargëzime brilante të shkëputura nga ky libër:

Në vendin tim
Mos luaj me fjalën!
Nuk është shaka
Me ba mahi.

Sa mijëvjeçarë
I trazon plagët;
Sa thellë në asht
Ti prek, s'e din?

Në vendin tim
Sa peshon fjala
Nuk peshon guri;
Mali s'peshon.

Mos gërric plagë
Se zgjon legjenda!
Mos trazo gurë!
Eposin zgjon!

***

MËSUESI I KLASËS SË PARË, AQIF SHERIF SPATA

Ëmbëlsira lihet për në fund thuhet shpesh në biseda të ndryshme. Dhe kjo mua më pëlqen ta citoj e ta theksoj, në të gjithë ato raste kur dua të shpreh disa fjalë të vërteta, disa fjalë zemre, disa kujtime përmalluese e merituese që, për një kohë të gjatë kanë fjetur në zemrën time, për mësuesin e parë të shkollës fillore, për mësuesin pasionant e të palodhur, për të respektuarin **Aqif Sherif Spatën**. Fati e solli që në këtë pranverë të jem në fshat për disa angazhime personale.



Dalë në fshatin Blliçe, me mësuesin e Klasës së Parë, Aqif Sherif Spatën (Prill, 2013).

I kisha vënë detyrë vetes kësaj radhe që të mos largohesha nga fshati pa e takuar profesorin e parë të udhës së dijes, atë që më mësoj me urtësi e durim si ta mbaja penën, si ti shqiptoja e ti shkruaja gërmat, fjalët e fjalitë, si ta shkruaja drejt dhe bukur gjuhën më të vjetër të Europës, ndoshta dhe të botës, gjuhën e ëmbël shqipe, edhe në ato raste kur boja më derdhej prej penës duke më ngjyrosur rrobat e mia plotë arna.

Njeriu gjatë jetës ballafaqohet me shumë profesorë të dijes në rrugën e gjatë të jetës, por ndjesitë që i japin kujtimet rreth mësuesit të klasës se parë, rreth personalitetit të Tij, janë padyshim më të pashlyeshmet e nga më të bukurat e jetës.

Sakip Dauti e Munir Hoxha, Shaban Bitri e Rushdi Spata, Lazam Nezha e Ismet Kuta, Gani Bitri e Maliq Bitri, Nuri Noka e Pijazit Noka, Ilir Spata e Vesel Hoxha, Esat Spata e Muhamet Bitri si dhe, shumë e shumë breza të tjerë nxënësish që kanë kaluar në sitën e mësues Aqif Spatës, ndjehen krenar ashtu si dhe unë, që kanë patur fatin ta kenë mësuesin e klasës së parë, në rrugën e gjatë e të mundimshme të mësimit dhe përvetësimit të dijes.

Nuk mund të harrohen as mësuesit e tjerë si Miftar Bushi (ndjesë pastë) nga Rrenzi, Selim Noka nga Arrasi, Nazmi Kaci nga Gur Lura e largët apo Hamdi Nezha (ndjesë pastë) e Skënder Kuta nga Blliçja e Poshtme etj., por unë këtu do të ndalem të shpreh disa fjalë burimore të shpirtit për mësuesin tim të klasës së parë, për Aqif Sherif Spatën.

Mes pengjeve të shumtë që e gërvishtin njeriun gjatë jetës është edhe pengu i të mos shkruarit për ndonjë personalitet të spikatur që të ka mbetur në zemër e në mendje për të mirë dhe për të cilin ndjen një detyrim moral, ndjehesh si borxhli për të, jo për ti bërë qejfin atij apo për ti bërë nder rrethit të tij familjarë, por për ti bërë nder në radhë të parë vetes dhe brezave që ai mësoi e edukoi me përkushtim e pa përtim, me vizion e vullnet të hekurt, duke lënë gjurmë të pashlyeshme te secili prej nesh, në këtë jetë të përkohshme. Ka kohë që kam dashur të vendos në radhë disa shkronja a fjalë por, nuk u bëra për mbarë që ta lehtësoja sadopak zemrën dhe mendjen time duke shkarkuar sadopak prej tyre, nëpërmjet të shkruarit të disa kujtimeve për mësuesin e klasës së parë të shkollës fillore, për mësuesin e shkronjës, për mësuesin e **ABC-së** siç më pëlqen shpesh ta emërtoj edhe kështu (...Eh sa guximtar po tregohen kohët e fundit shtetarët Maqedonas, duan të na zhdukin dhe shtëpinë e alfabetit, shtëpinë e ABC-së në Manastir e, shtetarët tanë heshtin të gjithë, pozitë e opozitë, edhe kur ata i venë zjarrin!!??). Jo për të rivalizuar ndonjë penë tjetër para meje por, për të nxjerrë në pah atë shpirt të madh të Tij, atë këmbëngulje e dashuri në mësimdhënie, atë ndjejnë dhimbje për më të vegjlit, atë përkujdesje sikur të ishim fëmijët e Tij. Në ato rrëfime prekëse të shoqëruara me të qeshurën e lehtë e të thellë të Tij, na tregonte gjëra interesante, të cilat na mbërthenin në botën e tyre nga stili i tregimit, thellësia e mendimit dhe modestia që e ka karakterizuar dhe e karakterizon këtë njeri të thjeshtë. Aqif Sherif Spatën e ndoqi tërë jetën e tij, hap pas hapi, hija e zezë dhe e frikshme e luftës së klasave, e cila në fshatin tim, sipas gjykimit tim, ka patur intensitetin më të lartë të veprimit dhe ndëshkimit, edhe në rang vendi. Këtyre njerëzve vërtet ju shkon për shtat ajo thënia për malet, të cilëve, sa më shumë tu largohesh aq më madhështore e të larta të duken. E njerëz të tillë, për besë të fjalës, janë modele që duhet të njihen. Nuk është vetëm rrethi i vogël i familjes, por edhe i shumë të tjerëve, të bëhen në këtë mënyrë pjesa e krenarisë për ata që e njohin, qe kanë pirë një kafe, që e kanë dëgjuar dhe kanë debatuar me të në mënyrën më fisnike. Kur kalova pragun e shtëpisë së profesor Aqifit (kështu më pëlqen ta thërras në mënyrën merituese), në vizitën e fundit që i bëra në shtëpi, iu drejtova natyrshëm njërës prej mbesave të Tij: Ju duhet të krenoheni se keni një gjysh të mirë, një gjysh të mbajtur, një gjysh të ëmbël, një gjysh të pastër, një gjysh të kthjellët, një gjysh të ditur ku, edhe unë mendoj se më takon pjesa ime, në krenarinë Tuaj, pasi ai para së gjithash është mësuesi im dhe i shumë brezave brenda e jashtë fshatit tonë të dashur. Madje është mësuesi i klasës së parë në jetën time shkollore, duke zënë **një vend të merituar e të veçantë në odën e kujtimeve të mia**, edhe pse sot më ka rënë bore e madhe mbi kokë, më shumë se gjyshit Tuaj, duke shtuar me të qeshur, një pjesë e borës siç e shikoni, më ka shkrirë fare. Që prej viteve të fëmijërisë e deri në ditët tona, pse jo dhe fshehurazi ia shënoja dhe vazhdoj t'ja shënoj diku pas bisedës ato këshilla, ato detaje të jetës e Odave Dibrane që në asnjë vend, në asnjë libër, në asnjë tavolinë nuk i dëgjon e nuk i mëson.

E gjeta një herë shumë të mërzitur. Dikush nuk kishte thënë të vërtetën rreth një problemi që kishte lidhje me të. Për ta qetësuar dhe për t'ia sjellë humorin, i them: Një fjalë e artë popullore thotë: **"Mos u mërzit për dikë që flet keq për Ty, pasi dhe qeni leh për dikë që nuk e njeh".** I pëlqeu shumë, qeshi me të madhe si një fëmijë dhe e mbajti shënim. **Aaaa** ..i drejtohem edhe unë me të qeshur, tani prit pak....i ndërruam rolet. Dëgjo këtu Vesel - mu drejtua krejt dashuri, sinqeritet e seriozitet - kënaqësia më e madhe dhe qëllimi i çdo mësuesi duhet të jetë të nxjerr breza më të ditur se vetja e tyre, ndryshe nuk ka kuptim shkolla, nuk ka përparim njerëzimi. Ky është misioni fisnik i mësuesit.

Dikur, diku kam lexuar një poezi dhe, në mendje se si me mbeti vetiu, as vetë se di! Ndoshta nga që i ndjeva shume ato vargëzime, që vijojnë më poshtë **-Se fjala e zemrës ne zemër futet** -thotë shkrimtari e studiuesi dibran **Xhafer Martini** (Nga Fushë-Çidhna, apo nga fshati **Buzë Drinas**, siç i pëlqen ta thërras Ai vendlindjen e Tij). Po e citoj më poshtë poezinë në fjalë:

Kushdo prej nesh, që kryet nalt e çon, aq sa nuk i takon,
nuk duhet të harrojë, se nga hiçi erdhi dhe pluhur do të jetë,
sikur nuk ka egzistue kurrë në këtë jetë

Jetojnë në histori vetëm ato skyfterë,
Që me fluturimin e tyre botës i japin vlerë.
Të tjerët, si zvarranikë ecin e parakalojnë,
Në parada të kota, që boshët i projektojnë.

Nuk harrova të bëjë një foto me profesor Aqifin me ndihmën e celularit në oborrin e xhamisë së fshatit, ku për hir të së vertetës, me që ishte ditë e Xhuma, kryem së bashku detyrimet si musliman në tempullin e kultit, nën drejtimin e imamit të fshatit të Blliçes së Epërme, **Sheh Ismetit,** një personalitet fetar shumë i njohur nga fshati Limjan, i përgatitur e i përkushtuar në shërbim të banorëve të fshatit, të cilët e duan dhe e respektojnë aq shumë. Unë do ta rendisja pa mëdyshje **profesorin e nderuar** Aqif Spatën e **Blliçes**, në grupin e atyre njerëzve që **fluturojnë** duke i dhënë vlerë jetës. Jetë sa më të gjatë mësuesit të respektuar të brezave, **Aqif Sherif Spatës!**

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Kaçorri, siç shkruajnë autorët, është njëri ndër etërit themelues të kombit shqiptar.

Dom Nikollë Kaçorri - arkitekt, shenjëtor dhe flamurmbajtës i pavarësisë së shtetit të parë shqiptar 1912

Nga **NIKOLLË KOLA**, *avokat*

Libri që është promovuar me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë, kushtuar flamurmbajtësit të shquar për këtë vepër "Dom Nikollë Kaçorrit - Burrështetas shqiptar në altarin e Atdheut", është një pjesë e historisë që hedh dritë në formimin dhe ndërtimin e shtetit të parë shqiptar, ku në tekst ndriçohet në një stad më të lartë figura e Kaçorrit, si faktor përcaktues i brendshëm, për liri dhe shtetformim, si klerik vizionar, si diplomat në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, për lobingjet në kancelaritë europiane e që i tregoi botës se Shqipëria ka zot.

Të dy autorët e librit, Profesor Angjelin Shtjefni dhe historiani Nikollë Loka, të dakorduar, në unison ndërmjet tyre ndërtuan çelësin e artë, me të cilin hapën shumë dritare si brenda dhe jashtë vendit, nga ku gjetën thesarin e historisë, të jetës dhe veprës së këtij kolosi vizionar i madh i kombit shqiptar, imzot Nikollë Kaçorrit.

Këtë thesar me vlera historike autorët e derdhën në këtë libër të shenjtë, ku në të zë fill origjina e fisit Kaçorri më në zë që në lashtësi e ardhur me emigrim nga rrethinat e Ohrit të Dibrës rreth viteve 1700, të vendosur fillimisht në Lurë të vjetër e më vonë në Krejë - Lurë (Fangu i Kaçorrit), një familje e madhe e përbërë me dy besime fetare, katolik dhe mysliman. Në këto troje ata ndërtuan banesa dhe kulla të bukura dhe me punën e tyre krijuan kushte jetese për familjen me dy besime në harmoni njerëzore shumë të lartë.

Këtu në këtë truall të bukur lindi Nikollë Kaçorri më 1865 nga dy prindër me besim të ndryshme, babai Vokërr Kaçorri - katolik dhe nëna Hanë Vladi (Kaçorri) me besim myslimane. Nën kujdesin e prindërve u rrit dhe u edukua Nikolla, por atij i vdiqën të dy prindërit shpejt dhe ai mbeti jetim, por ai u rrit nën kujdesin e xhaxhait Ndrec Kaçorri dhe të kushërinjve të tij deri në moshën 7 vjeç.


Natyrisht Nikolla vjen si fëmijë i zgjuar, por edhe me ndihmën e xhaxhait Ndrec Kaçorri, të priftit të Lurës At Domeniko, të Imzot Dom Ambroso arqipeshkv i Durrësit, Nikolla u dërgua për studime në kolegjin papnor Shkodër për 5 vjet nga ku mbaron studimet me rezultate të shkëlqyera.

Në këto rrethana Kaçorri dërgohet për studime në kolegjin Urban Romë në degët gramatikë dhe retorikë, pastaj ai vazhdon studimet në universitetin "Zeking" Zyrih dhe studion në degët: teologji, filozofi dhe shkencat politike. Ndërkohë Kaçorri zotëronte dhe mësoi gjuhë të huaj: italisht, latinisht, frëngjisht dhe gjermanisht, gjuhë këto të diplomuara dhe çertifikuara.

Kaçorri si gjatë studimeve të para në Shkodër si dhe në universitetet Romë e Zyrih fitoi dije, kulturë dhe aftësi universale akademike. Ai konsiderohej njëri ndër personalitetet më të afta të Shqipërisë në fundin e shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.

Kaçorri u shungurua prift më 1893, kurse më 1894 caktohet prift fillimisht në Delbnisht, Milot e Gurrëz dhe pastaj në kishën Shën Luçia në Durrës si meshtar dhe i jepet titulli (Monsinjor). Në këtë tempull të shenjtë Kaçorri shërbeu e predikoi fenë e Krishtit për 23 vjet.

Në vitin 1896 Papa Piu X e gradon



dhe cakton protonoter apostolik (përfaqësues të Vatikanit në Shqipëri). Kurse më 1906 Kaçorri gradohet Arqipeshkv i Arbërisë (kryetar i katolicizmit të Shqipërisë).

Në rrethanat e parashkruara rezulton se: Kaçorrin e lindi Lura, e arsimoi Shkodra, Roma e Zvicra, kurse Durrësi, Kurbini, Vlora dhe e gjithë Shqipëria (kombi shqiptar) e bënë politikan me emër në Europë.

Autorët e librit theksojnë se Kaçorri është njëri ndër klerikët më të vlerësuar sipas akteve të kohës - ithtar i bashkimit të shqiptarëve.

Kaçorri luajti një rol të rëndësishëm atdhetar nëpërmjet folklorit, nëpërmjet kompozimit të këngëve popullore të trimërisë së trevave të Veriut e më gjerë, si dhe themelues i arsimit shqip në Durrës, mbrojtës i interesave kombëtare. Kaçorri themeloi Shoqërinë atdhetare "Vllaznija", klubin "Bashkimi", përballë reaksionit xhonturk - udhëheqës i kryengritjeve të armatosura. Ideologu i kryengritjes së Kurbinit.

Kaçorri ishte në krye të Kuvendit e në ballë të luftës, përfaqësues politik i kurbinasve. Kaçorri në Kongresin e Manastirit ishte një zë i veçantë në këtë kongres që zhvilloi punimet e tij më 14-22 nëntor 1908, i cili hodhi themelet e shkrimit të gjuhës shqipe. Pjesëmarrja e tij është shumë domethënëse, ai flet thellë, shumë

FLAMUJMBAJTËSIT TË PAVARËSISË

Kushtuar Dom Nikollë Kaçorrit

O Flamur o more bajrak,
Pashë at bojë që e more në gjak,
Je simbol për çdo shqiptar,
Kallzom rrugën nga ke ardhë.

Jam flamur qysh i motit,
Ngrit në kohën e Kastriotit,
Si simbol i gjakut tuaj,
Më pat ngrit Gjergji në Krujë.

I nënshtruem 500 vjet,
Por në zemër flamur mbet,
500 vjet ti dorë më dorë,
Që nga Lura e deri në Vlorë.

O flamur kush të siguroi,
Dom Nikolla më mbajti në gjoks,
Që nga Durrësi e deri në Vlorë,
Ismail Qemalit ia dha në dorë.

Këtij vargoni kush i prini,
Ismail Qemali, Nikollë Kaçorri
e Isa Boletini,
Bashkë me burrat e Shqipërisë,
Shpallën Ditën e Pavarësisë.

O flamur në zemër të kemi,
Ty dhe Shqipen me dy krena,
Gjithë Shqipëria e Kosova,
Nga Ulqini e Tetova.

Ndaj valëvitu deri në qiell,
Sa të ketë hënë e sa të ketë diell,
Je simbol i Pavarësisë,
Gjak i gjakut të Shqiptarisë.

thellë në kongres. Fjalimet e tij ndikuan shumë tek pjesëmarrësit dhe bënë përshtypje jo vetëm për vizionin largpamës dhe kulturën e lartë gjuhësore.

Nikollë Kaçorri ishte pjesë e Kongresit të Elbasanit. Një tjetër domethënie e madhe në vlerën e tij atdhetare.

Këto vlera veç të tjerave Kaçorrin e bëjnë një vizionar, atdhetar, patriot, një kolos dhe burrë të madh shteti.

Kaçorri për veprimtari patriotike, kulturore dhe si organizator i lëvizjeve dhe kryengritjeve të armatosura të viteve 1907-1911, arrestohet nga Porta e Lartë dhe përfundimisht dënohet me dy vjet burgim.

Kaçorri, siç shkruajnë autorët, është njëri ndër etërit themelues të kombit shqiptar. Ai është përpjekur deri në minutën e fundit për shpëtimin e vendit.

Autorët e tekstit me kompetencë nxjerrin në pah rolin e padiskutueshëm në përgatitjen e platformës së Kuvendit të Durrësit e në atë të Vlorës, deri edhe në sigurimin e flamurit dhe dorëzimin në dorë në tribunën e pavarësisë në Vlorë. Thirrja e Kaçorrit në Kuvend ishte: "O flamurë o dekë". "Në qoftë për nesër vdesim sot."

Kaçorri zgjidhet me 100% të votave të delegatëve zëvendëskryeministër i Qeverisë së parë në Vlorë. Roli i Kaçorrit në Qeverinë e kohës ka qenë shumë i madh dhe largpamës, si për ngritjen e administratës shtetërore, në ruajtjen dhe forcimin e unitetit në radhët e qeverisë, në ruajtjen, forcimin e sovranitetin kombëtar etj.

Në rrethanat e shpjegueshme nga autorët, si akt qytetar, i detyruar nga kontradiktat në qeveri dhe sidomos me Ismail Qemalin për probleme parimore Kaçorri jep dorëheqje të parevokueshme nga detyra e zëvendëskryeministrit.

Kaçorri edhe pas dorëheqjes nuk e pushoi për asnjë çast veprimtarinë e tij politike dhe luftarake në interes të kombit e të atdheut. Ai mbështet edhe qeverinë prej së cilës ishte larguar. Pra, Kaçorri ishte një mbrojtës i vendosur i shtetit të ri shqiptar.

Qëndrimi i Kaçorrit veç rezervave që ka shprehur ndaj pretendentëve për Fronin mbretëror, ai u dakordua për ardhjen e Vidit si mbret i shqiptarëve. Vidi e pa Kaçorrin si kandidaturë të përshtatshme për postin e kryeministrit të vendit. Mbreti e thirri Nikollë Kaçorrin dhe i kërkoi të formonte qeverinë, por Kaçorri pranoi me kusht që Esad Pasha të mos bënte pjesë në kabinetin qeveritar. Pra, Kaçorri e pa se nuk bashkëqeveriste me tradhtarët e vendit si Esad Pasha dhe për këtë ai nuk e pranoi detyrën e kryeministrit dhe formimin e qeverisë përpara mbretit Vidit.

Pas zhvillimit të shumë ngjarjeve kundër Kaçorrit nga forcat rebele të Esad Pashës dhe Haxhi Qamilit në janar të vitit 1917 në përbërje të një delegacioni shqiptar Kaçorri shkon në Vjenë, dhe pas mbarimit të vizitës së delegacionit në Vjenë, delegacioni kthehet në Atdhe. Ndërsa Imzot Kaçorri ndalet në Vjenë për t'ju nënshtruar një kontrolli mjekësor (meqenëse sëmundja kishte përparuar shumë - ulçera në stomak) mjekët e shtruan në Sanatorium. Hemoragjia e pandërprerë e bëri të pamundur përpjekjen e mjekëve për ta shpëtuar. Më 29 maj, rreth orës 1100, iu përsërit hemoragjia, pas së cilës humbi ndjenjat. Në orën 1330 dha shpirt në qetësi e paqe.

Ceremonia e varrimit të Kaçorrit u bë më 1 qershor 1917. Morën pjesë shumë zyrtarë, perandorakë dhe diplomatë, e gjithë kolonia shqiptare në Austri. Ndër kurorat e shumta, binte në sy ajo e kolonisë shqiptare, ku lexoheshin fjalët: "Të përshëndet për të mbramen herë Kolonia Shqiptare e Vjenës". Kurorën e vendosi Aleksandër Moisiu. Ndërsa Bajram Curri e Hasan Prishtina vendosën kurorë në emër të dibranëve dhe kosovarëve... Gjergj Dimitrovi, në emër të emigrantëve bullgarë në Austri vendosi kurorën me mbishkrimin "Patriotët demokratë revolucionarë bullgarë, patriotit të shquar shqiptar Nikollë Kaçorrit" si dhe konsujt e tjerë...

Edhe autoritetet kishtare vjeneze e nderuan kujtimin e Imzot Kaçorrit.

Kaluan 94 vjet pritje për dëshirën e fundit. Në çastet e fundit Kaçorri e kishte lënë amanet që eshtrat e tij të prehen në tokën mëmë...

Në këto rrethana amanetin e Nikollë Kaçorrit e realizoi stërnipi i tij Edmond Kaçorri me banim emigrant në Kanada. Autoritetet shtetërore austriake dhe misioni katolik shqiptar i Vjenës dhe Dom Pren Kola ndihmuan për gjetjen e varrit, zhvarrimin e eshtrave të Kaçorrit dhe sjelljen në Atdhe. Qeveria austriake mori përsipër dhe investoi shpenzimet e transportit të relikeve.

Në ceremoninë e mbrritjes së eshtrave të Kaçorrit në Rinas morën pjesë personalitete, intelektuale, familjarët e tij luras, miq e shokë të Tiranës, Durrësit, Mirditës, Dibrës dhe të trevave të tjera të vendit. Por ra në sy mungesa e protokollit shtetëror.

Ceremonia fetare e organizuar më datën 13 shkurt 2011 ishte dinjitoze dhe me pjesëmarrjen e të gjithë hierarkisë së klerit katolik shqiptar.

Veprimtaria atdhetare e Nikollë Kaçorrit është dhe mbetet pjesë e historisë sonë kombëtare dhe si e tillë përbën objekt studimi të sinqertë e të paanshëm për historianët tanë, të huaj e në të ardhmen.

Dom Nikollë Kaçorri, eshtrat e të cilit prehen përjetësisht në truallin mëmë, ai tani është i ngrohtë, i mbuluar me dheun e truallit të famullisë "Shën Luçia" Durrës, ku shërbeu meshtar për 23 vjet duke dhënë edhe jetën për çështjen e fesë, Zotit, atdheut e kombit të tij, që ai të mbetet i lirë, i pavarur e sovran në shekuj nën flamurin e kombit, i cili do të valëvitet i qetë përgjithmonë në të gjithë trojet shqiptare.

Homazh

Ndërron jetë Profesor Zejnullah Ballanca

Unda nga jeta me 16 gusht 2013, në moshën 94 vjeçare, profesori i shkencave juridike Dr. Zejnullah Ballanca, një nga emrat më të shquar të jurisprudencës shqiptare dhe të botës akademike.

Zejnullah Ballanca lindi më 10 mars 1919 në Dibër të Madhe. Në moshën 4-vjecare mbetet jetim nga të dy prindërit. Ishte gjyshja nga ana e nënës që e rriti me dashuri dhe përkujdesje. Pasi përfundoi arsimin bazë, shkollën e mesme e kreu 2 vjet në Ohër dhe pjesën e mbetur në Beograd. Mbarimi ishkollës së mesme me rezultate shumë të mira i hapi rrugë perspektivës për studimet universitare. I akordohet bursë studimi për drejtësi në Universitetin e Sienës, Itali. Pas tre vitesh studimi i ndërprenë për të kaluar në Dibër të Madhe. Në fund të vitit 1943 u vendos përfundimisht në Tiranë. Me mbarimin e luftës krijon familje të re, duke u martuar me Shazijen, të bijën e Haxhi Hafiz Ismet Dibrës (Shehu). Fillimisht punoi si përkthyes i gjuhëve serbo-kroate dhe maqedonase pranë Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë. Më pas punoi si gazetar pranë shoqërisë "Shqipëri-BS" deri në vitin 1959. E gjejmë në fillim të viteve 1960 si asistent-pedagog dhe me pas pedagog pranë Fakultetit të Drejtësisë të USHT. Ndër lëndët që dha ishin: Historia e institucioneve politiko-juridike V.I,II,III; E drejta administrative; Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri. Në vitin 1990, doli në pension me titullin: "Doktor i shkencave juridike". Pas vitit 1970 ishte anëtar i Akademisë së Shkencave duke bërë një sërë hulumtimesh në arkivat e Kroacisë, Malit të Zi etj.

Është autor dhe bashkautor i të parit fjalor të termave juridik me titull: "Fjalor i termave të së drejtës Shqip-Frengjisht-Rusisht".

Në ceremoninë mortore morën pjesë anëtar të famijes, miq, shok, të afërm dhe nga komuniteti dibrane në Tiranë. Përmes këtij homazhi i përcjellim familjes ngushëllimet e rastit për humbjen e profesor Ballancës. Shpirti i tij u prehtë në paqe!

Shoqata "Bashkesia Dibrane"

portret

Esat Shehu i Vleshës…

Nga **ISLAM ÇENGA**

Vlesha, ngjitur shpatit të malit, mes gjelbërimit dhe përballë katër stinëve të vitit, ku ujërat e Veleshicës rrjedhin si qumësht, ku Krijuesi me një bujari të mahnitshme i ka falur gjithçka që ka e mban në prehër Nëna Natyrë; ku shtëpitë, kopshtet, ugaret, pemët, hardhitë, foletë, sokaqet, agu i ditës dhe tisi i mbrëmjes çelen e mbyllen si sytë e një hanëme të fisme; ku njerëzit bujarë e punëtorë, të thjeshtë e të ndershëm bulojnë në kosheret e jetës të vështirë por mundin dhe djersën e ndershme, ku, në fund të fundit, ti vjen si mik si kalimtarë, si vizitor e s`të bëhet të ikësh me ditë, me muaj, me stinë, me mote…

Kaloj aty pari dhe hapësirën e mendimit tim e zë Teqja e famshme e Vleshës, e përmendur dje dhe sot e gjithë ditën si Kryeteqja e gjithë zonës së Lumës, Kuvendet e famshme të Ujë e M`ujës, që përcaktonin jo vetëm fatet e krahinës së Dibrës dhe të Lumës por dhe më gjërë. Mbi të gjithë është vleshiani! I mendjes dhe i dijës, i urtësisë dhe i bujarisë, i familjes dhe vatanit!

Një ndër të spikaturit e kësaj treve, jeta e të cilit është e lidhur ngushtë e pazgjidhshmërisht me të djeshmen dhe të sotmen e Vleshës, të trevës dhe të gjithë Dibrës, spikat njeriu i mirë dhe fisnik, Esat Shehu. Atëherë djalosh plot ëndrra dhe energji, plot shpresa dhe siguri, do të niste udhën e gjatë të jetës si shumë fërsnikë të tij. 5-6 vjeçar do të ndihmonte familjen në mirërritjen e mbarështrimin e blegtorisë, herë në kullotat pranë fshatit, e herë në bjeshkën e Sllovës e të Korabit… Po me fërsnikët e tij do të niste shkollën fillore në fshatin e lindjes. I veshur shik me leshin e butë të deles rude, nën kujdesin dhe dashurinë pafund të nënës, me trupin e imët e me sytë që i shkëlqenin nga ëndrrat, shpresat e mirësia, me çantën prej basme e me ato pak libra e fletore të mbështjellura me kujdes, shpejt do të spikaste për zellin dhe dëshirën e madhe për të nxënë, për dituri…

Pas mbarimit të shkollës fillore, ai tashmë 16 vjeçar, do të niste në qytetin e Peshkopisë shkollën unike, i sigurt dhe kthjellët se kjo ishte udha e duhur për jetën, për të ardhmen.

-E kam dashur librin dhe dijen gjithmonë dhe në shkollën unike të Peshkopisë isha ndër nxënësit e dalluar… Por jo vetëm unë.



Kishte plot djem e vajza të talentuar, punëtorë e të shkathët, me plot ëndrra e energji për jetën, që nesër do të bëheshin profesionist të talentuar, kuadro e drejtues të zot të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë e ndërmarrjeve prodhuese e ndërtuese të kohës. Dhe Esati përmend dhjetëra emra moshatarësh, bashkënxënës e bashkëpunëtorë, ku ndjehet malli dhe kujtimi i një kohë jo shumë larg nesh, "një kohë e mbushur me vështirësi e punë plot sakrifica, një kohë e mbushur me ëndrra dhe shpresa…me shumë mund e më shumë djersë", siç thotë xha Esati.

Dhe jeta ka rrjedhën, kohën dhe hapësirën e saj, teket, fatin e mbarësinë që njeriu i mirë dhe fisnik Esat Shehu, e ka jetuar me gjithë intensitetin dhe vlagën e një të riu me kërkesa, në radhë të parë ndaj vetes. Pas mbarimit të shkollës unike, ai do të niste shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Stërvitja. Mërzitja. Shpresa. Monatonia. Stepjet. Ecja. Dasmat. Lindjet. Vdekjet dhe shumë e shumë mall për vendlindjen, për çdo fije bari, për çdo gjethe shtogu e arre, për vijën e ujit, për sokakun, për punën, e për njerëzit e dashur, e veçanërisht për nënën… do të mbushte zemrën dhe shpirtin e tij në udhën e vështirë të jetës. Pastaj martesa… sipas zakonit, traditës me shkuesi, por me një fat të bardhë, se mori për shoqe jete Shukrien, vajzën nga dera e fisme dhe me emër e Përzhillave të Kalasë së Dodës, që do të bëhej për Esatin bashkëshorte dhe për tre fëmijët e saj, një nënë e përkushtuar dhe shembullore.

Esat Shehu, i ri në moshë, plot energji dhe vitalitet, punoi me përkushtim dhe ndershmëri në sektorë të ndryshëm të ekonomisë në rrethin e Dibrës. Për shumë vite me radhë shef plani në Ndërmarrjen e Ndërtimit…Por unë, e shumë kush si unë, e mbajnë mend si shef shfrytëzimi në Parkun e Mallrave, ndërmarrje me vështirësitë e njohura të kohës. Me kërkesat e panumërta që kishte ekonomia e centralizuar e kohës për mjete transporti, me rrugët e mjetet e amortizuara, me dhjetëra e qindra probleme teknike, burokratike dhe organizative, Esati do të mbante një peshë jo të zakonshme për mbarëvajtjen e punës. I palodhur dhe i përkushtuar deri në sakrificë, e mbaj mend mëngjeseve të hershme kur dilte nga shtëpia ku banonte në lagjen "Kamen" dhe merrte udhën drejt Parkut të Mallrave, ku e "prisnin" njëmijë e një halle, njëmijë e një problem të çastit dhe të perspektivës.

E tani kur po shkruaj këto radhë atë e mendoj në udhët e vështira të Pratit për lëndën drunore, në udhë e pa udhë për transportin e qendrave të zjarrit deri në majë të Sorokolit, në minierën e kromit në Bulqizë, ku tranziti i mineralit shpesh kthehej në një gangrenë për mungesë mjetesh e kërkesa tej kapacitetit menaxhues të ndërmarrjes, me shqetësime e me tension pune ditë e natë për prodhimet bujqësore, për miellin e produktet e tjera të konsumit. Për atë nuk kishte orar, as kohë të mirë e të akullt, as ngrënie me vakte e pushim të qetë, duke "gjetur" vetëm pak kohë për t`u interesuar për mbarëvajtjen e fëmijëve në shkollë…

Kudo do të ishte ai, shefi i shfrytëzimit të kësaj ndërmarrje gjigante, kërkues e këmbëngulës deri në fund, autoritar por i dashur gjer në dhimbje për shoferin, mekanikun, kovaçin, bashkëpunëtorin, vartësin dhe qytetarin e thjeshtë; shok e bashkëpunëtor i sinqertë dhe i hapur, hokatar dhe i këndshëm në biseda mes miqsh dhe shokësh, njeri i punës dhe kurrë herë i pretendimeve. I thjeshtë, njeri i sublimit të pafund e punëtor i palodhur deri sakrificë, cilësi që i shoh dhe i ndjej edhe sot te xha Esati, te plaku i urtë dhe i mençur që t`a ka dëshira të ulesh e të këmbesh fjalë e histori me udhën ku ka shkelur e ka punuar për vite e vite me radhë.

Xha Esati, tashme 83 vjeçar, që nuk ka harruar të qeshë e të gëzojë, të bëjë shaka e t`i thotë si gjithnjë gjërat troç, të ecë me kohën e të shpresojë për shumë e më shumë ditë të bardha e pleqëri të mbarë. Përmend në bisedë e sipër pesë Medalje Pune, të Klasit të III, II e të I të akorduara nga Presidiumi i atëhershëm i Kuvendit Popullor, për punë të palodhur, disiplinë shembullore dhe ndërgjegje të lartë në realizimin e detyrave të kohës.

Veterani i punës, Esat Shehu, sot është një gjysh i lumtur dhe një qytetar i nderuar për të gjithë ato që e njohin dhe ata që kanë dëgjuar për të, për kolegët e bashkëpunëtorët e moshave e profesioneve të ndryshme, për miqtë dhe vleshianët kudo që janë, jetojnë e punojnë… Ai, me zemër e shpirt të madh tashmë çlodhet e gëzon ditët e bardha të mundit dhe djersës, jo vetëm me plakën Shukrie, me djalin e vajzat, por dhe me shtatë nipërit e mbesat, të gjithë me shkollë të lartë dhe kualifikime pas universitare, pedagogë e gjimnaziste të spikatura, të shtrenjta e të dashura për gjyshin e urtë, Esatin.

Gjithsesi, xha Esati edhe po t`ju kthehet viteve pas, në udhën ku shkeli e në punërat që kreu nuk mund të ketë ndonjë gjë për të cilën mund t`a bënte ndryshe. Ai mund të ec krenar e syçelët në rrugën me blire të qytetit tim, mund të ulet më bashkëmoshatarët e të kujtojë e të jetojë mes nderimit dhe respektit të njerëzve, shokëve dhe miqve. Dhe mes tyre gjithnjë e gjej veteranin e nderuar të punës Esat Shehun, jo vetëm burrin e shquar të Vleshës e të trevës ku lindi e punoi, por shumë më gjerë, shumë më tepër, shumë më lart. Në mendjen dhe respektin tonë edhe ju jeni xha Esat, qytetar nderi i punës, i mirësisë, i fjalës, i respektit njerëzor për qytetit tim…

Peshkopi, Korrik 2013

Qeveria provizore e Dibrës dhe kryengritja e shtatorit 1913

Vijon nga faqja 19

Në tekstin i cili do u dërgohej Fuqive të Mëdha shënohej: "Ne, populli i Dibrës, sot në një meting të madh që bëmë në qytet, shpallëm bashkimin e kazas s, onë me Shqipninë. Është e padiskutuar se kazaja e Dibrës si nga pikpamja e racës dhe e historisë ashtu dhe e traditave të saja formon një pjesë të pandarë të Shqipërisë dhe prandaj nuk mundemi kurr të japim pëlqimin tonë që të mbetemi nën administratën e Serbisë. Vendimi i mbretërive të mëdha që u dha në përfundim të luftës Ballkanike që kërkonte këputjen e kazas sonë nga Shqipëria, ne na shkatërroj dhe na sakrifikoj dhe prandaj këtë radhë shpallëm bashkimin me Shqipërinë…".23)

Nxitimi i tyre ishte i kuptueshëm. Nga gjitha anët vinin lajme të kobshme se Beogradi po merrte masa për të ripushtuar viset e çliruara. Është kjo arsyeja që duhej veprur urgjent e të njiheshin Fuqitë e Mëdha me realitetin e ri politik, bashkimin e Dibrës me Shqipërinë. Qeveria Provizore e Dibrës bëri gjithshka për kurorëzimin me sukses të këtij aksioni politik.

Kotraofansiva serbe, e ditëve të para të tetorit, 1913 solli ripushtimin e viseve të çliruara. Ajo gjithashtu shënoi edhe fundin e qeverisë Provizore të Dibrës. Në të vërtetë që me 29 shtator 1913 dy kryengritës dibran të ardhur në qytet nga fronti i Mavrovës e kishin paralajmëruar një gjë të tillë. Siç duket të informuar mbi rezikun e ardhjes së ushtrisë serbe, i ftuan familjarët e të afërmit të braktisnin vendlindjen dhe udhëtonin drejt Shqipërisë. Kryetari i qeveris Provizore të Dibrës, Sefedin Pustina nuk do ta besonte thënjen e tyre, ndaj i qorton për veprimin e kryer. Veprimi i tyre ngjalli panik në qytet, madje disa familje nxituan të emigonin drejt Shqipërisë, brenda kufirit të viti, 1913. Lidhur me këtë Sefedin Pustina i shkruan Aqif Pashës:"…Nga dy qytetarë mëndje–pakët që u kthyen një natë më parë nga kompania e Mavrovës, me qëllim që të justifikojnë fajin e tyre dhe të ndreqin fyerjet që u bënë, shpallën disa gjëra të reme dhe mbi këtë dhanë shkak që shumë familje, gra e kalamaj të emigrojnë. Mbasi kjo ndodhi natën, nuk qe e mundur të ndaloheshin. Megjithkëtë alarmi dhe shqetësimi ra dhe populi u qetësua mirë…"24) Sidoqoftë ky ishte një sinjal që gjithsesi paralajmëronte fundin e kryengritjes dhe të qeverisë Provizore të Dibrës.

Shtypje kryengritjes shënoi edhe fundin e qeverisë Provizore të Dibrës. Ajo jetoi pak kohë, afro dhjetë ditë, por me veprën e saj la gjurmë të thella në jetën shoqërore e politike të dibranëve. Pas afro një viti dhune e shtypje, dibranët jetuan çaste gëzimi të pamasë pasi bashkë me llirinë fituan të drejtën e qeverisjes nga bijtë e tyre. Edhe pse jetoi e veproi në një situate tejet të vështirë, qeveria Provizore e Dibrës tregoi përkushtrim të lartë ndaj çështjes kombëtare. Dokumentacioni që ofrohet përmes korespondencës së qeverisë Provizore të Dibrës dhe Prefekturës së Elbasanit flet shumë lidhur me këtë ngjarje. Gjithë korespondenca e zhvilluar hedhin dritë mbi veprimtarinë e saj, por mbi të gjitha është nga të paktat burime për kryengritjen në përgjithësi.

Qeveria Provizore e Dibrës ishte produkt e kryengritjes, por jo e trajtuar si pjesë e saj, aq më pak, si një faktor i rëndësishëm për kurorzimin e saj me sukses. Duke u përpjekut për t'i dhënë dritë kësaj dukurie të re edhe vetë kryengritja e Dibrës e Shtatorit 1913 merr dimensine më të plota. Ajo pasurohet me tjera ngjarje e personazhe, gjithsesi të lënë në hije. Evokimi i veprimtarisë së saj, pas një qind vitesh, sjell para auditorit tjera personazhe me kontribute në lëmin kombëtar. Sefedin Pustina e Selim Dema padrejtësisht ishin shkëputur prrej Saj. Korespondenca mes Sefedin Pustinës dhe Vehbi Agollit me Selim Demën na jep të drejtën të gjykojmë se ky i fundit ishte udhëheqësi i vullnetarëve të Dibrës së Sipërme në frontin Strugë-Ohër-Follorinë. Në këtë këndvështrim kërkohet që më me guxim këto dukuri dhe bashkë me to edhe aktorët dhe regjizorët e këtyre ngjarjeve të gjejnë një pasqyrim më të plotë.

Referime

1, 10. Ismail Strazimiri. Libër kujtimesh, dorëshkrim, Tiranë 1931, f. 7
2,4. Kristo Frashëri. Historia e Dibrës, Tiranë 2012, f. 340
3. Gafur Zota. Përkushtrimi atdhetar i "Qeverisë Provizore të Dibrës në ditët e kryengritjes së Shtatorit, 1913. Jehona, nr. 6. f. 68-75, Shkup, 1993. Gafur Zota. Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe problem të ngritjes së administrates lokale në Dibër. Dibra dhe etnokultura e saj, vol. I, Dibër, më 1995, f. 287-299.
5,6,7,8,9,11,12, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20. Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, Tiranë, 1963, dok. 266, f. 193.; Dok. 275, f. 201.; Dok. 266, f. 193.; Dok. 294, f.211; Dok. 275, f. 201.; Dok. 276 f. 201.; Dok. 294, f. 211.; Dok. 280, f. 203.; Dok. 285, f. 206.
13. Gaz. "Shqipëria e Re", 1913, 28 nëntor, f. 3-4. E. Matraxhiu Kryengritjet shqiptare. Të Marunit e Dibrës. Barbarizmi serb. Shkaku i shtypjes. Armikut iu zaptuan 13 topa. A. I. H. Vj. 23-19-1932. tel. nr. 5013. ref. I. IV. V. Regjistruar, më30. 11. 1913. Durrës, më 28 shtator 1913. Armikut iu zaptuan 20 topa. Haki srërmilli dorshkrim i cit. Armikut iu zunë 17 topa. Ismail Strazimiri, dorshkrim i cituar, po aty. Armikut iu zaptuan 17 topa, disa mitralozë e një sasi e madhe municioni.
21,22, 23, 24. Aqsh. Fondi 428, prefektura e Dibrës, skeda 411004. Tel i Ahmet Irfanit dërguar qeverisë provizore të Dibrës; Fondi 245, dos. 5/2, f. 743; fondi 245, dosja 5/2, fleta 743; dok 285, f. 206,

foto e muajit



Foto nga Ura e Vashës.
Sipër, në sfond duken punimet që po vazhdojnë
në Rrugën e Arbrit.
© Foto: Gazmend Kërkuti

Firmos peticionin për rrugën e Arbrit
http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arbëri-road-ndërtoni-sa-më-shpejt-dhe-me-standarde-rrugën-e-arbërit

cyan magenta yellow black